


PËRMBAJTJA

Lajme	2
Milazim Krasniqi: Ideologjitë që kanë pësuar disfatë historike nuk mund të rehabilitohen	3-5
Intervistë me Bajram Rexhepin	6-9
Sead Ujkani: Buxheti 2009 më i lartë për 15 % ..	10
Sabri Halili: Paqartësi, mosmarrëveshje dhe hezitime për zgjedhjet në Kosovë.....	11-12
Avni Avdiu: Maqedonia postobama	12-13
Floriqe Ademi: Dështim i radhës i UNMIK-ut në Mitrovicë.....	14-15
Armend Hetemi: Dëshmitar i një dite historike	16-17
Demir Reshiti: I përkushtuar për fe e atdhe.....	17-18
Drita Vitia: Aty ku vaji i foshnjave përzihet me buzëqeshje e mallëngjim.....	19
Demir Reshiti: Kosova në Hagë.....	20-21
Muhamed Jusufi – Kajolli: Kush do ta zëvendësojë Muhammedin s.a.v.s.?.....	22-23
Emine A. Vezaj: Prosperiteti i Kosovës në varësi serioze nga koekzistenca fetare dhe etnike.....	24-25
Vjollca Sheqiri: Të rinjtë e Kosovës në kërkim të perspektivës.....	25
Berat Dakaj: Inshalla bahet ashtu qysh e ka shkruar Lumi ZOT!	26
Ferid Selimi: Shqiptarët – i vetmi entitet në Serbi pa Këshill Nacional	27
Mimoza Sinani: Esenca e artit islam	28
Flamur Maloku: Statuset tekstuale	29-30
Besim R. Cengu: Atëherë kur lindi alfabeti i përbashkët i shqipes	31-32
Mexhid Yveysi: Rreth "Kongresit të Manastirit" profesori Jahja – asgjë nuk tha.....	33
Poezi	34
Drin Gashi: Klipomania.....	35
Elton Khanari: Sfidat e të mbeturit familje normale..	36
Bujar Sejdiu: 'Shkurtëza e faraonit'.....	37
I. Alloqi & B. Tahirbegolli: Gurët në veshka.....	38-39
Fjalëkryqi	40



6 Intervistë me Bajram Rexhepin



11 Paqartësi, mosmarrëveshje...



14 Dështim i radhës i UNMIK-ut...



16 Dëshmitar i një dite historike



36 Aty ku faji i foshnjave...



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,
KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti III / Nr. 24
19 nëntor - 19 dhjetor 2008
Botues
Zëri Ynë
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Redaktor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Demir RESHITI
demireshiti@hotmail.com

Redaktor i kulturës
Flamur MALOKU
flamurmalku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore
Mimoza SINANI

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,
përballë teatrit Dodona,
Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

Çikago

4 nëntor 2008

Barak Obama zgjidhet president i 44 i SHBA-së

Me 338 vota elektorale kundrejt 159 të rivalit të tij republikan, senatori demokrat 47 vjeçar, Barack Obama është zgjedhur presidenti i 44 me radhë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Fitorja e Obamas i ka dhënë fund 8 viteve të kontrollit republikan të Shtëpisë së Bardhë, nën presidentin Bush.

Ai do të jetë presidenti i parë afrikano-amerikan në historinë 232 vjeçare të Shteteve të Bashkuara. Obama do ta bëjë betimin si president më 20 janar 2009.

Obama, babai i të cilit ishte nga Kenia dhe nëna një amerikane e bardhë, ishte gjithashtu i pari kandidat presidencial afrikano-amerikan i një partie të madhe politike në Shtetet e Bashkuara.



Prishtinë

10 nëntor 2008

Kundërshtohet plani gjashtë-pikësh për Kosovën i sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki-Moon



Udhëheqësit e institucioneve të Kosovës kanë zhvilluar një varg takimesh me përfaqësuesit e vendeve të Grupit të Kontaktit në Prishtinë dhe me përfaqësuesin e BE-së në Kosovë, Pieter Faith – por ata kanë mbetur pranë qëndrimit të mëherëshëm se për Prishtinën zyrtare është i papranueshëm plani gjashtë-pikësh për të cilin janë dakorduar Beogradi dhe OKB-ja.

Sipas kësaj Marrëveshje të UNMIK-ut/OKB-së me Qeverinë e Serbisë, në fushën e policisë, parashihet mundësia e krijimit të stacioneve dhe nën-stacioneve të reja policore në rajonet e banuara me shumicën serbe, të cilat do t'i përgjigjeshin UNMIK-ut dhe ky zinxhir komandues do të shkonte deri te PSSP-ja. Gjithashtu, parashihet emërimi i një oficer serb, nga ana e Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut, që do të merrej me aktivitetet konkrete në terren. Në pikën e Doganave, sipas kësaj Marrëveshjeje, parashihet një ushtrim i përbashkët i doganave, nga ana e doganierëve ndërkombëtarë dhe i doganierëve të Serbisë, në Portat 1 dhe 31. Në pikën e Trashëgimisë kulturore dhe religjioze, parashihet një dialog midis përfaqësuesve të Prishtinës dhe Beogradit për këto çështje shumë të ndjeshme, megjithëse dihet që kjo temë është adresuar në Propozimin Gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisari.

Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Ban Ki-Moon, i ka bërë thirrje Prishtinës që ta pranojë planin e tij, për të cilin është pajtuar Beogradi. "Shpresoj që Prishtina do ta kuptojë dhe do të veprojë me pragmatizëm dhe fleksibilitet" - ka thënë Ban Ki-Moon, pas shtyrjes së seancës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Prishtinë

14 nëntor 2008

Filloi shpërndarja e patentë-shoferëve të Kosovës

Pajtesa Mustafa nga Prishtina është qytetaria e parë e Kosovës që pajiset me patentë-shofer të Republikës së Kosovës. Patentë-shoferin e parë të shtetit të Kosovës e kanë dorëzuar ministri i Transportit dhe i Postë-Telekomunikacionit, Fatmir Limaj dhe ministri i Brendshëm, Zenun Pajaziti. Ministrat Limaj dhe Pajaziti kanë deklaruar se patentë-shoferët e ri të Kosovës janë të një cilësie dhe sigurie të lartë dhe është pothuajse e pamundshme të falsifikohen.

Ndërkaq, ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, Fatmir Limaj, theksoi se kjo është ditë e veçantë për kategorinë e njerëzve që janë vozitës dhe qytetarë, të cilët kanë një privilegj që nuk e kanë pasur gjeneratat e kaluara.



Ideologjitë që kanë pësuar disfatë historike nuk mund të rehabilitohen



Milazim KRASNIQI

Kosova është shtet më vete për herë të parë në historinë e vet dhe kjo përvojë e re duhet të mbushet me përmbajtje adekuate, për të mos i lënë vend tendencës për deformimin e historisë së saj të re e të vjetër. Shteti i ri i Kosovës, tash duhet ta konsolidojë historinë e vet si një tërësi vlerash të verifikueshme e të qëndrueshme mbi të cilën është formuar dhe mbi të cilën do të ekzistojë. Kjo do të thotë se puna e parë që duhet të bëhet në realitetet e reja është shmangia e konceptimit mitologjik dhe ideologjik të historisë së saj. Mitologjitë, me paraardhës ilirë që nuk kanë lënë asnjë gjurmë të dokumentuar shkrimore e asnjë përvojë të mirëfilltë shtetërore, nuk kanë pse të mbahen më si daulle të nxehura nga gumëzhima patriotike. Përpyekjet për të sajuar njëfarë identiteti shtetëror të Kosovës me simbole e figura ilire, janë anakronike, sepse identiteti shtetëror në shekullin e XXI-të nuk mund të funksionojë mbi vlerat e paganizmit. Iliromania ka mundur të bartte njëfarë kuptimi në periudhën romantike të konstituimit të idesë kombëtare, ndonëse jo në atë përmasë deformimi. Por, në kujtesën historike të shtetit të ri, daullet zhurmuese pseudoshkencore mund të shkaktojnë trulllosje.

Shumë më tepër viktima se sa heronj

As mitologemat ideologjike enveriste për qëndrestarë të pamposhtur, meqë paskëshin pirë sisën e enverizmit, vërtet nuk do të duhej të futeshin në themelet e historisë së shtetit të ri. Ata që kanë mbijetuar burgjet e okupatorit, nuk ka logjikë të vetëshpallen heronj për së gjalli. Vetë fakti që kanë mbijetuar dhe janë gjallë

e shëndosh, i privon nga e drejta që të vetëshpallen heronj. Të gjithë duhet të jemi të lumtur që ata ish vuajtës janë gjallë e shëndosh, por duhet të jemi të mërzi-tur kur ata duan të uzurpojnë piedestalet e heronjve të vërtetë. Prandaj, asnjë gjë që nuk mund të verifikohet shkencërisht dhe që nuk mund të argumentohet në perspektivën e vlerave të qytetërimit, nuk do të duhej të futej në ngrehinën e historisë së shtetit të ri. Më mirë është që kjo histori të konsolidohet mbi një tërësi më modeste vlerash, se sa të ngrihet mbi një kallaballëk vlerash mitologjike e ideologjike, të cilat në instancë të fundit janë pseudovlera dhe antivlera. Në fund të fundit, Kosova nuk ka histori të një mbretërie, as të një perandorie e madje as të një shteti, prandaj historia e saj gjithsesi do të jetë modeste për nga bëmat e saj. Në fakt, Kosova ka një histori të gjatë dhe shumë të dhimbshme të përpjekjeve për çlirim, për liri kombëtare e për kauza të ndryshme ideologjike, ku ka pasur shumë më tepër viktima se sa heronj. Shtetasit e Kosovës së pavarur, duhet të mësohen të jetojnë me këtë fakt. Fakti që ka pasur më shumë viktima se sa heronj, zbulon egërsinë e okupatorëve, por edhe dobësinë e projekteve nacionale.

Në këtë kontekst, kur ende nuk janë vënë as piketat e një historie të argumentuar shkencërisht, tendencat e disa grupeve joformale, që pavarësinë e Kosovës ta paraqesin si rezultat të qëndresës së motivuar nga enverizimi, po bëhen gjithnjë e më agresive. Lidhur me pretendimin e këtyre grupeve joformale, duhet të bëhet një sqarim: kontributet e të gjithë njerëzve për pavarësinë dhe për lirinë e Kosovës, duhet të vlerësohen domosdoshmërisht. Pra, edhe kontributet e atyre që kanë qenë të motivuar nga enverizimi, nëse ato janë kontribute të verifikueshme dhe të qëndrueshme. Ata që kanë rënë për pavarësinë dhe për lirinë e Kosovës, natyrisht që e meritojnë respektin e të gjithë bashkëkombësve. Por, respekti për ta duhet të institucionalizo-

het, në kuadër të sistemimit të të gjitha vlerave të historisë së shtetit të ri. Ngutja e grupeve joformale që të imponohen vetëm kontributet e enveristëve, duke i përjashtuar të gjithë të tjerët, është një hile ideologjike e demagogëve. Këtë ngutë enveristët e gjallë e kanë nga konceptimi marksist mbi historinë, sipas të cilit edhe vetë historia fillon me ta. Gjithçka, përpara se ata ta fillonin kauzën revolucionare, paskësh qenë një qëndresë jorevolucionare, që do të thotë edhe e kotë. Qëndresa e luftëtarëve të Lidhjes së Prizrenit kundër copëtimit të tokave shqiptare, sipas këtij konceptimi marksist, rezulton e pavlerë. E pavlerë rezulton të jetë edhe qëndresa e luftëtarëve kundër okupimit të Kosovës në vitin 1912 dhe e gjithë rezistenca e viteve tridhjetë, dyzet e deri në shfaqjen e grupeve marksist-leniniste në vitet pesëdhjetë.

Konceptimi grupor dhe klasor i historisë së kombit dhe të shtetit (edhe të shtetit të ri të Kosovës) kësisoj po bëhet përjashtues dhe deformues. Me kësi kriteri, kurrë nuk do të mund të krijohet një pamje e vërtetë e historisë së shtetit të ri. Me kësi kriteri mund të shkohet drejt ideologjizimit dhe krahinarizimit të historisë. Ashtu do të rezultonte që çdo mëhallë i ka heronjtë e vet, çdo fshat i ka heronjtë e vet dhe çdo komunë i ka heronjtë e vet. E drejta, është normale që edhe t'i kenë. Por, deformimi fillon kur heronjtë e një mëhale, të një fshati ose të një komune, duan t'i imponojnë si heronj të mbarë kombit ose të shtetit. Në këtë mes, bien edhe heronjtë ideologjikë. Ata mund të jenë heronj të një grupimi politik ose ideologjik, edhe të grupimit enverist, por nuk mund të imponohen si heronj kombëtarë ose shtetërorë, nëse nuk janë të tillë me veprën e vet sublimë. Një person që e ka pasur ose e ka enverizmin si busull të orientimit të vet ideologjik, nuk mund të jetë simbol i demokratëve, i ballistëve, i legalistëve. Ai mbetet simbol brenda grupimit enverist, por jo për të tjerët.



Të gjallët që manipulojnë me emrat e të rënëve, duke u munduar t'ua zmadhojnë bëmat, gjithnjë në bazë të preferencës ideologjike, bëjnë gabime të rënda morale. Për së vdekuri i vënë në pozitë të vështirë, duke u munduar t'i vendosin në një vend, të cilin ata nuk e meritojnë dhe për të cilën ata as nuk kanë rënë. Fjala vjen, të rënë në një demonstratë kundër regjimit, ose të vlarët në ushtri a në burgje, nuk mund të barazohen me heronjtë kombëtarë, që e kanë planifikuar dhe e kanë realizuar një luftë çlirimtare në përmasa kombëtare. Në rast të një barazimitarë të tillë, heronjve të vërtetë të kombit ose të pavarësisë së shtetit, esencialisht do t'u zvogëloheshin meritat. Do të afirmohej përfytyrimi që heronjtë janë bërë aksidentalisht, pahiri, gjë që nuk është aspak e vërtetë.

Enverizimi i historisë së re të Kosovës

Për të shmangur tendencën e enverizimit të historisë së re të Kosovës, në kujtesën e shtetit të ri duhet të funksionalizohet fakti që për pavarësinë kanë luftuar e kanë rënë burra e gra të bindjeve të ndryshme ideologjike, politike e fetare. Respekti për të gjithë ata duhet të memorizohet. Vendi në këtë kujtesë duhet t'u jepet në bazë të meritave, e jo në bazë të lobimeve të grupeve agresive të interesit. Nëse ndodh që lobimi të përcaktojë vendet në histori, atëherë për luftëtarët e kohës së Lidhjes së Prizrenit, të kohës së pavarësisë së Shqipërisë, të kohës ndërmjet dy luftërave botërore e edhe të NDSH-së, nuk ka kush të llojë. Në fakt kjo edhe është duke ndodhur, në këto nëntë vite të çlirimit të vendit dhe në këta dhjetë muaj të pavarësisë. Në këtë periudhë, ato gjenerata patriotësh janë mbajtur tërësisht jashtë vëmendjes së publikut. Është mbajtur tubim spektakular për Enver Hoxhën në Prishtinë, por nuk është mbajtur asnjë aktivitet për Ymer Prizrenin, për Sulejman Vokshin, për Bajram Currin, për Isa Boletinin, për Hasan Prishtinën, për Azem Bejtën, për Halim Spahinë, Gjon Sereqin, Tahir Deden, etj. Mbajtja e një tubimi të enveristëve nuk është problem. Problem është kur tubimi shfrytëzohet për imponimin e enverizmit si vlerë kulminante kombëtare. Në këtë aspekt duket se historia e re e shtetit të Kosovës ka filluar të rrudhet në mënyrë të dhimbshme në një parcelizim ideologjik. Në këtë pikë ka filluar të zgjerohet edhe një manipulim shumë i

pamoralshëm, sipas të cilit në Kosovë ka pasur vetëm dy alternativa: enverizëm ose titizëm. E vërteta është se krahas këtyre dy opsioneve, të cilat në esencë i përkasin të njëjtit bllok ideologjik, ka ekzistuar edhe alternativa antikomuniste e ballistëve dhe e legalistëve, në emigracionin shqiptar. Mungesa e njohurive për një gjë, nuk do të thotë se ajo nuk ekziston. Nga ana tjetër, në rrethimin tonë ka ekzistuar demokracia liberale e Perëndimit, me të cilën shqiptarët kanë qenë në kontakt aktiv, veçmas në vitet shtatëdhjetë e tetëdhjetë, kur paradoksalisht e kanë përqaftuar masivisht enverizmin ose titizmin! Pse jo demokracinë liberale, e cila u tregua triumfuese?

Simbolet e të botës së lirë mbetën të padeshifruara

Pse veprimtarët shqiptarë nuk kanë pranuar për model Vili Brantin, i cili pati kurajën të binte në gjunjë para viktimave të terrorit nazist, kur vizitoi Poloninë në vitin 1971? Po të ishte marrë Vili Branti si model, do të mund të arsyetohej kërkesa e shqiptarëve për liri në raport me okupatorin serbo-jugosllav. Nëse jo Vili Brantin, pse nuk e kanë pranuar si model Ronald Reganin, njeriun që e filloi epokën fitimtare të botës së lirë mbi botën e errësirës staliniste? Gjëja më e logjikshme do të ishte që urrejtja ndaj okupatorit komunist serbo-jugosllav, t'i ndërjegjësonte veprimtarët enveristë që Regani ishte lideri që po i bënte varrin edhe sistemit të shtetit okupator, e edhe Bashkimit Sovjetik, përkatësisht Rusisë, e cila historikisht ka qenë inspiruesja e pushtimeve sllavojugore në dëm të shqiptarëve. Pse nuk i bëri për vete veprimtarët shqiptarë fjalimi historik i Reganit në Berlin, në vitin 1987, kur iu drejtua Gorbaçovit me fjalët: "Zotëri Gorbaçov, hapini këto dyer! Zotëri Gorbaçov, rrëzoheni këtë mur!" Sikundër u pa më vonë, rrëzimi u Murit të Berlinit e hapi edhe kapitullin e çlirimit të Kosovës. (Fatkeqësisht, ka mbetur në kujtesë një protestë e disa enveristëve shqiptarë në Berlin, kundër rrëzimit të Murit të Berlinit!) Por, fatkeqësia, nuk është që enveristët shqiptarë të Kosovës nuk e vunë re atëherë rëndësinë e ndryshimit. Fatkeqësia është se ata faktikisht nuk duan ta pranojnë as tash rëndësinë e atij ndryshimi. Me vetë faktin që e glorifikojnë sot Enverin dhe enverizmin, ata mohojnë vlerat e botës së lirë. Edhe vlerat që solli politika e Brantit, e edhe vlerat që solli politika e Reganit.

Enverizmi dhe titizmi kanë pësuar bashkërisht disfatë

A është faji i demokracisë liberale apo i verbërisë ideologjike të enveristëve dhe të titistëve shqiptarë të Kosovës? Na mbetet të hamendësojmë se si do të zhvillohej lëvizja kombëtare në Kosovë, pas Luftës së Dytë Botërore, nëse ajo do të përqaftonte konceptet fundamentale të demokracisë liberale. Por, e logjikshme është që të besohet se përkrahja e Perëndimit do të ishte shumë më e fuqishme. Ne e kemi parë se kur lëvizja politike në Kosovë, në fillim të viteve nëntëdhjetë, proklamoi përqaftimin e koncepteve të demokracisë liberale dhe të aleancës me Perëndimin, ndihma e Perëndimit evoluoi dhe u kurorëzua me intervenimin ushtarak të NATO-s dhe me pranimin e pavarësisë së Kosovës. Kush është aq naiv sa të besojë se NATO-ja do të intervenonte në mbrojtje të një lëvizjeje enveriste dhe se do të pranohej si shtet i pavarur një Kosovë e dominuar nga ideologjia enveriste?! Prandaj, nuk mund të thuhet se kanë qenë në dispozicion vetëm enverizmi dhe titizmi, sikundër që nuk mund të thuhet se enverizmi paskësh qenë një zgjidhje e drejtë. Ndërsa, kur është fjala për titizmin, (term gjithsesi joadekuat, por i cili si i tillë, joadekuat, është produkt i enveristëve), nuk mund të mohohet e vërteta se disa nga eksponentët e tij kryesorë, në momente të caktuara, janë angazhuar edhe për shndërrimin e Kosovës në republikë në kuadër të ish Jugosllavisë, gjë që ka qenë edhe kërkesa kryesore e enveristëve. Edhe vetë disa nga eksponentët e enverizmit në ndonjë rast e kanë pranuar që Fadil Hoxha ka qenë inspiratori i kërkesës për republikën e Kosovës në vitin 1968.

Nga ana tjetër, nuk mund ta mohojë askush kontributin që kanë dhënë në shkollimin e gjeneratave të reja të shqiptarëve, në zhvillimin ekonomik dhe në transformimin shoqëror të Kosovës, politikanët dhe intelektualët shqiptarë që kanë punuar brenda institucioneve të sistemit. Ata kanë hapur me qindra shkolla fillore dhe të mesme, ata kanë hapur Universitetin e Prishtinës dhe Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ata e kanë shndërruar ish Rilindjen në gjigand të botimeve shqipe, ata e kanë ngritur ish Radiotelevizionin e Prishtinës. Nuk i kanë ngritur enveristët e Kosovës, e as Enver Hoxha. Por, qëllimi i ideologjisë titiste ka qenë integrimi i shqiptarëve në

sistemit komunist dhe në shtetin jugosllav, duke ua shembur tërësinë e vlerave kombëtare, fetare e qytetërimore. Pra, qëllimi nuk ka qenë fisnikëruet, por deformues dhe asimilues. Prandaj, një ideologji e atillë johumane, edhe krahas disa rezultateve konkrete që ka pasur, nuk ka mundur dhe nuk mund të rehabilitohet, sepse qëllimi i saj ka qenë negativ, anti-njerëzor. Ideologjia titiste ka pësuar, në tërësi, disfatë historike dhe askush nuk ka të drejtë morale të afirmojë një ideologji që ka pësuar disfatë historike. Edhe ideologjia dhe praktika fashiste, nga ana e saj, ka pas provokuar zhvillim ekonomik, por disfata historike që ka pësuar, i ka bërë të palavdishme projektet e fashizmit.

Sa i takon projektit enverist për Kosovën, duhet të rikthejmë në vëmendje edhe një tjetër të vërtetë: enveristët janë angazhuar për Kosovën si republikë në kuadër të federatës jugosllave, duke kërkuar që e tërë Jugosllavia të kthehej në burimin e mirëfilltë ideologjik të marksizëm-leninizmit e të braktiste "revizionizmin jugosllav". Kjo ka qenë kërkesa themelore e enveristëve të Kosovës. Fatkeqësisht, reagimi i autoriteteve serbo-jugosllave ndaj asaj kërkesë patriotike-ideologjike dhe ndaj bartësve të saj, ka qenë mizor. Reagimi ka qenë i motivuar nga ideja serbomadhe e shtypjes së shqiptarëve dhe e dëbimit të tyre nga Kosova. Aktivitetet e enveristëve janë shfrytëzuar si pretekst për rishpalosjen e projekteve antishqiptare. Reagimi i autoriteteve ka qenë në shpërpjesëtim drastik me kapacitetet dhe me mjetet që kanë përdorur enveristët, për realizimin e kërkesës për republikën e Kosovës në kuadër të federatës jugosllave. Ndaj shpërndarjes së trakteve të shaptilografuara, mbledhjeve ilegale të celulave me tre persona dhe pjesëmarrjes në protesta masive, autoritetet kanë reaguar me tërë egërsinë e aparatit të shtetit totalitar dhe okupator.

Të gjitha viktimat e terrorit serbo-jugosllav duhet të rehabilitohen

Vuajtjet e enveristëve dhe të patriotëve të tjerë shqiptarë në burgjet serbo-

jugosllave, përbëjnë një kapitull historie të dhimbshme. Por, vuajtja në burgjet e egra serbo-jugosllave nuk është karta e duhur për të uzurpuar piedestalet e heronjve dhe për ta deformuar pamjen e historisë së Kosovës. Në burgjet serbo-jugosllave kanë vuajtur e madje janë pushkatuar edhe shumë bashkëluftëtarë të Shaban Polluzhës dhe pjesëtarët e Organizatës Nacionaldemokratike Shqiptare. Por, vuajtjet e tyre ka tendenca që të mbeten të mbuluara me harresë. E drejta, të gjitha viktimat e terrorit serbo-jugosllav duhet të rehabilitohen në shtetin e ri, me mirënjohje, me përmirësime sociale të statusit, me publikimin e dëshmimeve të vuajtjeve të tyre. Për këtë gjë duhet që personat vetë, po edhe familjet dhe organizatat e ndryshme, të iniciojnë procese gjyqësore, në të cilat do të kërkohet pafajësia dhe rehabilitimi i atyre që janë dënuar me vite burgimesh dhe të atyre që kanë humbur jetën nga torturat e policisë, ushtrisë dhe të shërbimeve sekrete. Në Serbinë fqinje, fjala vjen, procesi i rehabilitimit të viktimave të përndjekjes komuniste është duke u zhvilluar tash sa vite. Tashmë është rehabilituar edhe kryetari i qeverisë jugosllave në emigracion, Sllobodan Jovanoviçi dhe ministri i jashtëm në qeverinë në emigracion, Momçillo Ninçiqi, si përkrahës të lëvizjes çetnike. Por, serbët edhe në këtë çështje, si në shumicën e punëve të tyre, dinë të shkojnë në ekstrem. Aktualisht, në gjykatat serbe është duke u zhvilluar madje edhe një proces gjyqësor për rehabilitimin e Drazha Mihajloviçit!

Në realitetin shqiptar duhet të ketë një ndjenjë më kritike dhe më racionale. Fashizmi nuk mund të rehabilitohet kurrsesi, ndonëse disa nga aktivistët shqiptarë që kanë qenë të pleksur me të, i kanë ofruar shërbime të vyera kombit shqiptar. Figurat e tilla edhe mund të rehabilitohen, nga rasti në rast e duke e vlerësuar veprimtarinë e secilit në të gjithë paramet-

rat human e kombëtarë, ku pika e parë duhet të jetë vlerësimi se a kanë kryer krime a jo. Në rast se nuk kanë qenë të përfshirë në kryerje krimesh, veprimtarët e tillë mund të rehabilitohen. Por, realisht ata nuk bënë të heroizohen. Fjala vjen, na duket vendim i pavend që një rrugë në qendër të Prishtinës i është vënë emri i Mustafa Krujes.

Sa u përket enveristëve të Kosovës, puna ndryshon. Ata kanë qenë viktimat e terrorit serbo-jugosllav dhe duhet të rehabilitohen me procese gjyqësore. Këtu nuk duhet të ketë asnjë dilemë. Por, ideologjia enveriste me të cilën ata janë ushqyer, kurë nuk mund të rehabilitohet, sepse edhe ajo ka pësuar disfatë historike. Nuk mund të arsyetohet për qafimi i një ideologjie aq negative me "rrethanat historike", sepse në atë rast edhe për qafimi i ideologjisë fashiste do të mund të arsyetohej me të njëjtin kriter, të "rrethanave historike". Ndërsa, në atë rast do të shkaktohej një anarki tragjike në vlerësimin e të kaluarës.

Për shkak të këtyre zhvillimeve jopitike për një shtet, edhe historia e periudhës kur Kosova ka qenë e okupuar, duhet të studiohet e të sistemohet pa ngarkesa ideologjike. As kontributet nuk ka pse të zmadhohen e as krimet nuk kanë pse të fshihen, sepse nëse kjo ndodh, ka rrezik të deformohet edhe e ardhmja jonë evropiane.

Prandaj, historia e shtetit të ri duhet të filtrohet, në mënyrë që shtetasit e Kosovës të jenë të informuar se cili është drejtimi në të cilin duhet të ecë shoqëria dhe shteti i tyre i ri, e të mos mbeten pengje të ideologjive të së shkuarës, veçmas të fashizmit dhe të komunizmit, të cilat edhe kanë pësuar disfatë historike. ■



Intervistë me Bajram Rexhepin, kryetar i komunës së Mitrovicës

Serbët e Mitrovicës gradualis

- UNMIK-u asnjëherë nuk e ka funksionalizuar mandatin në pjesën veriore të Mitrovicës
- Komuniteti serb në Mitrovicë - peng i strukturave paralele të sigurisë
- Duhet të hulumtohen e të kapën kontrabandistët kryesorë që e mbajnë këtë monopol e jo vetëm distributorët
- Edhe sikur të isha tani kryeministër, nuk besoj se do të mund të bëja më tepër sepse mundësitë megjithatë janë të kufizuara

Intervistoi: Demir Reshiti

Mitrovica, dikur e njohur si qyteti më i zhvilluar industrial jo vetëm në Kosovë, sot po përballet me shumë probleme. Ura e Ibrit e ndan këtë qytet në dy pjesë. Në një pjesë veriore të udhëhequr nga struktura paralele serbe të dirigjuara nga Beograd dhe nga një administratë ndërkombëtare e cila ka pranuar se ka dështuar ta shtrijë mandatin, si dhe në pjesën jugore e cila udhëhiqet nga institucionet vendore.

Për t'u njohur më për së afërmi me gjendjen momentale në Mitrovicë, zhvilluam një intervistë me z. Bajram Rexhepi, kryetar i kësaj komune dhe ish-kryeministër i Kosovës. Rexhepi flet për raportet me administratën e UNMIK-it, kompetencat e kufizuara të qeverisjes vendore në pjesën veriore të qytetit, strukturat paralele të sigurisë, kontrabandën, projektet për zhvillimin e Mitrovicës, etj.

PAQJA: Si e vlerësoni gjendjen momentale në Mitrovicë?

Rexhepi: Në përgjithësi situata e sigurisë është e qetë, mirëpo tensionet janë të larta sidomos në fshatin Suhodoll, mes Suhodollit dhe Kroit të Vitakut, ku tash e sa ditë po i pengohet puna pronarit të shtëpisë, Ali Kadriut dhe këto shkaktojnë tensione dhe grumbullime të popullatës. Shpjegimi i përgjegjësve të sigurisë që thonë se ai ka të drejtë ta vizitojë shtëpinë por jo edhe ta rindërtojë atë, është i papranueshëm dhe paradoksal. Në lidhje me këtë unë kam pasur edhe një kontakt nëpërmjet telefonit me kryeadministratorin dhe ai është pajtuar se është gabim i UNMIK-it që ia ka ndaluar një gjë të tillë. Këtë tani e konfirmoi edhe zëdhënësi i UNMIK-it, i cili tha se Ali Kadriu ka të drejtë të punojë në shtëpinë e tij, pa pasur nevojë për kurrfarë autorizimi special. Ne shpresojmë se kjo do të realizohet por jemi të interesuar që kjo të mos bëhet me tensione dhe eskalim të situatës, por në mënyrë të qetë dhe në mënyrë institucionale.

UNMIK-u asnjëherë nuk e ka funksionalizuar mandatin në pjesën veriore të Mitrovicës

PAQJA: Sa ka qenë e vendosur administrata e UNMIK-it që ta kryejë misionin e saj në pjesën veriore të Mitrovicës?

Rexhepi: Unë nganjëherë e kritikoj UNMIK-un, por këtë e bëj për arsye se ata kanë bërë shumë pak sidomos për pjesën



Në administratën e UNMIK-it, edhe pas shkuarjes së Galuchit, kanë ngelur njerëz të cilët kanë bashkëpunuar ngushtë me të dhe kanë vepruar njëjloj si ai

veriore. Atje asnjëherë nuk e kanë funksionalizuar mandatin e tyre, kanë dështuar në vendosjen e rendit dhe ligjit. Shpeshherë nuk kanë pasur qasje të barabartë ndaj komuniteteve dhe zakonisht i kanë pranuar kërkesat e komunitetit serb, ndërsa i kanë injoruar kërkesat e shqiptarëve. Kjo shpeshherë ka shkakuar edhe revoltë, edhe humbje të kredibilitetit në popullatën shumicë shqiptare. Unë kam tërhequr vërejtjen edhe te kryeadministratori se nëse vazhdohet në këtë mënyrë, përgjegjësit rajonalë të UNMIK-it me veprimet e tyre ia dobësojnë edhe më tepër imazhin edhe ashtu shumë të ultë të UNMIK-it. Gjatë rikonfigurimit, presim (edhe pse nuk jam shumë optimist), që të zëvendësohen ata të cilët kanë qenë për një status quo, të cilët kanë bërë më shumë obstrukcion se sa që kanë ndihmuar në zhvillimin e proceseve pozitive dhe që të përmirësohet ky imazh ndaj UNMIK-it. Unë jam i bindur se kryeadministratori Zanieri është i përkushtuar që të ketë progres. Problemi është se në administratën e UNMIK-it, edhe pas shkuarjes së Galuchit, kanë ngelur njerëz të cilët kanë bashkëpunuar ngushtë me të dhe kanë vepruar njëjtë si zoti Galuchi dhe këto janë çështje që duhet ta shqetësojnë UNMIK-un.

PAQJA: Nëpërmjet deklaratave jeni treguar të vendosur edhe për çështjen e ujësjellësit të Suhodollit, që fillimisht ishte paraparë të kalonte nëpër lokalitetin e banuar me serbë,

ht po e pranojnë realitetin e ri

ndërsa tani e keni ndërruar projektin që po ju kushton shumë më shtrenjtë se ai fillestari?

Rexhepi: Është shumë e vërtetë se ai ujësjellës ishte në interes të të gjithë qytetarëve dhe u jepte mundësi edhe komunitetit serb që të kishte qasje në gypat e ri. Mirëpo ato ishin veprime të paarsyeshme të imponuara nga strukturat paralele komunale, jo nga banorët serb të Suhodollit. Ne kemi dashur që ajo të kalonte pa incidente. Kemi kërkuar të angazhohet edhe UNMIK-u edhe KFOR-i të cilët janë angazhuar, por nuk kanë pasur sukses dhe, më në fund, për t'u ikur tensioneve, kemi kërkuar një projekt alternativ, i cili siç e përmendet, kushton dyfish më tepër, por është më i gjerë sepse përfshin disa fshatra tjera. Mjetet për këtë janë siguruar nga Ministria për mbrojtjen e ambientit dhe planifikim hapësinor. Ne, fillimisht, kemi shpallur tenderin. Janë kryer të gjitha procedurat të cilat është dashur të shkojnë përmes ministrisë sepse është grant qeveritar dhe pritet që për dy-tri ditë të fillojë implementimi i këtij projekti. Shpresoj se deri në pranverë të vitit të ardhshëm këto fshatra do të furnizohen me ujë të pijshëm.

Komuniteti serb në Mitrovicë - peng i strukturave paralele të sigurisë

PAQJA: UNMIK-u dëshiron të mbetet edhe më tej në veri të Kosovës, ndërkohë ju keni deklaruar se ky institucion duhet ta kryejë misionin sa më parë, sepse do të ndikonte pozitivisht në integrimin e Mitrovicës. Si e mendoni ju procesin e integrimit?

Rexhepi: Procesi i integrimit nuk është i lehtë. Gjithkush që e njeh këtë realitet e di se ky është proces që do të zgjasë. Si parakusht është vendosja e rendit dhe ligjit. UNMIK-u deri më tani nuk ka arritur që ta vendosë rendin dhe ligjin. Natyrisht që mandati i UNMIK-ut nuk vjen nga institucionet tona, por vjen nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, dhe ata në procesin e rikonfigurimit kanë paraparë që në pjesë tjera

të Kosovës të jetë një prani simbolike, ndërsa në pjesën veriore të jenë edhe më tej prezentë. Këto janë çështje që duhet të diskutohen ndërmjet Nju Jorkut, Brukselit dhe institucioneve tona dhe është mirë që sa më parë të vendoset EULEX-i, i cili në radhë të parë është një mision teknik për gjyqësi, polici dhe dogana. Mendoj se ata kanë kapacitete të mëdha për vendosjen e rendit dhe ligjit dhe misioni i UNMIK-ut të përfundojë si një storie e cila ka qenë në pjesë të ndryshme të Kosovës mesatarisht i suksesshëm, por që në pjesën veriore ka dështuar në përmbushjen e misionit. Këtë dështim e kanë pranuar edhe vetë përfaqësuesit e UNMIK-ut. Prandaj, me shpalljen e pavarësisë dhe miratimit të kushtetutës së Kosovës, ka mbetur pak hapësirë për funksionimin e UNMIK-ut dhe është mirë që ai ta përfundojë misionin sa më shpejt.

PAQJA: UNMIK-u nuk ka arritur që të shthurë strukturat paralele, ndërsa EULEX-i ende nuk i ka shtrirë kompetencat në pjesën veriore. Çka keni bërë ju si qeveri lokale për t'i shthurur këto struktura?

Rexhepi: Ne nuk e kemi këtë kompetencë. Ne kemi qenë shumë të përkushtuar në mundësitë tona. Ju e dini që para proklamimit të pavarësisë ne e kemi caktuar një komitet gjithëpërfshirës për vlerësimin e situatës së sigurisë, i cili në kohën kur presionet ishin më të mëdha,

ka organizuar takime të përditshme, ndërsa në kohën kur situata ka qenë më stabile ka mbajtur takime javore, ose sipas nevojës. Ky komitet ka pasur për detyrë koordinimin në mes të strukturave përgjegjëse të sigurisë. Në të kanë qenë pjesëmarrës strukturat e KFOR-it, policisë së UNMIK-ut, policisë së Kosovës, TMK-së, drejtorive të ndryshme dhe institucioneve civile ndërkombëtare, me qëllimin e një informimi dhe koordinimi më të mirë. Kemi pasur shumë takime me banorë të pjesës veriore dhe mendoj se ne e kemi kryer mirë detyrën. Kemi ndihmuar shumë që situata të jetë e qetë, dhe të mos eskalojë dhuna ndëretnike. Prandaj, ne si qeverisje lokale, me mundësitë tona, kemi kontribuar mjaft që situata të mbetet e qetë. Këto janë mundësitë tona, ndërsa si e përmendët, megjithatë ekziston një konfuzion dhe një vakuum i rendit dhe ligjit në pjesën veriore të rendit dhe ligjit. EULEX-i ende nuk është vendosur, ndërsa UNMIK-u nuk ka arritur që për 8-9 vite të bëjë diçka dhe s'mund të pritet të bëjë më tepër në këto vitet e ardhshme. Prandaj, sa më shpejt të qartësohet ky pozicion dhe sa më shpejt të vendoset EULEX-i, bashkë me institucionet e Kosovës, aq më shpejt kjo pjesë e Kosovës do të jetë nën funksionin e rendit dhe ligjit. Pra edhe vetë komuniteti serb, në mënyrë konfidenciale, kërkon që të vendoset ligjshmëria, për arsye se ata janë peng të strukturave paralele të sigurisë.



Duhet të hulumtohen e të kapën kontrabandistët kryesorë që e mbajnë këtë monopol e jo vetëm distributorët

PAQJA: *Kakuk ka pranuar se UNMIK-u nuk po bën asgjë për ta parandaluar kontrabandën nëpërmjet veriut. Çfarë po bëni ju si qeveri lokale në këtë drejtim?*

Rexhepi: Nuk është kjo përgjegjësi e qeverisë lokale. Ne i bartim, në mënyrë indirekte, pasojat e kësaj kontrabande. Në bashkëpunim me ministrinë e brendshme, kemi dhënë informatat që kemi pasur në dispozicion lidhur me kontrabandën që po zhvillohet dhe shpeshherë kemi diskutuar në komitetin për siguri. Falë animimit që është bërë nga ana jonë, ministria e brendshme ka ndërmarrë veprime të caktuara. Janë bërë hulumtime të caktuara dhe janë arrestuar edhe disa kontrabandistë. Mirëpo, problemi ende nuk është zgjidhur sepse duhet të kapën ata që janë bartës të kontrabandës dhe jo kontrabandistët kushtimisht të nivelit të ulët, me disa dhjetëra apo qindra litra derivatesh. Problemi nuk është aty, por diku më lart. Për këtë arsye duhet të hulumtohen kontrabandistët kryesorë që e mbajnë këtë monopol, e jo vetëm distributorët.

PAQJA: *Gjatë takimit me Komisionin për Siguri të Kuvendit të Kosovës, ju keni deklaruar se minoriteti serb në veri ka filluar ta pranojë realitetin e ri politik në Kosovë. Ngjarjet e fundit në Mitrovicë po dëshmojnë të kundërtën. Cili është koment juaj?*

Rexhepi: Kjo është diçka që nuk shihet në shikim të parë, megjithatë, them me përgjegjësi se qytetarët serbë të Mitrovicës po e pranojnë gradualisht këtë realitet të krijuar. Ka raste kur drejtohen me kërkesë për dokumentacion të institucioneve tona dhe nga informatat që kemi, ekziston një bashkëpunim mes fqinjëve. Ata shpeshherë deklarojnë se do të ishin shumë më të lumtur që t'i kishin fqinjët e tyre shqiptarë se sa të jenë peng e strukturave paralele të sigurisë që merren me aktivitete kriminale. Ndërsa, aktivitetet e ndryshme të strukturave paralele të sigurisë dëshmojnë të kundërtën. Edhe pse ata janë pakicë, për momentin kanë një fuqi të madhe, sepse kanë përkrahje të madhe nga

Beogradi. Megjithatë neve na intereson se cili është opinioni i qytetarëve e jo i strukturave paralele, sepse ato duhet të shuhën sa më parë.

PAQJA: *Nga ky komision ju keni marrë një dokument sekret me 7 rekomandime për situatën e sigurisë... A keni filluar t'i zbatoni ato rekomandime?*

Rexhepi: Nuk ka diçka mistike në këtë dokument. Janë këto kërkesa të përgjithësuara se duhet të vendoset rendi dhe ligji, të vendosen doganat, të rifillojë puna e gjyqit dhe nuk ka diçka specifike që implementohet nga komuna. Ishte thjesht një informim i punës së komitetit për siguri dhe kjo do të diskutohet në një nga seancat e parlamentit, ku do të dilet me rekomandime të përgjithësuara lidhur me situatën e sigurisë.

Edhe sikur të isha tani kryeministër, nuk besoj se do të mund të bëja më tepër sepse mundësitë megjithatë janë të kufizuara

PAQJA: *Mitrovica për momentin është e ndarë dhe kompetencat e Kuvendit Komunal shtrihen vetëm deri te ura e Ibrit. A mendoni se po të ishit tani kryeministër do të mund të bënit më shumë për këtë qytet?*

Rexhepi: Është kushtimisht kjo që po thoni deri në urën e Ibrit. Vetëm sa për informim iu them se kompetencat e komunës të cilën e udhëheq shtrihen edhe në pjesën veriore, në disa fshatra. Ndërsa pjesa veriore urbane e qytetit, për momentin, administrohet nga UNMIK-u me një këshill multi-etnik i cili nuk ka qenë funksional që 4-5 vite, si dhe nga strukturat paralele komunale serbe të dala nga zgjedhjet ilegale të 11 majit, të cilat janë jolegale edhe për UNMIK-un, edhe për institucionet tona. Unë dua të jem i ndërgjegjshëm. Kam qenë edhe në postin e kryeministrit, por atëherë ka qenë një kohë krejt tjetër kur mundësitë kanë qenë më të vogla. Mirëpo edhe sikur të isha tani kryeministër, nuk besoj se do të mund të bëja më tepër sepse mundësitë megjithatë janë të kufizuara. Dua të jem i përgjegjshëm se qeveria, në bashkë-

punim me faktorin ndërkombëtar, është duke bërë çka është e mundur që të vendoset rendi dhe ligji. Vlerësoj se duhet të bëhen projekte të ndryshme edhe për pjesën veriore dhe të krijohen parakushte për integrimin gradual të serbëve.

PAQJA: *Si kryetar i asociacionit të Komunave të Kosovës, a keni ndonjë strategji se si t'i futni nën këtë ombrellë komunat e udhëhequra nga serbët?*

Rexhepi: Fatkeqësisht problemi nuk është te strategjia por te realizimi ose implementimi i saj, për arsye se statuti i asociacionit të komunave të Kosovës është shumë i qartë. Ky asociacion nuk është mono-etnik, por është për të gjitha komunat. Andaj, është mirë që komunat e udhëhequra nga serbët t'i bashkëngjiten këtij asociacioni për të përfutur një lloj si komunat e tjera. Mirëpo, për fat të keq ata refuzojnë edhe pse dera është e hapur dhe ftesat ju bëhen për çdo takim ose aktivitet, mirëpo ata nuk i përgjigjen ftesës. Ata kanë formuar një union virtual të komunave me shumicë serbe dhe kemi informacion se kanë aplikuar të pranohen ndaras si asociacion në Këshillin e Evropës. Ne ua kemi bërë të qartë përfaqësuesve të Këshillit të Evropës se do të ishte një gabim i madh nëse pranohet një gjë e tillë sepse, me këtë pranim ata do të favorizonin një ndarje etnike. Ata kanë një statut ku parashohin vetëm komunat me shumicë serbe dhe bashkëpunimin kryesor me Beogradin që është plotësisht e papranueshme. Unë shpresoj se nuk do ta bëjnë një gabim të tillë, që ta legalizojnë një asociacion të tillë për arsye se me atë rast do t'i prishnin raportet edhe ashtu jo aq të mira të asociacionit të komunave të Kosovës me Këshillin e Evropës, ku ne kemi rolin e vëzhguesit, për shkak të qëndrimeve të tyre. Ata janë një institucion i pa reformuar me të cilin kemi pas kundërshtime për arsye se në çdo ftesë që është bërë për Asociacionin e komunave të Kosovës, shpeshherë ftesa është bërë si komuna të Serbisë, gjë që ka qenë plotësisht e papranueshme. Ne ua kemi tërhequr vërejtjen dhe kemi thënë se përkundër interesit që të jemi pjesë të këtyre strukturave, megjithatë një ftesë të tillë kurrë nuk do t'i përgjigjemi. Ata e kanë marrë

parasysh këtë dhe presim përgjigjen e tyre që të na drejtohen si Asociacion i komunave të republikës së Kosovës, ose vetëm si Kosovë, pa ndonjë preambulë tjetër deri në momentin kur edhe ata të reformohen në atë drejtim. Ky është pozicioni momental sa i përket raportit të komunave me shumicë serbe. Ne do të ishim të lumtur që edhe ata të jenë pjesë e asociacionit të komunave të Kosovës, sepse ky asociacion nuk ka karakter monoetnik por është multietnik, konform realitetit në Kosovë.

PAQJA: Cilat janë planet e qeverisë lokale për t'i joshur investitorët e huaj në Mitrovicë?

Rexhepi: Dihet se Mitrovica në të kaluarën ka qenë qyteti më i zhvilluar industrial. Këtu ka pasur një standard më të mirë të qytetarëve, se sa në pjesët e tjera, por ju e dini se pas grevës së 3 shtatorit kur regjimi i Milosheviqit i ka larguar punëtorët me dhunë nga puna, shumica e këtyre kapaciteteve prodhuese janë ndalur, e sidomos tash pas luftës kur ato ende nuk janë vënë në funksion. Situata më e vështirë ekonomike është në Mitrovicë edhe për një arsye se njerëzit nuk kanë qenë të orientuar drejt privatizimit, nuk kanë

qenë të përgatitur sepse ata kanë pasur një standard solid dhe një punësim solid, prandaj këto pasoja janë reflektuar më së shumti në Mitrovicë. Ne, si qeveri komunale, mund të bëjmë atë që është në kompetencën tonë, që të krijojmë një ambient më të favorshëm për investime, të mos ketë burokraci të tepruar. Në përfundim është plani hapësinor dhe i zhvillimit që është si parakusht për investime dhe për një legalitet në këtë drejtim. Po ashtu kemi kërkuar nga niveli qendror që të ketë më shumë grante. Kjo është duke u realizuar dhe për këtë vit shuma e granteve nga niveli qendror arrin në 10 milion euro, që është shumë më e madhe se buxheti i komunës së Mitrovicës. Shihet se ka filluar një ringjallje, mirëpo që të kemi zhvillim ekonomik duhet që të ketë investime, kryesisht private, pse jo edhe të jashtme. Ne, në konferencën e donatorëve që është mbajtur në muajin korrik në Bruksel, kemi identifikuar 115 projekte, prej të cilave një të tretat kanë karakter multietnik. Kemi qenë më optimist se me këto projekte multietnike do të thithim më tepër mjete, por zotimi i këtyre mjeteve nga shtete të ndryshme dhe nga unioni evropian duhet të kalojë nëpër disa procedura. Këto mjete kalo-

Me shpalljen e pavarësisë dhe miratimit të kushtetutës së Kosovës, ka mbetur pak hapësirë për funksionimin e UNMIK-ut dhe është mirë që ai ta përfundojë misionin sa më shpejt.

jnë nëpërmjet institucioneve qendrore. Ne jemi të gatshëm që me projekte konkrete të aplikojmë në mënyrë që të thithim sa më shumë donacione që është e mundur, qoftë në infrastrukturë, qoftë në një inkubator të biznesit, në mënyrë që të krijohen kushte për investime të ndryshme në sferën ekonomike dhe që gradualisht ta zbusim papunësinë. Ka projekte edhe në lëmin e agrikulturës, edhe pse Mitrovica nuk ka shumë tokë punuese, por ka terrene të përshtatshme për blegtori, për prodhime të ndryshme të qumështit, mishit etj. Ka edhe zona të ndryshme që mund të shfrytëzohen si turizëm veror dhe dimëror, sidomos në malësinë e Shalës së Bajgorës. Mirëpo, megjithatë ne e bartim pasojën e një zhvillimi të ngadalshëm ekonomik në tërë Kosovën. ■



Buxheti 2009 më i lartë për 15 %

Arsimi, infrastruktura dhe energjetika së bashku me rendin dhe ligjin do të jenë fushat kryesore të cilat do t'i thithin paratë e buxhetit 2009 dhe si të tilla janë identifikuar si fusha prioritare, duke marrë parasysh rëndësinë e tyre të padiskutueshme në zhvillimin dhe stabilizimin afatgjatë të republikës së Kosovës.



Sead UJKANI

Në fillim të këtij muaji, në mbledhjen e saj të radhës, qeveria e Kosovës ka miratuar projektbuxhetin për vitin 2009, i cili është paraparë të jetë 1 miliardë e 430 milionë. Në krahasim me vitin paraprak, ky buxhet shënon një rritje prej rreth 15 për qind.

Arsimi, infrastruktura dhe energjetika së bashku me rendin dhe ligjin do të jenë fushat kryesore të cilat do t'i thithin paratë e buxhetit 2009 dhe si të tilla janë identifikuar si fusha prioritare, duke marrë parasysh rëndësinë e tyre të padiskutueshme në zhvillimin dhe stabilizimin afatgjatë të republikës së Kosovës.

80 milionë euro hua për investimet kapitale në KEK

Në përgjithësi janë identifikuar tri qëllime të cilat gëzojnë përqendrimin kryesor për realizimin e të cilave do punohet dhe kështu janë vendosur si objektiva të cilat mëtohen të arrihen me buxhetin përkatës.

Këto tri qëllime janë: Përmirësimi i cilësisë së standardit jetësor të qytetarëve të Republikës së Kosovës; vënia e Kosovës në rrugën e rritjes së qëndrueshme dhe zhvillimit ekonomik; dhe përsheptimi i anëtarësimit të vendit në FMN dhe Bankën Botërore.

Qeveria e Kosovës në projektbux-

hetin për vitin e ardhshëm ka paraparë që një pjesë të shpenzimeve të mbahen si rezervë, me qëllim që të përdoren në rrethana të paparashikuara. Një rezervë e tillë stabilizuese është menduar të përdoret në veçanti për tejkalimin e krizave eventuale që mund të përfshijnë Kosovën.

E veçantë e këtij projektbuxheti është se është menduar të jetë buxheti i fundit i cili në projektimin e shpenzimeve të tij përmban ndarjen e mjeteve për subvencione për sektorin e energjisë, duke marrë parasysh faktin mbi gjendjen e rëndë të mëtutjeshme të këtij sektori dhe në këtë kontekst edhe të shpresës për një fuqizim dhe përmirësim të dukshëm të tij gjatë vitit 2009. Lidhur me këtë, Qeveria e Kosovës ka aprovuar 80 milionë euro si hua për investimet kapitale në KEK.

Kryeministri Thaçi, me rastin e miratimit të buxhetit, ka theksuar se Qeveria e vendit ka bërë konsultime të shumta me partnerët qeverisës dhe spektrin e gjerë të partive politike dhe shoqërisë civile me të vetmin qëllim, që buxheti për vitin 2009 t'u përgjigjet nevojave të qytetarëve të vendit dhe t'ia lehtësojë Kosovës rrugën drejt prosperitetit afatgjatë dhe ballafaqimit me sfidat e së ardhmes.

Ndërsa Ministri Ahmet Shala, nga ana e tij, ka theksuar se struktura e projektimit të këtij buxheti është bërë në harmoni të plotë me prioritetet bazë, të vendosura nga qeveria në fillim të punës së saj, përkatësisht në pajtim me Planprogramin veprues të saj.

"Ky buxhet adreson problemet, sfidat dhe të ardhmen e popullit të Kosovës

dhe shtetit të pavarur të Kosovës, andaj ky buxhet është historik si në aspektin përmbajtësor, po ashtu edhe për nga vizioni" - ka thënë Shala.


Rritja ekonomike për vitin 2009 pritet të jetë rreth 6 për qind

Gjatë prezantimit të buxhetit për vitin e ardhshëm, ministri Shala ka theksuar se rritja ekonomike për vitin 2009 pritet të jetë rreth 6 për qind. Kjo rritje, sipas tij, do të vijë si rezultat i rritjes së investimeve dhe eksporteve dhe për shkak se shpenzimet operative kapin vlerën prej 661 milionë euro, shifër e cila është në pajtim me rekomandimet e dhëna nga FMN-ja.


Një element mjaft i rëndësishëm, që do të shikohet në të ardhmen, do të jetë ai se si do reflektohet efekti i rritjes së pagave, gjë për të cilën edhe FMN ia ka tërhequr vëmendjen Qeverisë së Kosovës, duke i rekomanduar që të këtë kujdes në këtë drejtim dhe të orientohet me shumë drejt zhvillimi të sektorit privat, përkatësisht ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si katalizatorë të zhvillimit ekonomik.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në fjalën e tij para kabinetit qeveritar, e ka vlerësuar si çast historik miratimin e projektbuxhetit. "Ky projektbuxhet është i veçantë për faktin se është rasti i parë që një buxhet hartohet nga qeveria sovraane e shtetit më të ri në botë dhe në harmoni të plotë me Kushtetutën e Kosovës dhe, si i tillë, ky projektbuxhet paraqet një pikënisje drejt misionit të rritjes dhe zhvillimit afatgjatë të vendit në përgjithësi" - ka thënë Thaçi. ■

Shpenzimet buxhetore 2008



Shpenzimet buxhetore 2009



Paqartësi, mosmarrëveshje dhe hezitime për zgjedhjet në Kosovë

Zyra Civile Ndërkombëtare, duke i parë vështirësitë për arritjen e një konsensusi për mbajtjen e zgjedhjeve, ka filluar t'i zbusë qëndrimet e saj. Kjo zyrë, së fundi, ka deklaruar se: "së paku zgjedhjet lokale duhet të mbahen sipas zgjidhjes së Pakos së Ahtisarit"



Sabri HALILI

Në opinionin e gjerë, madje edhe në qarqet intelektuale të Kosovës, mbretëron një paqartësi lidhur me faktin se cila duhet të jetë baza ligjore-politike, për mbajtjen e zgjedhjeve dhe cila duhet të jetë korniza kohore për mbajtjen e tyre.

Nga kjo paqartësi një gjë është e qartë. Zgjedhjet e ardhshme në Kosovë duhet të organizohen për herë të parë në bazë të ligjit të ri zgjedhor dhe nga stafi vendor. Por është e paqartë, madje ka shumë dyshime për faktin nëse stafi vendor është i gatshëm të organizojë dhe menaxhojë zgjedhjet pa përkrahjen e OSBE-së.

Konfuzion apo...?

Sipas pakos së Ahtisarit, parashihet se "jo më vonë se nëntë muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje, Kosova do të organizojë zgjedhje të përgjithshme dhe lokale, në pajtim me kushtet e kësaj marrëveshje...". Kjo pikë, që mund të shihet edhe si pikë orientuese për zgjedhjet e ardhshme, tashmë po i sjell probleme të mëdha institucioneve të Kosovës, por edhe Zyrës Civile Ndërkombëtare, e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen e implementimit të Pakos së Ahtisarit.

Në bazë të kërkesave që dalin nga kjo Pako, Parlamenti i Kosovës tashmë ka nxjerrë ndër të tjera edhe: Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale. Këto ligje janë miratuar në Parlament, pa ndonjë kundërshtim. Sipas të tre ligjeve në fjalë, kryetarët e komunave, gjegjësisht

anëtarët e asambleve komunale, zgjidhen për çdo katër vjet.

Edhe Kushtetuta, neni 66, parashihet se Kuvendi i Kosovës ka mandat 4 vjeçar. Sipas këtij neni, zgjedhjet vijuese mbahen 30 ditë para përfundimit të mandatit.

Në këtë bazë, së paku deri tashti, mbështet pozita, gjegjësisht qeveria dhe presidenca. Presidenti i Kosovës ka deklaruar disa herë për opinionin se "duhet të ruhet stabiliteti institucional", duke mos kundërshtuar mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve lokale, mandati i të cilave përfundon në vitin 2009. Zrytarët e presidencës kanë deklaruar se zgjedhjet do të mbahen sipas përcaktimeve kushtetuese, gjegjësisht sipas marrëveshjeve paraprake të partive politike.

Me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë parashihet që Presidenti i Kosovës i shpall zgjedhjet 6 muaj para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve. Sipas kësaj logjike, zgjedhjet e ardhshme, nëse mbahen në tetor, duhet të shpallen së paku në maj të vitit 2009.

Zyra Civile Ndërkombëtare, duke i parë vështirësitë për arritjen e një konsensusi për mbajtjen e zgjedhjeve, ka filluar t'i zbusë qëndrimet e saj. Kjo zyrë, së fundi, ka deklaruar se: "së paku zgjedhjet lokale duhet të mbahen sipas zgjidhjes së Pakos së Ahtisarit". Kjo arsyeohet me faktin se me krijimin e komunave të reja do të kemi edhe ndryshime të kufijve komunalë, sidomos në disa komuna që efekton ndarja e re, por edhe për faktin se Pakoja e Ahtisarit parashihet zgjedhje pas 9 muajve. Kjo zyrë nuk këmbëngul që të mbahen edhe zgjedhjet

e përgjithshme, por lihet mundësia për "marrëveshje ndërmjet partive politike".

Pra, këtu është lënë hapësirë e madhe për interpretime të ndryshme të një dokumenti të vetëm, i cili ka qenë bazë për nxjerrjen e ligjeve të cilat kanë paraparë zgjedhje të tjera për këtë proces.

Qëndrimet e opozitës dhe dilemat e ndërkombëtarëve

Kërkesat e opozitës shkojnë vetëm në një drejtim. Baza e këtyre kërkesave merret vetëm Pakoja e Ahtisarit, gjegjësisht mandati dyvjeçar i pushtetit lokal. Ajo nuk bazohet në zgjedhjet ligjore, të cilat kanë paraparë zgjedhje në afat tjetër.

Këto kërkesa, sa afrohet fundi i vitit bëhen edhe më të zëshme. Bashkësia ndërkombëtare nuk ka ndonjë opinion të qartë lidhur me këto kërkesa, e në këtë drejtim as vetë opozita nuk është aq unike dhe e koordinuar.

OSBE-ja, gjegjësisht ish-Departamenti i Zgjedhjeve, që deri tashti i ka organizuar dhe menaxhuar të gjitha zgjedhjet në Kosovë, duket të ketë një rol shumë indiferent, edhe pse ka një interes shumë të madh për të pasur një organizim dhe menaxhim dinjitoz të zgjedhjeve në Kosovë. Në raportin e OSBE-së me seli në Vjenë, për zgjedhjet e fundit në Kosovë, janë adresuar kritika serioze ndaj misionit të saj në Prishtinë, për faktin se nuk ka bërë sa duhet për ngritjen e kapaciteteve humane, për trupën vendore zgjedhore, gjë për të cilën ka qenë e autorizuar.

Çështjet që shqetësojnë

Njohësit e këtyre strukturave e dinë se vërtet misioni i OSBE-së në Prishtinë, së bashku me disa struktura vendore, i kanë rrënuar në vazhdimësi gjithë ato kapacitete që dikur i ndërtauan dhe i ngritën vetë me mund të madh.



Është e qartë se, në këtë drejtim, ka shumë mangësi dhe në këto mangësi ka shumë shkaqe objektive e subjektive, të cilat kërkojnë analizim dhe investigim më të thellë dhe për të cilat partitë politike nuk kanë informacione të duhura.

Pse partitë politike kanë informacione të mangëta? Përgjigjen për këtë duhet ta kërkojnë te përfaqësuesit e tyre në KQZ. Çështje tjetër që kërkon përgjigje imediate është roli i këtyre përfaqësuesve në gjithë këto mangësi, gjegjësisht në këtë nivel shumë mjeres në të cilën ndodhet aktualisht KQZ-ja, si e vetmja trupë legjitime për organizimin dhe menaxhimin e zgjedhjeve në Kosovë.

Pikërisht për këtë, në zgjedhjet e fundit, të trefishta në Kosovë, OSBE sërish e riktheu autoritetin e vet dhe pothuajse i organizoi në tërësi zgjedhjet. OSBE angazhoi staf të nevojshëm shtesë nga shtete të ndryshme, vetëm për periudhën zgjedhore, duke e hedhur në periferi stafin vendor, i cili nuk arriti të konsolidohet asnjëherë që nga themelimi i Sekretariatit të KQZ-së. Arsye kryesore e kësaj gjendje ishte menaxhimi i dobët i gjithë këtij procesi nga menaxherët vendor, gjegjësisht nga KQZ, por edhe për shkak të interesave të ngushta të stafit të misionit të OSBE-së në Kosovë, për çka edhe ka marrë kritika të shumta nga Vjena.

Këto janë çështjet thelbësore që duhet t'i shqetësojnë strukturat politiko-shoqërore të Kosovës, jo vetëm ato që kërkojnë mbajtje sa më të shpejtë të zgjedhjeve. Ata nuk kanë ide se sa është e përgatitur trupa vendore për organizimin dhe menaxhimin e zgjedhjeve, pa ndihmën e OSBE-së. Ky ka qenë dhe do të jetë fokusi i kritikave të OSBE-së drejtuar misionit të tij në Kosovë. Partitë politike duhet të kërkojnë informacione nga përfaqësuesit e tyre në KQZ dhe më pas të bëjnë përllogaritje afatgjate të procesit zgjedhor në Kosovë, si dhe të kërkojnë llogaridhënie për gjendjen në të cilën ndodhet trupa vendore zgjedhore, pikërisht nga përfaqësuesit e tyre në KQZ, nëse nuk kanë raportuar drejtë për këtë gjendje. ■

Korrespondencë nga Shkupi

Maqedonia pos

Zgjedhja e presidentit të ri amerikan, Barak Obama, është edhe një megaproblem që e ka goditur Maqedoninë. Para zgjedhjeve, maqedonasit ishin për fitoren e republikanit McCain, por kur kjo nuk u realizua, vërehet qartë dëshpërimi. Siç dihet, maqedonasit anonin nga kandidati republikan me shpresën e mosndryshimit të kursit politik ndaj Maqedonisë. Barak Obama, qysh gjatë fushatës së tij parazgjedhore, kishte shprehur qëndrimin e tij në përkrahje të Greqisë.



Avni AVDIU

Do të kalojë edhe ky vit e Maqedonia do të ngelë edhe më tej pa shanse për integrimet euroatlantike. Ndër shumë arsye që e largojnë vendin nga ky pikësypnim i dëshiruar, dy janë kryesoret: moszgjidhja e kontestit me emrin dhe zvarritja e zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit. Kriza rreth emrit është krizë e imponuar, kurse kriza me shqiptarët është krizë e vetëprodhuar. Në vazhden e problemeve, është në interes të vendit ta ketë një problem më pak. E çliruar nga një problem, Maqedonia ndoshta do të gjejë fuqi dhe energji për t'u shkarkuar edhe nga problemet e tjera. Zaten modeli i disa shteteve perëndimore, ka dëshmuar se kur një vend multietnik krijon hapësirë të barabartë në të gjitha sferat, për të gjitha etnitë, atëherë ai vend ka stabilitet të qëndrueshëm. Maqedonisë i nevojitet vetëm vullneti i mirë politik për të arritur këtë.

Maqedonasit duhet të bashkëpunojnë më tepër me faktorin shqiptar

Megjithatë sado i vështirë të duket hendeku i shkaktuar rreth krizës së emrit, prapëseprapë nga një analizë më e thellë, në sfond dalin më tepër improvizime se sa pengesa reale. Administrata amerikane në largim ka qenë mjaft e interesuar për ta nxjerrë Maqedoninë nga ky qorrsockak. Ajo përmes ndërmjetësuesit Metju Nimic ka ofruar propozim-zgjidhesh të ndryshme, ndaj të cilave pala maqedonase nuk është treguar konstruktive. Është e qartë se është ndodhur në një pat-pozicion për shkak të cenimit të identitetit kombëtar, por nga ana tjetër është nga gjuha diplomatike se çdo kompromis për

palët shkakton dhimbje. Me fjalë tjera s'ka tërhiq perin e mos e këput. Në këtë kontekst, propozimi që u është bërë palëve që emri Maqedoni në ndryshim e sipër të bartë edhe shtojcën gjeografike 'Veriore', nuk ka qenë edhe aq i disfavorshëm për vendin. Madje-madje menduar më 'open minded', kjo zgjidhje do ta linte Greqinë me gishta në gojë. Meqë Maqedonia nuk ka rrugëdalje tjetër përpos se të bëjë lëshime, gjithsesi ky lëshim do të ishte më me pak dhimbje. Çdo zgjidhje tjetër përpos "Republika Veriore e Maqedonisë", do të ishte zgjidhje e kënaqshme për grekët dhe e dhimbshme për maqedonasit. Kjo (emri "Republika Veriore e Maqedonisë") në mënyrë implicite do të shprehte gjithë atë që grupet radikale maqedonase e pretendojnë: kompaktësinë territoriale të Maqedonisë antike. Me anë të saj do të kuptohej ashtu si në rastet e tjera (Koreja Veriore, Gjermania Lindore etj) se dikur ka ekzistuar një tërësi territoriale e Maqedonisë, tashmë e ndarë. Kur kihat parasysh se shqiptarët po ashtu janë unik në mbrojtjen e emrit Maqedoni, atëherë maqedonasit duhet të bashkëpunojnë edhe më tepër në këtë drejtim me faktorin shqiptar. Zaten shqiptarët kanë arsye të fuqishme të qëndrojnë pas këtij pozicioni, sepse siç theksonte edhe Naim Frashëri në një varg të tij 'maqedonasit ishin fis ilir'. Mu për këtë, faktori shqiptar nuk mund të abstraktohet në këtë moment, sepse ky problem është problem i përbashkët. Mirëpo pala maqedonase nuk do të kishte forcë morale të kërkonte angazhimin e shqiptarëve, përderisa vazhdon edhe më tej me zvarritjen e qëllimshme të zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit. Pra lipset një kompaktësi e brendshme për një zë më të fuqishëm në bisedimet e ardhshme lidhur me kontekstin e emrit. E kjo kompaktësi nuk mund të arrihet përderisa shqiptarët

stobama

vazhdojnë të mbeten të pakënaqur me të drejtat e tyre.

Maqedonia rrezikon të humbë mbështetësin kryesor - SHBA-në

Po ashtu, një megaproblem që e ka goditur Maqedoninë është edhe zgjedhja e presidentit të ri amerikan, Barak Obama. Para zgjedhjeve, maqedonasit ishin për fitoren e republikanit McCain, por kur kjo nuk u realizua, vërehet qartë dëshpërimi. Siç dihet, maqedonasit anonin nga kandidati republikan me shpresën e mosndryshimit të kursit politik ndaj Maqedonisë. Barak Obama qysh gjatë fushatës së tij parazgjedhore kishte shprehur qëndrimin e tij në përkrahje të Greqisë. Zaten ai ishte mbështetur edhe nga lobi grek në Amerikë. Së këtejmi, natyrshëm ekziston droja se Obama do të shprehët, ashtu sikurse presidenti francez Nikolla Sarkozy, se në kontestin maqedono-grek është në krah të Greqisë. Pra, Maqedonia rrezikon të humbë mbështetësin kryesor - SHBA-në. Dhe kjo definitivisht do të thotë që vendi duhet të fillojë të mendojë për linjat deri ku mund të lëshohet pe gjatë kompromisit. Mirëpo, në vend të kësaj, mënyra se si kanë vendosur strukturat vendimmarrëse t'i menaxhojnë këto kriza nuk është aspak

me vend. Çështje më e keqja, politikanët maqedonas janë të përçarë dhe çështjen e emrit e përdorin më shumë për poenë politikë. Presidenti Cërvenkovski shkarkoi këto ditë nga detyra negociatorin maqedonas Dimitrov, duke ngjallur pakënaqësinë e partisë kundërshtare në pushtet VMRO-DPMNE-s. Nga ana tjetër me fitoren e Obamës, duket se këmbënguljes së kryeministrit po i vjen fundi. Ai e shfrytëzoi këtë çështje për ngritjen e kredos së tij politike, duke siguruar me shumicë dërrmuese edhe një mandat prej katër vitesh. Gruevski është zotuar se së fundi do të organizojë edhe referendum për çështjen e emrit, ndonëse gjithnjë e më tepër shtohen zërat që e kundërshtojnë këtë mënyrë zgjidhjeje. Maqedonia ka kohë edhe pak, deri në janar, gjersa akoma nuk i ka përfunduar mandati presidentit Bush. Përndryshe, ajo çfarë mund të nxjerrë tani, hipotetikusht, do të mund të ishte shumë më pozitive se sa ajo që mund të pasojë më vonë. Gjendjen e bën edhe më të rënduar obstrukcioni i palës greke. Greqia nga pozicioni i saj vepron me komoditet, sepse asaj nuk i ngutet. Ajo që pëson është Maqedonia dhe nëse ky vend nuk ndërmer hapa konkretë për të dalë nga situata e krijuar, atëherë gjasat për prosperitet duken të pakta. Në këtë mes, pozita më e vështirë është ajo e popullit. Ai mund ta pësojë rëndë ekonomikisht nga izolimi i mëtutjeshëm. Për momentin, ai i është lënë stuhisë dhe, rrjedhimisht, mund të

pritet që rishtas të dalin nga kontrolli turma të çorganizuara, të cilat ndjekin logjikën serbe me parulla antiperëndimore dhe me sulme ndaj ambasadave. "NATO-n e japim, emrin s'e japim" - ishte një ndër parullat që u përdor gjatë disa tubimeve nacionaliste. Mirëpo harrohet se NATO-ja ka aq fuqi sa që të detyron ta japësh emrin, e ta kërkojë sërish NATO-n, ndonëse atëherë ajo mund të hidhërohet e të mos vijë. Pastaj gjuajtja ndaj ambasadave me gurë është metodë e huazuar nga huliganët serbë në Beograd. Së këtejmi, me gjuajtjen e gurëve, grupet e caktuara maqedonase dëshmuuan se ndjekin 'logjikën' serbe të shprehjes së revoltës. Disa maqedonas ua mësynë ambasadave edhe atëherë kur bombardojë Serbia për shkak të gjenocidit në Kosovë dhe kjo nuk i ka ikur nga syri Evropës. Sikur të zgjidhej ndonjëherë ndonjë çështje me gurë, tashmë moti do të ishte harruar çështja palestineze. Dhe...nëse do të duhej të gjuhej ndonjë ambasadë ndonjëherë me gurë, atëherë atë do ta meritonte ambasada ruse, kineze, spanjolle, rumune etj, por shqiptarët në këtë kontekst dhanë provimin e tolerancës qytetëruese dhe atë nuk e bënë. Politikanët dhe populli në Maqedoni duhet të vetëdijesohen se çfarë do të thotë ngecja në integritet euroatlantike. Nëse Maqedonia do zgjidhje konstruktive për emrin, atëherë i duhet taktikë, strategji dhe diplomaci vizionare, e jo përplasje e brendshme, moslëshim pe dhe huliganizëm. ■



Dështim i radhës i UNMIK

Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bajram Rexhepi, për ta argumentuar njëanshmërinë e UNMIK-ut, ka përmendur rastin e “Lagjes së Boshnjakëve” në veri të qytetit, ku gjatë këtyre viteve të pasluftës, serbët kanë ndërtuar banesa shumëkatëshe, me ose pa leje të UNMIK-ut, ngjitur me pronat e shqiptarëve dhe pa i pyetur fare ata. Ndërsa në rastet kur shqiptarët fillojnë të punojnë, madje edhe të meremetojnë shtëpitë e tyre, zyrtarët e UNMIK-ut thonë se duhet kërkuar pëlqimi i serbëve



Florije ADEMI

MITROVICË, NËNTOR

Çdo nismë për realizimin e ndonjë projekti, qoftë meremetim i pronave private të shqiptarëve apo projekte me interes për të gjithë banorët e veriut të Mitrovicës, ballafaqohet me probleme të ndryshme. Krahas strukturave paralele serbe, edhe UNMIK-u vazhdon të jetë pengesë, duke ju dalë jo rrallë në mbështetje kërkesave të serbëve.

Kështu ndodhi edhe me rastin e tentimit të meremetimit të shtëpive të Ali Kadriut, që ndodhen ndërmjet fshatit Suhadoll dhe lagjes veriore “Kroi i Vitakut”, dikur të banuar kryesisht nga shqiptarë. Zyrtarët e UNMIK-ut urdhëruan ndërprerjen e punimeve me arsyetimin se nevojitet një leje e posaçme për meremetim!

“Unë nuk kam çka kërkoj leje nga UNMIK-u, sepse nuk po ndërtoj objekt të ri, por po meremetoj shtëpinë që ekziston”, - thoshte pronari Kadriu.

Serbët e kanë shfrytëzuar arritjen

e policisë së UNMIK-ut në vendin e ngjarjes dhe janë grumbulluar që të kundërshtojnë fillimin e punëve. Nderkaq, në anën tjetër, shqiptarët kanë dalë që ta përkrahin bashkëkombësin e tyre Kadriun. Kjo ka rezultuar me përleshje ndërmjet këtyre dy grupeve të qytetarëve, si pasojë e së cilës ka pasur edhe disa të lënduar.

Rexhepi kritikon UNMIK-un

Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bajram Rexhepi e kritikoi UNMIK-un për urdhrin dhënë policisë për ndalimin e punëve në meremetimin e shtëpive, që u bë shkak i kësaj përleshje ndëretnike dhe tensionit të situatës së sigurisë.

Sipas tij, nga UNMIK-u është kërkuar të jetë i paanshëm, meqë deri më tani mitrovicasit kanë pasur një përvojë jo të mirë me ta.

Për ta argumentuar njëanshmërinë e UNMIK-ut, ai përmend rastin e “Lagjes së Boshnjakëve” në veri të qytetit, ku gjatë këtyre viteve të pasluftës, serbët kanë ndërtuar banesa shumëkatëshe, me ose pa leje të UNMIK-ut, ngjitur me pronat e shqiptarëve dhe pa i pyetur fare ata. Ndërsa në rastet kur shq-

iptarët fillojnë të punojnë, madje edhe të meremetojnë shtëpitë përbrenda, zyrtarët e UNMIK-ut thonë se duhet kërkuar pëlqimi i serbëve.

“Kjo praktikë duhet të ndërpritet. UNMIK-u duhet ta kuptojë mandatin e vet. Në veri duhet të fillojë funksionimi i rendit dhe ligjit” - thotë Rexhepi.

Por Ali Kadriu, shkon çdo ditë në shtëpinë e tij të boshatisur, pa dyer dhe pa dritare, ku vetëm mund të qëndrojnë por jo edhe të punojnë, ndonëse dëshiron ta meremetojë atë dhe të kthehet të jetojë në të dhe thotë se nuk tërhiqet nga ky vendim edhe sikur të vdesë.

Vlen të theksohet se qeveria e Serbisë i ka ofruar Ali Kadriut për dy shtëpitë 1.2 milion euro, por ai nuk i ka shitur. Vlerësohet se kjo shumë e madhe i është ofruar për arsye se këto dy objekte ndodhen në pikën më strategjike në qytetin e Mitrovicës.

Incidenti në afërsi të shtëpive të tij, e shtyri Kuvendin Komunal të Mitrovicës që në javën e parë të nëntorit të mbajë një seancë të jashtëzakonshme, ku janë nxjerrë katër konkluzione të cilat iu adresuan instancave më të larta vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë, për të ndihmuar Mitrovicën në mënyra të ndryshme. Njëpërmjet këtyre konkluzioneve, është kërkuar respektimi i rendit dhe ligjit për të gjithë, garantimi i kthimit të familjeve të zhvendosura përmes formimit të një fondi për rindërtim dhe kthim të qëndrueshëm dhe nevojën që, në këtë fazë, secila Ministri, me dedikim për pjesën veriore, të realizojë nga një projekt kapital për fushën e vet.

Banorët e Suhadollit në përkrahje të Ali Kadriut

Nderkaq, kryesia e fshatit Suhadoll, përmes një letre u dha ultimatum institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, politike dhe atyre të sigurisë, të ndër-

Konkluzionet e Kuvendit të Komunës

- ◆ Respektimi i rendit dhe ligjit për të gjithë.
- ◆ Garantimi i kthimit të familjeve të zhvendosura përmes formimit të një fondi për rindërtim dhe kthim të qëndrueshëm.
- ◆ Kuvendi i Komunës konsideron se është e rëndësishme që, në këtë fazë, secila Ministri, me dedikim për pjesën veriore, të realizojë nga një projekt kapital për fushën e vet.
- ◆ Kuvendi i Komunës dhe institucionet qendrore të vazhdojnë përpjekjet për realizimin e projekteve të filluara, të cilat kanë për synim kthimin dhe krijimin e kushteve për siguri të të gjithë banorëve të kthyer.

UNMIK-ut në Mitrovicë

Qeveria e Serbisë i ka ofruar Ali Kadriut për dy shtëpitë 1.2 milion euro, por ai nuk i ka shitur. Vlerësohet se kjo shumë e madhe i është ofruar për arsye se këto dy objekte ndodhen në pikën më strategjike në qytetin e Mitrovicës.

marrin diçka në këtë drejtim deri me 12 nëntor, duke tërhequr vërejtjen se situata atje mund të eskalonte dhe përgjegjësia për këtë do të binte tek institucionet. Kryetari i fshatit Suhadoll, Shefki Imeri, pohon se situata atje është e tensionuar pas incidenteve që kanë ndodhur rreth tentimit të kthimit të Ali Kadriut në pronën e vet.

Banorët dhe kryesia e Suhadollit e përkrahin fuqishëm qëndrimin e drejtë të Kadriut për kthim në pronën e tij, si e drejtë e patjetërsueshme dhe se shfrytëzimi i pronës është i garantuar me Kushtetutën e Kosovës dhe me të gjithat Konventat Ndërkombëtare.

Pas këtyre ngjarjeve, në oborrin e objekteve kontestuese për meremetim, një të diel, zëdhënësi i UNMIK-ut në Prishtinë, Aleksander Ivanko, tha se Kadriut nuk i

nevojitet kurrfarë leje nga UNMIK-u për të punuar. Me këtë, Ivanko ka hedhur poshtë "arsyetimin" për ndërprerjen e punëve nga ana e kolegëve të administratës së UNMIK-ut në veri, të drejtuar nga Jaroslav Kozak, që njihet si bashkëpunëtorë i ngushtë i ish-administratorit rajonal Gerard Gallucci, i cili akuzohej për jokorrektesi dhe njëanshmëri gjatë misionit të tij në këtë rajon.

I ndalohet kthimi për shkaqe sigurie!

Edhe pas verifikimit të dokumentacioneve mbi pronësinë e Ali Kadriut në objektet kontestuese dhe të drejtës së tij për të meremetuar pronat, ai nuk lejohet të punojë, gjoja për shkak të mungesës së sigurisë edhe pse ai nuk ka kërkuar nga askush që ta sigurojë. "Po bëjmë përpjekje që të gjejmë mënyrën më të mirë të mundshme që Ali Kadriu të fillojë punën dhe të kthehet në shtëpinë e tij për të jetuar, sepse kjo është e drejta e tij. Por policia na ka njoftuar se rrethi këtu nuk është i mirë dhe se Aliu nuk ka siguri për të jetuar këtu, prandaj edhe kemi këtë situatë", - tha Ivanov, duke vlerësuar se nuk është çështje e lehtë për t'u zgjedhur, por duhet pasur parasysh se Kadriu

ka të drejtë të kthehet në shtëpinë e tij dhe shpresoj se kjo do të bëhet sa ma shpejt që është e mundshme.

Ndërkaq, Anil Vasisht, shef i stafit të UNMIK-ut, tha se UNMIK-u nuk është kundër kthimit të Kadriut në shtëpinë e tij.

Veseli: Komuna dhe Qeveria e Kosovës po bëjnë përpjekje për t'i kthyer të gjithë të zhvendosurit në pronat e tyre

Derisa vazhdojnë përpjekjet për vazhdimin e meremetimit të pronave të Kadriut, drejtori për infrastrukturë në Kuvendin Komunal të Mitrovicës, Rasim Veseli njoftoi autoritetet e UNMIK-ut se Komuna dhe Qeveria e Kosovës po bëjnë përpjekje për t'i kthyer të gjithë të zhvendosurit në pronat e tyre.

Me mjetet e Qeverisë së Kosovës, këto ditë pritet të fillojë ndërtimi i rrugës për në fshatin Vidimriq dhe në lagjen "Kroi i Vitakut". Veseli ka kërkuar përkrahjen dhe mbështetjen e UNMIK-ut në përpjekjet e Pushtetit Lokal për të krijuar infrastrukturë të nevojshme për kthimin e të zhvendosurve në pronat e tyre, gjë për të cilën mori premtimin për përkrahje në këtë drejtim nga Anil Vasisht. ■



Korrespondencë nga Nju Jorku

Dëshmitar i një dite hi

"Nëse ende dikush ka dyshim se Amerika është vendi ku të gjitha gjërat mund të ndodhin, se ëndrrat e themeluesve të këtij shteti ende jetojnë me ne dhe nëse dikush ende dyshon në fuqinë e demokracisë amerikane - përgjigjen më të mirë ua keni dhënë sot Ju!" - Barack Obama, me rastin e fitores



Armend HETEMI

Vesa kishte lagur barin e oborreve në rrugën Woodland. Bashkë me të edhe kapelën e zonjës topolake, Mary Magdalena (fqinjës sime afrikan-amerikane) e cila ishte zgjuar herët në mëngjesin e së martës. Një ditë jo e zakonshme për të shkuar në kishë. -Kush e di se çfarë mëkatesh paskan bërë! - thashë unë, - që qenkan zgjuar në orën gjashtë të mëngjesit për t'u rrëfyer. Çdo njëri i huaj si puna ime do të thoshte: "Sa mëkatarë që

janë shejtanët. Nuk ju mjaftuaka e diela dhe e hëna, por kanë ardhur të rrëfihen të martën!". -A thua do t'ua falë zoti mëkatesh këtyre njerëzve? -e pyeta veten duke fshirë sytë. Sepse radha ishte shumë e gjatë. Por jo shumë kohë më vonë, derisa po fusja një gazetë në kutinë postare, më ra në sy një slogan aty nga mesi i rreshtave: "Vota është obligim qytetar!" Atëherë e kuptova se kjo ishte dita e zgjedhjeve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës...

Fati deshi që të qëlloja në Amerikë në këtë ditë historike. Përse historike, derisa ato ishin vetëm një palë zgjedhje?! Historike sepse cilido kandidat eventual që do të fitonte do të bënte histori. Nëse do të fitonte kandidati demokrat, Barack Obama, ai do të ishte presidenti i parë afrikan-

amerikan, kurse Joe Biden i pari zëvendës-president romano-katolik. Ndërkaq po të fitonte republikani John McCain ai do të bëhej presidenti më i moshuar i zgjedhur në historinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ndërsa kandidatja Sarah Palin e para femër e zgjedhur si zëvendës-presidente. Çdo kandidat do të bënte histori, por zgjedhja e Barack Obamës si president ishte histori në vete.

Skanerit regjistronte çdo detaj

Rrugët e New York-ut, si zakonisht, gumëzhinin nga zhurmat. Jeta zhvillohej normalisht. Askush nuk e vrau askënd. Asnjë votë nuk u vodh mekanikisht, sepse skaneri regjistronte çdo detaj. Dhe çka ishte shumë me rëndësi, nuk u votua për të vdekurit, madje as për ata që ishin jashtë shtetit, siç më ka rënë në sy të shohë në zgjedhjet e fundit në Kosovë.

Ky do të ishte një përshkrim konciz i tërë asaj çka ndodhi më 4 nëntor 2008 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, saktësisht në të dyja shtetet që kisha mundësi të vizitoja këtë ditë, New York dhe Connecticut. Pra, atmosfera në përgjithësi ishte festive.

Edhe pse të gjitha institucionet punuan që nga ora shtatë e mëngjesit e deri në orët e vona të mbrëmjes, oborret e shkollave ishin përplot me votues.

Rezultatet e para që erdhën nga Bregu Lindor tregonin se senatori Barack Obama, printe bindshëm në garën për president. Në rrugë, në çdo kënd, vëresheshin grupe kryesisht të rinjsh që ishin drejtuar për në qendrat e votimit. Disa nën sloganin "Change we Need!" dhe 'Yes we Can!' kurse të tjerët 'Country First: Reform, Prosperity, Peace!'

Pas rezultateve të para, madhështinë e këtyre zgjedhjeve e shtoi dalja e një numri të madh votuesish. Si duket, votat e para për Obaman i nxitën dy kategori njerëzish. Ata që e përkrahnin atë për ta thelluar fitoren e tij dhe një kategori tjetër që u nxitën të vendosnin në momentin e fundit, shumica

Kush është Barack Obama?

U lind më 4 gusht 1961, në Honolulu, Hawaii. Në fëmijërinë e hershme është ballafaquar me disa vështirësi të njëpasnjëshme. Fillimisht ishte ballafaquar me divorcin e prindërve natyral të tij, babait kenian dhe nënës amerikane dhe pastaj edhe me faktin e humbjes së babait. Një kohë ka jetuar në Indonezi së bashku me nënën, motrën dhe njerkun e tij. Si i ri ka treguar rezultate të shkëlqyeshme në shkollë. Ka një arsimim superior të kënaqshëm. Ka qenë student i Shkollës Juridike të Chicagos, Fakultetit të Drejtësisë së Harvardit dhe Universitetit Columbia në New York.

Ka qenë senatori më i ri në dhomën e Senatit, si përfaqësues i shtetit të Illinoisit, që nga viti 1997-2004.

Barack Obama është presidenti i 44 i SHBA-ve.

Gjithashtu edhe presidenti i parë afrikan-amerikan.

Ka kundërshtuar vazhdimisht politikën e qeverisë republikane, sa i përket Lindjes së Mesme, Irakut, Sirisë dhe Iranit. Gjatë fushatës elektorale, ka

premtuar rritje ekonomike dhe fokusim në zgjidhjen e problemeve të brendshme dhe kthimit të imazhit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Është i martuar me Michelle

Robinson dhe ka dy fëmijë: Malia Ann, dhjetë vjeçe dhe Natasha ("Sasha"), shtatë vjeçe..



istorike

syresh republikan të pavendosur. Por edhe kjo nuk e zbehu fitoren e Obamas. Ai deri në momentin e fundit, përmes mënyrave të ndryshme, ua bëri me dije të gjithëve se kjo ishte dita e tij dhe se tani ishte tepër vonë të ndalej marshi deri në fitore.

Çka nuk të kujtohej në këtë ditë. Pasi që demokratët avanconin, historia ishte tema e ditës. Tani njerëzit filluan të flasin për lëvizjet dhe përpjekjet që kishte bërë njerëzimi për të ardhur deri këtu. Në mjedise të ndryshme mund të dëgjoje që nga fyerjet verbale të racistëve dhe deri tek manifestimet e shpirtit human nga njerëz të bardhë me plot kuptimin e fjalës. Shumë njerëz i kam dëgjuar të flasin dhe të kujtojnë vuajtjet e popullsisë me ngjyrë. Padrejtësitë që u ishin bërë dhe deri te lëvizjet e tyre për të drejta natyrore, civile, ekonomike dhe politike. Shumë e shumë gjëra të tjera që ndoshta janë të tepërta të thuhën dhe vështirë të përshkruhen.

Festa nis në getot e afrikan-amerikanëve

Orë pas ore, gara shkante dhe bëhej më e nxehtë. Obama printe dhe në orën 11 të darkës tani më dihej se ai do të ishte presidenti i ri i vendit. Festa filloi, në getot e afrikan-amerikanëve. Të gjithë ishin në rrugë. Kësaj herë jo për të kërkuar të drejta, por për të festuar kurorëzimin e fitores së madhe të tyre, demokracisë, njerëzimit dhe të mbarë popullit amerikan. Më 4 nëntor 2008 ishte zgjedhur një president afrikan-amerikan! Kjo nuk donte më ndonjë koment. Të gjithë i bashkohen festës.

Në Time Square-New York, njerëz të të gjitha ngjyrave kishin dalë për të festuar fitoren e madhe dhe historike që u transmetua drejtpërdrejt në shumë vende të botës. Pastaj paraqitet, drejtpërdrejt, Presidenti i porsazgjedhur. "Nëse ende dikush ka dyshim se Amerika është vendi ku të gjitha gjërat mund të ndodhin, se ëndrrat e themeluesve të këtij shteti ende jetojnë me ne dhe nëse dikush ende dyshon në fuqinë e demokracisë Amerikane - përgjigjen më të mirë ua keni dhënë sot Ju!" – iu tha Barack Obama qindra mijërave simpatizantëve në Chicago të shtetit Illinois. ■

Mr. Naim Tërnavë myfti i Kosovës

I përkushtuar për fe e atdhe



Demir RESHITI

Trupi Zgjedhor i Bashkësisë Islame të Kosovës më 18 tetor të këtij viti ka rizgjedhur edhe për një mandat pesëvjeçar Naim Tërnavën për myfti të Kosovës. Në një manifestim të organizuar më 25 tetor, myftiut të rizgjedhur i është dorëzuar Menshura dhe është bërë përrurimi publik i tij.

Rizgjedhja në këtë post të rëndësishëm, ka bërë që Tërnavë të jetë në qendër të vëmendjes së opinionit në Kosovë dhe më gjerë.

Për lexuesit e respektuar të revistës "Paqja", kemi përgatitur një portret të myftiut të rizgjedhur në këtë post.

Biografia

Naim Tërnavë është i lindur më 7 janar 1961, në fshatin Lismir të komunës së Fushë-Kosovës. Shkollën fillore e ka kryer në vendlindje, të mesmen në medresenë "Alauddin" në Prishtinë, ndërsa fakultetin në Universitetin "Al-Azhar" të Kajros, dega e Apologjetikës Islame.

Pas përfundimit të studimeve, emërohet imam në fshatin Lismir. Në

vitin shkollor 1985/86 emërohet profesor i lëndëve 'Akaidi' dhe 'Filozofia islame' në medresenë e mesme "Alauddin", ndërsa në vitin 1995 është zgjedhur drejtor i kësaj medreseje për dy mandate (1995-2003).

Ka magjistruar më 2003 në Universitetin e Hapur Amerikan të Kajros, (American Open University, Cairo).

Naim Tërnavë ka kryer shumë detyra dhe funksione me rëndësi në kuadër të Institucioneve të Bashkësisë Islame të Kosovës. Ka qenë anëtar i redaksisë së revistës "Dituria Islame" (tri mandate), pastaj anëtar i Kryesisë së Bashkësisë Islame (dy mandate) nga viti 1990-1998.

Në vitin 1999 u zgjodh kryetar i Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës. Gjatë kësaj kohe Naim Tërnavë ka zhvilluar shumë takime zyrtare në nivele ndërkombëtare, kudo në botë, gjithnjë në interes të çështjes së Kosovës.

Naim Tërnavë, gjatë gjithë këtyre viteve, është marrë në mënyrë të vazhdueshme edhe me publicistikë. Ka botuar shtatë libra (Moral Islami/Ahlaku-1; Bazat e besimit/Akaidi-1; Pasqyrë e filozofisë islame, Morali Islami/Ahlaku-2; Fraksionet në Islam/Akaidi-4; Islami besim i vërtetë dhe fetë tjera/Akaidi-2; Bazat e Besimit Islam), disa dhjetëra

artikuj, në revista e gazeta vendore dhe të huaja.

Krahas gjuhës amtare, flet edhe gjuhën arabe, angleze, turke dhe kroate.

Në vitin 2003 zgjidhet kryetar dhe Myfti i Bashkësisë Islame të Kosovës.

Më 18 tetor të këtij viti, është rizgjedhur myfti i Kosovës me mandat 5 vjeçar.

Ishte vetëm pesëvjeçar kur policia serbe e hedh nga dritarja!

Naim Tërnavë rrjedh nga një familje me tradita patriotike. Është fëmija i tretë nga 5 vëllezër e 2 motra, sa janë gjithsej.

Babai i tij, Pajaziti, ishte njëri nga gjashtë djemtë e Ahmetit. Pajaziti si pjesëtar i NDSH-së, kurrë nuk është pajtuar me regjimin e atëhershëm komunist jugosllav, nga i cili është përndjekur dhe është burgosur disa herë. Që nga viti 1950, kur e burgosën për herë të parë, familja e Pajazitit ishte në shënjestër të regjimit komunist. Sa herë që ndonjë udhëheqës i lartë jugosllav i asaj kohe e vizitonte Kosovën, Pajazitin e izoloni në burg shtëpiak.

Naimi ishte vetëm pesëvjeçar kur përballat me dorën e hekurit të policisë serbe. Gjatë një bastisjeje të shtëpisë në Lismir, policia e hedh nga dritarja në borë!

“Mbaj mend kur hyra në klasë të parë si 6 vjeçar, babai e hoqi fotografinë e Titos nga Abetarja duke më thënë se ky njeri nuk është i yni” - tregon myftiu, duke shtuar se gjatë gjithë shkollimit të mëtutjeshëm librat i ka pas pa fotografi të këtij ish-udhëheqësi komunist jugosllav.

Naimi, qysh si 10-vjeçar, nisi të punonte në dyqanin tregtar të fshatit, ku do ta vazhdonte punën deri në çastin kur filloi studimet në Kajro.

Gjatë studimeve, krahas obligimeve në fakultet, angazhohet me aktivitete atdhetare. Është një nga themeluesit e Unionit të studentëve shqiptarë në Egjipt. Atje shquhet për veprimtari atdhetare në të mirë të kombit shqiptar. Njihet dhe bashkëpunon me atdhetarë nga Shqipëria që jetonin në Egjipt dhe lexon e shpërndan literaturë që në Kosovë ishte e ndaluar.

Angazhimi në Këshillin e Emergjencës

Në vitin 1989 kur filluan protestat e mëdha në Kosovë kundër ndryshimeve kushtetuese me të cilat suspendohej au-

tonomia e Kosovës, Naimi u angazhua në këshillin e ndihmave. Ai tregon se, në atë periudhë, vetëm nga Bosnja e Hercegovina arritën në Kosovë mbi 200 maune me ushqim dhe veshmbathje.

Një moment tjetër, që myftiu e bën për herë të parë publik nëpërmjet revistës “Paqja”, është rasti kur në vitin 1990, bashkë me Riza Lukën dhe Elez Osmanin udhëtojnë për në Kranj të Sllovenisë, ku ishin strehuar një pjesë e madhe e delegatëve të atëhershëm të Kuvendit të Kosovës, të cilët e patën shpallë republikën në Kaçanik. Atyre (deputetëve) ua dërgojnë 40 mijë marka gjermane, prej të cilave 35 mijë ishin të dhuruara nga kryesia e BIK-ut dhe 5000 nga biznesmeni Ekrem Luka. “Të udhëtosh deri në Slloveni me gjithë ato para, vërtet ishte një aventurë e rrezikshme. I maskuam ato para me disa gjëra ushqimore dhe i vendosem në ulësen e prapme të veturës”-kujton Tërnavë, duke e vlerësuar këtë si një kontribut të rëndësishëm për deputetët që sakrifikuan aq shumë në atë kohë.

“Bashkësia Islame e Kosovës, në atë periudhë, kishte marrë rolin e dalëzotës së popullit. Xhamitë e Kosovës u shndërruan në shkolla e fakultete, si dhe në qendra ku zhvilloheshin aktivitete të ndryshme. 1230 tubime të karaktereve të ndryshme janë mbajtur vetëm në lokalet e medresesë. Pothuajse të gjitha kuvendet e partive politike janë mbajtur në këtë medrese, madje edhe kuvendi i Partisë Demokristiane të Kosovës” - kujton myftiu Tërnavë.

Të gjitha këshillat e BIK-ut qenë shndërruar në logjistikë të UÇK-së

BIK-u vazhdoi të jepte kontribut të rëndësishëm edhe gjatë viteve të luftës në Kosovë. Krahas ndihmave financiare dhe ushqimore për UÇK-në, ajo ndihmonte edhe popullatën e dëbuar nga zonat e luftës. Të gjitha këshillat e BIK-ut qenë shndërruar atëherë në logjistikë të UÇK-së, kujton Naimi.

Intensifikimi i luftës në Kosovë (1998), e gjen Naimin në krye të Këshillit të Emergjencës, të cilin e kishte formuar Bashkësia Islame e Kosovës.

Ai kujton disa momente gjatë luftës, të cilat i kanë krijuar shumë emocione. Tregon se si e ka përjetuar masakrën e Likoshanit dhe momentin kur ua ka

falur namazin e xhenazes të rënëve në këtë masakër.

Disa momente të tjera kur i ka ndihmuar UÇK-së janë po ashtu mjaft domethënëse. I kujtohet rasti kur ka porositur 1400 palë këpucë në Novi Pazar, për nevojat e ushtarëve të UÇK-së, të cilat ka arritur t'i fus në Kosovë me shumë sakrificë.

Këshilli i Emergjencës i BIK-ut, të cilin e udhëhiqte Naimi, ka siguruar 65 mijë copë pasteta të pulës, të cilat të maskuara në kamionë me rërë i kanë futur në zonat e luftës.

Atij i kujtohet gjithashtu momenti kur më 1997 i shon në zyrë Rrustem Mustafa (komandant Remi), të cilin atëkohë nuk e njihte dhe i kërkon të holla për nevojat e furnizimit me armë të UÇK-së, e ky pa hezituar ia jep 15 mijë DM. Në një rast tjetër, i vjen Fatmir Xhelili (tani zv/ministër i Ministrisë së Brendshme) dhe i kërkon 50 mijë euro. Naimi i siguron ato dhe përkundër rrezikut të madh (duhej të kalonte nëpër disa patrulla të policisë serbe), dhe ia sjell paratë që nevojiteshin për furnizimin e UÇK-së.

Milosheviqi ia shtyn martesën!

Si 27-vjeçar (ishte i fejuar), shkon në shërbimin ushtarak të Jugosllavisë së atëhershme dhe u detyrua ta shtynte martesën. (Këtë periudhë ai nuk dëshiron ta kujtojë sepse thotë se ka hequr të zitë e ullirit për shkak të dosjes që ia kishin përgatitur “sigurimcat” e atëhershëm).

Pasi kthehet nga shërbimi ushtarak, e cakton dasmën, të cilën detyrohet ta shtyjë edhe njëherë! Këtë radhë ia sheh sherrin Milosheviqit. Data e dasmës kishte qëlluar në të njëjtën ditë kur Milosheviqi kishte ardhur në Gazimestan. Meqë të fejuarën e kishte nga fshati Stanofc i Ulët, dhe rrugët qenë bllokuar nga policia dhe përkrahësit e Milosheviqit që kishin ardhur atë ditë në Gazimestan, ky u detyrua që ta shtyjë martesën për herë të dytë, kësaj radhe për një javë!

Myftiu Naim Tërnavë, që nga viti 1998, jeton në Prishtinë me gruan dhe katër fëmijë: Refiqen, nxënëse e klasës së tretë në medrese, Harisin që shkon në klasën e parë gjithashtu në medrese, Lejlan në klasën e gjashtë në kolegjin turk, dhe Ejmenin e vogël katër vjeçar. ■

Reportazh nga reparti i maternitetit në QKUK

Aty ku vaji i foshnjave përzihet me buzëqeshje e mallëngjim

Lot gëzimi, e mallëngjimi, buzëqeshje, heshtje, ankth, frikë, kureshtje... Kjo është atmosfera që mbretëron gjatë një dite të zakonshme në Klinikën Gjinekologjike Obstetrike në Prishtinë.



Drita VITIA

Në sportelin e Klinikës Gjinekologjike Obstetrike në Prishtinë pritin dhjetëra qytetarë duke u interesuar për gjendjen e të afërmeve të tyre. Ata, me një droje të shprehur në fytyrë, i afrohen sportelit për të pyetur nëse ka gjë të re. Dhe sapo marrin lajmin e shumëpritur të përcjellë me buzëqeshje të theksuar të personelit mjekësor, atyre iu ndrit fytyra.

Në radhën e gjatë të pritjes takojmë edhe gjyshër që mezi presin momentin të mbajnë në duar nipërit e mbesat e porsalindura.

Lot gëzimi, e mallëngjimi, buzëqeshje, heshtje, ankth, frikë, kureshtje...Kjo

është atmosfera që mbretëron gjatë një dite të zakonshme në Klinikën Gjinekologjike Obstetrike në Prishtinë.

Çdo ditë në këtë klinikë lindin mesatarisht nga 30 foshnja. Krahas pacienteve nga kryeqyteti, në këtë klinikë vijnë për të lindur edhe gra të moshave të ndryshme nga rajone të tjera, veçmas ato që kanë pasur probleme gjatë shtatzënësisë, apo të tilla që janë mbarësuar në mënyrë artificiale.

2500 euro për një shtazënësi artificiale

Në njërin nga shtretërit e bardhë na zë syri një grua me fytyrë të zbehur, të qetë dhe me sy të përmalluar, e cila shikonte nga dera dhe priste vizitën e ndonjë familjari. Është kjo Mirvete Qollaku nga Prizreni, nënë e dy vajzave binjake Arlindës dhe Alketës, të cilat i ka lënë në shtëpi dhe së shpejti do t'i gëzojë edhe me një vëlla ose motër.

Mirvetja dy vajzat binjake i kishte

lindur pas 30 vjet martesë. Ndjesinë e të qenit nënë ajo e ka provuar pas një intervenimi mjekësor në Turqi (shtatzëni artificiale). Ajo, tashmë në moshën 50 vjeçare pret fëmijën e tretë, me shpresë se do të lindë një foshnjë të gjinisë mashkullore.

Mirvetja, tregon se ka pasur vështirësi të shumta për të arritur një shtazënësi të tillë, pasi që përveç problemeve të shumta shëndetësore, kjo shtazënësi asaj i ka kushtuar 2500 euro. "M'ka kushtu boll. Mu ka deshtë mi ba s'di sa lloje t'analizave, kontrolla, udhëtimi i largët e krejt po e kom ba me ymyt për ni djal. Se qikat i kom t'shnosha e t'mira boll që nuk i ndrroj me kurgjo po, pata qef me pas edhe ni djal. Kontrollat që i kom ba nuk m'kan kallxu për gjini se po thojnë për shkak të problemeve në bark s'po mujna me dallu gjininë" - thotë 50 vjeçarja me ndjenja gëzimi dhe kureshtjeje njëkohësisht për të ditur gjininë e fëmijës që pret.

Mirvetja tregon se, po të kesh para, në Turqi mund ta caktosh edhe gjininë e fëmijës, gjë të cilën ajo nuk ka pasur mundësi financiare ta bëjë.

Në familjen e saj punon vetëm bashkëshorti i saj Sefë Qollaku, i cili ka një ndërmarrje të veten dhe kujdeset edhe për familjen e vëllait me të cilën jetojnë në bashkësi familjare.

Mirvetja, pas martesës, ka qenë disa herë nëpër spitale të ndryshme të rajonit, si në Beograd, Lubjanë por edhe brenda Kosovës me shpresë se do të gjente shërim dhe do të lindte fëmijë, por pa sukses. Tani, megjithëse në moshë të shtyrë, ajo pret me padurim fëmijën e saj të tretë, i cili shpreson të jetë djalë.

Për çiftet e reja nuk ka rëndësi gjinia

Zyla Rashiti nga komuna e Besianës, qëndronte në spital me emocione të përzier, derisa priste për të lindur fëmijën e parë. Ajo nga emocionet nuk dinte as si ta përshkruante gëzimin që ndjente. Me

një buzëqeshje në fytyrë bisedonte me bashkëshortin, Ejupin, i cili kishte ardhur për ta vizituar dhe mendonin për emrin që do t'i vinin foshnjës që do të lindte.

Meqë ishte fëmija i parë për ta, çifti i ri nuk mërzhitej për gjininë. Për ta me rëndësi ishte shëndeti i foshnjës dhe nënës. Zonja Zyla nuk i fsheh dot emocionet. "Është diçka e veçantë për mu, s'po di qysh ta përshkruaj, edhe gjininë nuk pe di se nuk e kom këqyr, veç shumë qef po kom me kanë çik", shprehej Zyla. Përkundër saj, bashkëshorti Ejupi krejt çka dëshironte ishte që foshnja të jetë e shëndoshë. Për emër megjithëse ishin të pavendosur, krejt çka dihej "do të jetë emër mysliman ose shqip" - theksonte Ejupi.

Ndryshe nga kjo, Gylere Mehmeti, nga komuna e Lipjanit priste fëmijën e tretë që do ta lindte me operacion, lindje kjo që konsiderohet më e komplikuar nga mjekët. Ajo ka dy vajza, Dorinën 8 dhe Donikën 5 vjeçare dhe nuk e fsheh dëshirën e madhe për të lindur një foshnje të gjinisë mashkullore. "Gjininë nuk e di, nuk e kam këqyrë hiq se s'kam guxuar. Kam hjek shumë ndy lindjet e para e tash ishalla e kom djal se nuk e di a guxoj me lind edhe niher a jo. Mjekt m'kan than që munesh me pas ose ti ose foshnja pasoja mas tri lindjeve. Nuk e di, po pres edhe pak deri sa t'më shtinë n'operacion" - fliste Gylerja me një zë të butë dhe të frikshëm.

Nga ana tjetër, përkundër kushteve jashtëzakonisht të dobëta të punës, stafi mjekësor me përkushtim dhe me pasion të lartë për punë u ndihmonte grave të shtruar në këtë klinikë.

Disa nga punëtorët shëndetësorë që i takuam në këtë klinikë, ankoreshin për kushtet jashtëzakonisht të dobëta të punës. Sipas tyre, aty mungon gjithçka, duke filluar nga hapësira e nevojshme për punë e deri te mungesa e materialit teknik e sanitar. Megjithatë, ata nuk e fshehin shpresën se e nesërmja do të jetë më mirë...!

Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

Kosova në Hagë

Demir RESHITI

Portugalia, Maqedonia, Mali i Zi, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Malajzia, janë pesë shtetet që e kanë njohur zyrtarisht Kosovën e pavarur gjatë muajit tetor, duke e ngritur kështu numrin e njohjeve në 52. E veçanta e këtyre njohjeve është se katër prej tyre kanë ndodhur menjëherë pas miratimit të rezolutës serbe nga ana e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për ta proceduar në gjykatën ndërkombëtare të Hagës çështjen e ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Dy të veçanta të tjera janë se Kosovën e kanë pranuar dy shtete fqinje (Maqedonia dhe Mali i Zi), si dhe një shtet arab (Emiratet e Bashkuara Arabe).

Ndërkohë, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë ka kërkuar nga vendet anëtare të OKB-së që të deklarohen nëse besojnë se shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte e ligjshme. Trupi më i lartë juridik i OKB-së ka kërkuar deklarata me shkrim deri më 17 prill 2009, ndërsa shtetet do të kenë kohë deri më 17 korrik 2009 të bëjnë komentet për deklarimet e njëra-tjetres.

Në vazhdim po paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajit tetor 2008.

**Angela Merkel**

(1 tetor) Merkel refuzon ndarjen e Kosovës

Berlin - Kancelarja e Gjermanisë Angela Merkel ka hedhur poshtë idenë e ndarjes së Kosovës, e cila është përmendur nga presidenti serb Boris Tadiq. Ajo ka bërë këto komente pas takimit me Ta-

diqin në Berlin. Ndërkohë, Tadiq i cili dje kishte thënë se ndarja është një opsion, në Berlin ka thënë se është keqkuptuar.

(2 tetor) Munter: SHBA kundër ndarjes së Kosovës

Beograd - Ambasadori i SHBA-së në Beograd Cameron Munter i ka bërë thirrje qeverisë serbe që të ndihmojë në shtrirjen dhe funksionalizimin e EULEX-it në Kosovë. Duke komentuar deklaratën për ndarjen eventuale të Kosovës të bërë nga presidenti Tadiq, Munter ka thënë se statusi i Kosovës është i zgjidhur dhe se SHBA nuk pajtohet me ndarjen e Kosovës.



(4 tetor) PE: EULEX të shtrihet në tërë Kosovën

Prishtinë - "Misioni i Bashkimit Evropian për sundim të ligjit dhe polici duhet të shtrihet në tërë territorin e Kosovës. Ndarja e përgjegjësive të EULEX-it dhe të misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë në vija etnike në zona të ndryshme nëpër Kosovë, është opsion i papranueshëm",- kanë thënë anëtarët e Komitetit për Siguri dhe Mbrojtje të Parlamentit Evropian në fund të vizitës së tyre 4 ditore në Kosovë. Kryetari i këtij komiteti, gjermani Karl Von Wogau, thekson se shtrirja e EULEX-it në tërë territorin e Kosovës, duke përfshirë dhe veriu, është e vetmja mënyrë për garantimin e sundimit të ligjit.


(6 tetor) ICO: Beogradi të pranojë EULEX-in

Prishtinë - "Serbia nuk mund t'i ofrohet Bashkimit Evropian duke kundërshtuar shtrirjen e misioneve të këtij mekanizmi në tërë territorin e Kosovës, sepse

pavarësia e Kosovës është proces i përfunduar, i pakthyeshëm dhe i mbështetur nga shumica e vendeve të Bashkimit Evropian", -ka deklaruar Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar në Prishtinë, Pieter Feith, gjatë një debati të organizuar nga Klubi për Politikë të Jashtme.

(7 tetor) Portugalia njeh Kosovën

Lisbonë - Qeveria e Portugalisë ka njohur zyrtarisht shtetin e Kosovës, ka deklaruar ministri i jashtëm portugez, Luis Amado. "Është në interesin e shtetit portugez të procedojë sot me njohjen zyrtare të pavarësisë së Kosovës" - ka thënë Amado, para komitetit për marrëdhënie me jashtë në Parlamentin e Portugalisë. "Ne jemi të bindur se pavarësia e Kosovës tashmë është e pakthyeshme" - ka shtuar Amado. Portugalia është vendi i 22-të i BE-së që ka njohur shtetin e ri.

**Robert Gates**

(7 tetor) Gates: Trupat amerikane në Kosovë - më së paku deri në fund të 2009-ës

Londër - Shtetet e Bashkuara do t'i mbajnë trupat e tyre në Kosovë më së paku deri në fund të vitit 2009, - ka thënë sekretari amerikan i Mbrojtjes, Robert Gates, duke nënvizuar mbështetjen për operacionet paqeruajtëse të NATO-s, njofton agjencia e lajmeve Reuters.

(8 tetor) OKB: U miratua rezoluta serbe

Nju Jork - Këshilli i Sigurimit të OKB-së, me shumicë votash, ka miratuar rezolutën serbe për ta proceduar në gjykatën ndërkombëtare të Hagës çështjen e ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë së

Kosovës. Edhe pse rezoluta serbe është miratuar nga Asambleja, shumë nga 27 vendet anëtare të BE-së kanë abstenuar. SHBA-ja, sikurse edhe Shqipëria, e kanë kundërshtuar atë. Ndarjet në BE kanë qenë të qarta, meqë Qiproja, Sllovakia, Rumania, Greqia dhe Spanja mbështetën kërkesën serbe. Pritet që të kalojnë dy deri në tre vjet derisa Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë ta japë opinionin e saj.

(9 tetor) Maqedonia njohu Kosovën

Shkup - Republika e Maqedonisë e ka njohur shtetin e pavarur të Kosovës. Këtë vendim e ka miratuar Qeveria e Maqedonisë, ka njoftuar ministri i Jashtëm i Maqedonisë, Antonio Milloshovski.

(9 tetor) Mali i Zi e njohu Kosovën

Podgoricë - Qeveria e Malit të Zi e ka njohur Kosovën si shtet të pavarur, ka njoftuar ministri i jashtëm, Milan Ročen. "Qeveria ka vendosur njëzëri ta njohë Republikën e Kosovës" - ka deklaruar për gazetarët shefi i diplomacisë malazeze.



Yves de Kermabon

(10 tetor) Kermabon: EULEX-i funksional në fund të vjeshtës

Berlin - Shefi i EULEX-it, Yves de Kermabon ka thënë se ky mision aktualisht po e intensifikon dislokimin. "Ne parashikojmë të jemi operacionalë nga fundi i vjeshtës. EULEX-i, do të zhvillojë më tej dhe do të forcojë një sistem të pavarur dhe shumë-etnik të sundimit të ligjit, nga i cili do të përfitojnë të gjitha komunitetet në Kosovë" - ka thënë Kermabon në konferencën "Kosova - 120 ditë pas miratimit të Kushtetutës", që është mbajtur në Berlin.

(14 tetor) Emiratet e Bashkuara Arabe e njohën Kosovën

Abu Dhabi - "Emiratet e Bashkuara Arabe shpallin se e njohin Kosovën si shtet të pavarur" - ka njoftuar agjencia



Emiratet e Bashkuara Arabe

zyrtare e lajmeve e këtij shteti - WAM.

Emiratet e Bashkuara Arabe, janë shteti i parë arab që e ka njohur shtetin e Kosovës. Me këtë njohje numri i shteteve që pranojnë pavarësinë rritet në 51.

(21 tetor) Hagë: Kosova të argumentojë pavarësinë

Hagë - Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë ka kërkuar nga vendet anëtare të OKB-së që të deklarohen nëse besojnë se shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte e ligjshme. Trupi më i lartë juridik i OKB-së ka kërkuar deklarata me shkrim deri më 17 prill, ndërsa shtetet do të kenë kohë deri më 17 korrik të bëjnë komentet për deklarimet e njëra-tjetrës. Gjykata e ka ftuar edhe Kosovën, që të paraqesë argumentet e saj.

(21 tetor) Ladley moderon dialogun Prishtinë-Beograd

Nju Jork - Kombet e Bashkuara kanë caktuar Andrew Ladleyn si negociatorin e ri, i cili do të ndërmjetësojë në bisedimet indirekte ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, të asistuar nga administrata e OKB-së në Kosovë. Detyrë e Ladleyt do të jetë gjetja e zgjidhjeve sa i përket doganave, policisë si dhe çështjeve akoma të padefinuara ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të përcaktuara edhe në letërën e kreu të OKB-së, Ban Ki Moon.

(22 tetor) Fried: SHBA-ja merr pjesë në misionin EULEX

Uashington - Zyrtari i lartë i Departamentit amerikan të shtetit, Daniel Fried, ka deklaruar se Uashingtoni do të dërgojë 88 oficerë policie, gjyqtarë dhe prokurorë në misionin e BE-së për sundim të ligjit në Kosovë. Fried ka thënë se pjesëmarrja në misionin e Bashkimit Evropian në Kosovë shënon herën e parë kur amerikanët marrin pjesë në një mision evropian. Sipas tij, marrëveshja e Shteteve të Bashkuara me BE-në për këtë çështje tregon se raportet transatlantike kanë prodhuar rezultate konkrete.

(24 tetor) Rehn: Viti 2009 - fokusi në Kosovë

Varshavë - Komisionari për zgjerim i Bashkimit Evropian, Olli Rehn, ka deklaruar se "pikë qendrore e politikës evropiane në Ballkan gjatë vitit të ardhshëm do të jetë Kosova, ndërsa më e rëndësishmja është që atje të fillojë funksionimi i misionit EULEX". Ai këto komente i ka bërë gjatë vizitës njëditëshe në Varshavë.



Javier Solana

(27 tetor) Solana: Në dhjetor, EULEX-i në tërë Kosovën

Bruksel - 'Misioni EULEX do të vendoset në tërë territorin e Kosovës në muajin dhjetor' - ka deklaruar në Bruksel shefi për Politikë të Jashtme dhe Siguri i Bashkimit Evropian, Javier Solana. Ai i ka bërë këto komente në selinë e NATO-s, gjatë një konference të përbashkët për shtyp me sekretarin e përgjithshëm të aleancës, Jaap de Hoop Scheffer.

(30 tetor) Jones: Do të rriten ndjeshëm njohjet për Kosovën

Tiranë - Zv/ndihmës Sekretari Amerikan i Shtetit, Stuart Jones ka deklaruar se numri i vendeve që do të njohin pavarësinë e Kosovës do të rritet ndjeshëm në të ardhmen. Këtë qëndrim diplomati i lartë amerikan e mbajti në Tiranë, gjatë punimeve të Konferencës së përvitshme të ambasadorëve shqiptarë, të akredituar në vende të ndryshme të botës.

(31 tetor) Malajzia njohu Kosovën

Kuala-Lumpur - Qeveria e Malajzisë ka njohur Republikën e Kosovës. Këtë ia ka bërë të ditur ministrit të Jashtëm të Kosovës, Skënder Hyse-nit, në një takim të posaçëm, shefi i Zyrës së Malajzisë në Kosovë, Mustafa Mansor.

Malajzia është vendi i 52-të që deri tash ka njohur pavarësinë e Kosovës. ■

Histori Islame (24)

Kush do ta zëvendësojë

Zgjedhja e Kalifit, në formën në të cilën ai u zgjodh, ishte forma më e re dhe e para e këtij lloji të zgjedhjeve në botë. Kjo formë e zgjedhjeve doli si rezultat i këshillave të All-llahut në Kur'an dhe praktikës parlamentare të Muhammedit s.a.v.s. Kjo praktikë e zgjedhjeve do të rifillojë së aplikuari ndër njerëz vetëm pas katërmbëdhjetë shekujve



Muhamed JUSUFI
-KAJOLLI

Sikur ai që e ka lexuar historinë islame dhe nuk e ka besuar këtë fe, ashtu edhe ai që e ka lexuar këtë histori dhe e ka besuar këtë fe (veprën e Muhammedit s.a.v.s.- dhe Kur'anin) është i bindur se Muhammedi s.a.v.s. ishte i pazëvendësueshëm.

Se çfarë përfaqësonte Muhammedi s.a.v.s. dhe kush ishte ky njeri do ta kuptojmë më saktë nga shembulli në vijim. Sipas një ankete të bërë në fundshekulin e XX-të, në të cilën kërkohet njëshi i njerëzimit, pra, njeriu më meritor i të gjithë kohërave, rezultoi se ky njeri ishte Muhammedi s.a.v.s., njeriu i papërsëritur gjatë historisë dhe besohet se nuk do të lindë më një i tillë. Kjo i bëri krenar muslimanët edhe më shumë, sepse ky anketim nuk ishte me iniciativën e muslimanëve, por nga një profesor amerikan me prejardhje çifute. Nga njëqind personalitetet e zgjedhur, sipas kriterëve të bëra nga instituti shkencor i këtij profesori, doli se Muhammedi s.a.v.s. ishte i pazëvendësueshëm. Prandaj, kjo më bën edhe më të bindur të them se termi 'zëvendës i Muhammedit s.a.v.s.' është i mangët, kështu që do të mjaftohemi, sikurse në vazhdim, të themi 'Kalifi i tij'.

Ç'kuptojmë me fjalën 'kalif'?

Secili dijetar e ka të vështirë për ta komentuar fjalën Kalif. All-llahu tha se njeriu është Kalifi i Tij në Tokë, pra, njeriu është Kalif i All-llahut në Tokë. Si do ta kuptojmë këtë? Për ta kuptuar saktë se çdo të thotë Kalif, njeriu duhet të njohë saktë dhe mirë tërësinë e Islamit, ta kuptojë saktë relacionin Krijues dhe i krijuar. All-llahu i Lartëmad-

hëruar, përmes Kur'anit, ka informuar njerëzimin se iu ka thënë melekëve: "... Unë po krijoj në Tokë-Kalif..."

Nëse e përkthejmë thjesht fjalën kalif, gjuhësisht kjo fjalë do të thotë zëvendës, por kur mundohemi ta krahasojmë dhe ta përshkruajmë këtë emër me detyrat që i ngarkohen sipas aspektit etimologjik, atëherë gjejmë vështirësi për ta definuar saktë. Sa për ilustrim, përkthyesit shqiptarë dhe ata të gjuhëve indoevropiane, fjalën 'Kalif' të theksuar në Kur'an e kanë përkthyer herë si mëkëmbës, e herë si sundimtar, e herë si zëvendës, e herë si trashëgues. Nga kjo kuptojmë se secili përkthyes e ka përkthyer ashtu si e njeh, ose e kupton tërësinë e fesë Islame.

Shumë nga përkthyesit preferojnë ta lënë ashtu siç është theksuar në origjinal, pra, Kalif, dhe mjaftohen me kaq. Kështu do të kuptohej më mirë, sepse kemi të bëjmë me njeriun, me qenien e lirë, i cili vepron në përgjegjësinë e vet kur është fjala në raportet e tij me Krijuesin e vet, ndërsa kur kemi të bëjmë me marrëdhëniet ndërnjerëzore 'Kalif' do të thotë burrë shteti, prijës dhe udhëheqës shpirtëror i njerëzimit.

Kështu All-llahu i tha Davudit: "O Davud: Ne të kemi bërë Kalif në Tokë, prandaj gjyko ndërmjet njerëzve me drejtësi..."

Se sa është në gjendje ta zëvendësojë një njeri i thjeshtë të zgjedhurin e All-llahut të Lartëmadhëruar nuk është tema jonë e diskutimit, por, historia e ka njohur të parin e muslimanëve me emrin 'Kalif'. Personalisht, mendoj se ky emërim ishte shumë i drejtë për muslimanët e hershëm dhe kështu duhej të vazhdohej, por, fatkeqësisht ky emërim nuk zgjati për shumë kohë.

Nëse muslimanët arritën t'i përballonin me sukses sulmet e jomuslimanëve, ata e humbën përballjen e tyre të brendshme. Sulmet për ta rrëzuar Kalifin e Drejtë, ishin aq të fuqishme sa që pas dyzet vjet sundimi, ata u detyruan

ta dorëzojnë fronin. Aliu r.a., Kalifi i Drejtë i katërti dhe i fundit, për të mos vazhduar vëllavrasjet deri në pafundësi, u detyrua t'ia lëshonte vendin Muaviut. Pas përmbysjes së Kalifit të drejtë, Muaviu, gjithashtu, e emëroi veten 'kalif' për të lënë trashëgimtarë djalin e vet, Jezidin.

Islami ishte ngulitur fort në zemrat e muslimanëve, prandaj të gjithë trashëgimtarët që do të zgjidheshin më vonë do të shpallehin 'Kalifë', por në fakt ata ishin shndërruar në mbretër. 'Kalifët' i ngjasonin mbretërve të botës si nga pamja e jashtme, ashtu edhe nga trashëgimi, por ata, ndër muslimanët, nuk ishin sovranë, sepse gjyqësori-she-riati kishte autonominë e vet të plotë.

Në kohën kur lindën kalifët-mbretër, në shtetin musliman si kundërpërgjigje lindi Lëvizja e Imamëve: të bazuar në fjalën e All-llahut që ia tha Ibrahimit a.s. pasi e provoi atë. All-llahu i tha: "... Unë do të bëj imam (prijës) të njerëzve! - "Po pasardhësit e mi?" - pyeti ai, Allahu tha: "Premtimi Im nuk i përfshin të padrejtët." Meqë çifutët nuk pajtoheshin me pejgamberinë e Muhammedit s.a.v.s., si trashëgimtar gjenealogjik i stërgjyshit të tij, Ibrahimit a.s. të Lagjes së Pejgamberëve, me lindjen e kalifëve-mbretër, nga lëvizja imamite u rishfaq kjo trashëgimi, por me emrin "Familja e Shtëpisë (Pejgamberit)-Ehlul Bejt" të bazuar në ajetin kur'anor: "...O Familje e Shtëpisë (Pejgamberit)! Në të vërtetë, All-llahu do që



Si bëhej përzgjedhja e Muhammedin s.a.v.s.?

ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."

Si bëhej përzgjedhja?

Nëse hedhim një vështrim të shkurtër në shekullin e shtatë gregorian, rreth përzgjedhjes së prijësit të një vendi, shteti, ose një perandorie, themi se në atë kohë mbretëronte sistemi trashëgimtar, sovrani i të cilit ishte mbreti ose perandori.

Në këto shekuj, Bizanti dhe Persia ishin fuqitë më të mëdha të kohës. Sikur bizantinët ashtu edhe persët, prijësit e tyre të rinj i zgjidhnin pa kokëçarje të mëdha, populli nuk kishte gjë në dorë. Nëse parardhësi tyre kishte lënë trashëgimtarë, qofshin ata foshnje ose të paaftë për të udhëhequr vendin, ata do të konsideroheshin të parët e vendit ose perandorë. Mjaftonte të kishin gjak perandorak dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë i konsideronin për perandorë. Atëbotë gjaku perandorak nuk ishte i njëjtë me gjakun e njeriut të thjeshtë, besohej se gjaku perandorak kishte përbërje ose ngjizje hyjnore. Por kishte raste që edhe dikush tjetër të kishte gjak perandorak dhe në këso raste plaste sherri brenda familjes perandorake. Sikur rasti i djalit të Justinianit dhe shumë të tjerëve: "Pas vdekjes së Justinianit, nëna perandoreshë, Anastasia, rendi të strehohet bashkë me nipin, Tiberin, në kishën e Shën Mërisë së Blankernës.... Njëri prej burrave shkoi drejt altarit ku qe kapur fort fëmija i tmerruar, që në dorën tjetër shtrëngonte një copë të Kryqit të Vërtetë. Ushtari ia mori relikën nga altar, pastaj e tërhoqi zvarrë robin e vogël, nën protikun e një kishe aty

pranë dhe siç tregon një kronist "e theri si berr". Me vdekjen mizore të fëmijës gjashtëvjeçar u shfaros përgjithmonë dinastia e Herakliut."

Në këso tragjedi mbaronin edhe ata të Persisë: "Ndërkaq Kosroeja u mbyll në burg nga djali tij Siroja dhe i jepnin vetëm bukë e ujë sa për t'i zgatur agoninë. Ditën e pestë e vranë me shigjeta."

Historia ka përshkruar shumë shembuj tragjikë të vrasjeve dhe burgimeve të familjeve perandorake të atyre kohërave, deri në shekullin e XX-të. I ndodhur para këtyre fakteve historike, shpeshherë pyes veten, a ishte e mundur të mbijetonte Sistemi i Ri Botëror i prezantuar nga një komb i ri, i cili sapo ishte themeluar? Arabët, deri në kohën e Muhammedit s.a.v.s., kishin qenë beduinë të thjeshtë, thënë shkurt, kishin qenë njerëz që merreshin me mbijetesën. Me vdekjen e Muhammedit s.a.v.s., këta beduinë të islamizuar do t'u jepnin një mësim për të mos e harruar kurrë të gjithë mbretëritë të botës dhe në veçanti dy super perandorive të botës.

Zgjedhjet e para të lira në botë

Pas gjithë këtij përshkrimi historik që i bëmë figurës së Muhammedit s.a.v.s., konstatojmë se ai ishte bërë shkaktar për t'u bashkuar të gjithë arabët e Gadishullit në një fjalë dhe në një veprim. Dhe jo vetëm i bashkimit të tyre, por, vepra e tij i kaloi të gjithë kufijtë kombëtarë, edhe pse ai fizikisht nuk arriti t'i bashkonte popujt e tjerë të botës. Historia e ka dëshmuar këtë, sepse për një kohë shumë të shkurtër, popujt, nga Spanja në perëndim, e deri në Kinë në lindje, u vëllazëruan. Kjo energji njerëzore nuk është shuar akoma. Ne jemi duke e përjetuar këtë fuqi njerëzore dhe, pa dyshim, kjo do të vazhdojë kështu edhe në gjeneratat e ardhme që do ta implementojnë këtë program Hyjnor.

Ashtu siç kemi thënë më herët, ai nuk ishte dijetar, e as shkencëtar, ai ishte një njeri thjeshtë, ishte si të gjithë të tjerët. Për dallim nga ne, ai ishte i zgjedhur nga Krijuesi për ta informuar njerëzimin për të gjithë ato që i Shpallëshin prej Tij. Për këtë arsye ai, s.a.v.s. nuk e emëroi

pasardhësin e vet. E si ta bënte një gjë të tillë kur atij nuk i ishte shpallur asgjë për këtë? Pa dyshim, ishte Urtësia Hyjnore që Muhammedi s.a.v.s. të mos linte pas vetes asnjë trashëgimtar. Mbase edhe muslimanët do të kishin zgjedhur për trashëgimtar, si gjithë të tjerët, djalin e tij sikur ta kishte, por për vetë faktin se ai nuk kishte lënë trashëgimtar, ata u sprovuuan me një formë të re zgjedhjeje, të cilën atyre iu desh të përpiqeshin për ta gjetur. Zgjedhja e Kalifit në formën në të cilën u ai zgjodh, ishte forma më e re dhe e para e këtij lloji të zgjedhjeve në botë. Kjo formë e zgjedhjeve doli si rezultat i këshillave të All-llahut në Kur'an dhe praktikës parlamentare të Muhammedit s.a.v.s.. Kjo praktikë e zgjedhjeve do të rifillojë së aplikuari ndër njerëz vetëm pas katërmëdhjetë shekujve.

Cili do ta zëvendësojë

Muhammedin?

Na është bërë e njohur se Muhammedi s.a.v.s. e kishte shtëpinë e tij ngjitur me xhaminë. Disa nga besimtarët, kur morën vesh për vdekjen e tij, të befasuara, për një çast, u tërbuan. Është gënjeshtër - tha Omeri, "ai i cili më thotë se Pejgamberi s.a.v.s. ka vdekur, do ta mbys me këto duart e mia". Këto fjalë lënë të kuptohet se shumë kush nuk e kishte idenë se ç'duhet bërë pas vdekjes së tij. Në këtë moment të vështirë, ose në këtë shok që pësuan besimtarët, u ngrit Ebu Bekri në këmbë dhe tha: "Ai i cili ka besuar Muhammedin, ai tani veç ka vdekur. I Dërguari i All-llahut nuk do të jetë më në mesin tonë. Ndërsa ata që besuan All-llahun, Krijuesin e botëve, Ai është i gjallë dhe nuk vdes kurrë". Këto fjalë sikur e ulën tensionin dhe hutinë e të pranishmëve në xhami, ndërsa Omeri r.a. dha shenjat e stabilizimit dhe falënderoi Ebu Bekrin për ndërhyrjen e tij. Duke e kuptuar barrën që kishin shokët e Muhammedit s.a.v.s., një grup prej ensarëve u mblodh dhe filloi të diskutonte për Kalifin e ri. Nuk vonoi as një orë, Ebu Bekri, Omeri dhe Ebu Ubejde shkuan në atë tubim. ■

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)

Roli i besimit islam në parandalimin e çrregullimeve në shoqëri

Prosperiteti i Kosovës në varësi nga koekzistenca fetare dhe

Toleranca fetare e popullit shqiptar mbështetet në vetëdijen kombëtare, në faktin se të gjithë shqiptarët e të gjitha besimeve janë të një gjaku dhe të një gjuhe, kanë origjinën, historinë, truallin dhe traditën e përbashkët, janë pra një vëllazëri e gjerë, një popull. Kjo vetëdije ka ndikuar fuqimisht në kohezionin kombëtar me përmasa më të gjera dhe e ka mobilizuar popullin shqiptar gjatë historisë për t'u bërë rezistencë përpjekjeve të vazhdueshme të të huajve që ta përçajjnë dhe ta sundojnë atë

Emine A. VEZAJ

Janë të shpeshta pohimet se Kosova është e kosovarëve, përkatësisht e banorëve të saj. Kjo nuk mund të jetë asgjë tjetër pos një indikacion që atribuon përgjegjësinë e tyre që ata duhet ta kenë ndaj Kosovës dhe lundrimin të saj në valët kohore.

Kosova në retrospektivë

Tani, me formimin e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran, ne të gjithë jemi duke parë përpjekjet e qytetarëve të saj për anëtarësimin dhe inkuadrimin e Kosovës drejt strukturave më të larta ndërkombëtare. Megjithëse e "viktimizuar" disa herë gjatë historisë në periudha të ndryshme kohore, ajo sërisht nuk ndalet për të vajtuar të kaluarën, por është duke kontribuar në vazhdimësi për një të ardhme me të ndritur për qytetarët e saj.

Lëndimet e marra gjatë luftës së fundit nuk qenë të limituara vetëm për një kohë të caktuar, bie fjala vetëm gjatë atij konflikti të armatosur, por ato mbizotërojnë ende si gjurmë serioze dhe me pasoja të pashërueshme për shoqërinë dhe të ardhmen e Kosovës.

Madje pasojat e luftës tani po shfaqen përherë e më shumë. Varret e zbuluara, listat e të zhdukurve, sërisht janë fakte rrëqethëse që trazojnë ndjenjat e shqiptarëve. Traumata e përjetuara në ato ditë të mynxyrës serbe ende nuk do të zhduken plotësisht, sidomos tek fëmijët të cilët ishin viktimat më të pakursyera të kësaj mynxyre. Tani, ne të gjithë sa do të donim që ajo e kaluar të mbetet pa "koment" për faktin se karakterizimi i luftës ishte me ata që sot megjithatë janë element i pashmangshëm për sendërtimin e imazhit të Kosovës, po aq edhe do të donim që ajo të mbetet një leksion i mirë dhe profitabil në hapat tonë drejt së ardhmes. Kjo do të thotë se ne mund të ecim përpara edhe duke shikuar mbrapa, por jo me përfytyrime emocionale të së kaluarës, sepse në vazhdimësi do të jenë motiv çrregullues për shoqërinë në përgjithësi. Nga kjo e fundit marr shkas të them se: një pjesë e trupit e lënduar për herë të parë me shumë lehtësi mund të shërohet se sa ajo që shërohet për së dyti. Dhe tani akoma pa harruar luftën tmerruese të fundit në Kosovë, jo larg nga ajo rikujtojmë edhe trazirat e 17, 18, 19 marsit të vitit 2004, të cilat qenë një leksion i qëndrueshëm se veprimet mbi baza emocionale janë të paarsyeshme dhe të dëmshme për proceset që çojnë drejt zhvillimit dhe stabilitetit të një rajoni. Kujtojmë, se pasojat e dala nga dy tri ditë trazirash ishin jo më pak se dhjetëra të

vdekur e qindra të lënduar. S'duhet harruar se edhe kostoja e riparimeve të shkatërrimeve materiale ishte një shumë e madhe të hollash. Tani, pas kësaj, kush mund ta rikthejë besimin e humbur të të huajve që kishin fituar për kosovarët si një popull bujar, i qëndrueshëm, paqdashës etj? E gjitha kjo thuhet u rrënuar brenda një dite, pastaj, çka fitoi Kosova nga kjo, pos që humbi.

Cilësimi i Serbisë nga qarqe botërore si gjakatare dhe cënues e paqes në rajon për shkak të veprimeve antinjerëzore të ndërmarra gjatë luftës në Kosovë dhe Bosnje Hercegovinë, si dhe kryeneçësia e saj ndaj Bashkësisë Ndërkombëtare, nuk duhet të na shërbejnë neve si model i shkëlqyer se si bëhet lufta. Kjo duhet të na vetëdijesojë për një kooperim më të përafërt, ngase për të mos u etiketuar si të tillë, ne duhet të bëjmë përpjekje të vazhdueshme për një kultivim koekzistence me fqinjët tanë të të gjitha konfesioneve, etnive etj. Plagët e mara nga Serbia, vite me radhë e në veçanti gjatë konfliktit të fundit, janë monstruoze dhe shumë rrëqethëse. Këtë se mohon askush. Por, në këto kohë paqeje dhe të pas pavarësisht, Kosova është duke dhënë shembullin e një nxënësi të shkëlqyer se si është duke menaxhuar punën e saj. Praktika duhet ndërtuar gjithmonë në bazë të një teorie të mirë. Teoria e saj ishte periudha disavjeçare e kaluar brenda një mbikëqyrësi "legjitim"-UNMIK, ndërsa praktika e saj është, aktivizimi drejtpërdrejt në të gjitha organet vendimmarrëse në strukturat vendore dhe ndërkombëtare. Ndonëse nuk është ende kohë e rezultateve përfundimtare, shpresat për rezultate të mira janë në favor të pozitivitetit - optimizmit.

Kosova nën hijen e vizionit të ri

Kosova ndonëse nuk e ka epitetin e një nxënëseje shembullore, megjithatë duket se ka kaluar madje



ësi serioze e etnike

edhe më lartë se suksesin e mirë. Mbase edhe të cilësuarit e saj si shembullore nuk do të paraqiste kurrfarë gabimi, kur dihet se ajo ka tejkaluar disa "provime" të tranzicionit të cilat konsiderohen si shumë të rëndësishme për shqiptarët, kujtojmë këtu, zgjedhjet lokale dhe parlamentare, si dhe finalizimi e Statusin të Kosovës që konsiderohet si kapitulli më i rëndësishëm që karakterizon një pjesë të caktuar të historisë sonë. Së këndejmi, Kosova është kjo që është, ajo ka të gjitha elementet dalluese dhe shtetformuese që e cilësojnë si një shtet legjitim dhe të pranuar nga një pjesë e caktuar shtetesh botërore. Vizioni i qytetarëve të Kosovës duhet të jetë i qartë. Të gjithë duhet të jemi unik në punët dhe angazhimet tona në mënyrë që edhe shteti ynë të marrë pamjen e një shteti që di të tregojë dhe të japë vlera, si dhe di të bëjë zgjidhje për të gjithë. Tashmë të gjithë ne qytetarët e Kosovës duhet të vetëdijsohemi që shtetin tonë ta konsiderojmë si pronë tonën dhe të mundohemi të punojmë aq sa mundemi. Siç punojmë të gjithë për shtimin e pasurisë personale ashtu duhet të mendojmë edhe për pasurinë e Kosovës. Tashmë, kur timoni është në duart tona dhe ne jemi udhëheqës, duhet të japim shembujt më të mirë të një udhëheqje perfekte. Kosova shihet se ballafaqohet me probleme të mëdha të natyrave të ndryshme, si droga, prostitucioni, trafikimi i krijesave njerëzore etj. Këto janë probleme që duhen konsideruar si probleme serioze nga të gjithë shtetasit e shoqërisë, duke filluar prej qytetarit më të thjeshtë e deri te institucionet përkatëse, që mund të ndikojnë në mënjanimin e deri edhe në shmangien totale të të gjithë atyre që shkatërrojnë shoqërinë dhe dëmtojnë imazhin e një shteti. Institucionet ekzekutive janë më me peshë për këtë, por atyre duhet t'u ofrojmë ndihmë dhe bashkëpunim të mirëfillt në identifikimin e shkaktarëve dhe shërimin e pasojave të shkaktuara. ■

(Vazhdon në numrin e ardhshëm.)

Të rinjtë e Kosovës në kërkim të perspektivës

Gjendja e rëndë ekonomike, izolimi si pasojë e regjimit të vizave, papunësia, mos hapja e perspektives..., janë vetëm disa nga faktorët të cilët shtynë të rinjtë e Kosovës t'i drejtojnë sytë nga shtetet e huaja.



Vjollca SHEQIRI

Shumë të rinj e të reja nga Kosova vazhdojnë të kenë në mendje dëshirën që të marrin rrugën drejt ndonjë vendi tjetër, me iluzionin se mund të gjejnë ndonjë perspektivë e cila këtu iu mungon.

Harisi, 21 vjeçar, nga Prishtina ëndërron që të shkojë në Angli, pasi që mendon se atje do të ketë perspektivë më të madhe për të formuar një karrierë të ndritshme, siç e quan ai. "Anglia është vendi ku unë mund të filloj të ndërtoj karrierën time prej artisti" - thotë Harisi, i cili tani sa ka mbushur 21 vjet. Ai thotë se në Kosovë ka mungesë idesh për të stimuluar të rinjtë që të punojnë.

"Nuk na ndihmojnë neve të rinjve me asnjë projekt. Duhet me pas të njohur, ose para. Pa para s'ka asgjë" - thotë Harisi, i cili nuk ka mundur të regjistrohet në universitetin publik të Prishtinës. Tani ai mendon si të gjejë një zgjidhje, e më e "mira" i duket ajo e migrimit. "Më mirë të shkoj diku jashtë, ndoshta e gjej veten. Parapëlqej Anglinë, por nuk po kemi as aty mundësi të marrim viza" - thotë Harisi, i dëshpëruar me jetën në Kosovë.

Të njëjtën gjë e dëshiron edhe Lulja nga Prishtina, e dashuruar në një djalë nga Prizreni, që jeton në Zvicër. Ajo dëshiron që të jetë pjesë e Evropës, duke u "barazuar" me të dashurin e saj, Astritin. "Ata kanë gjithçka, ne asgjë, më vjen turp edhe prej tij, se në çfarë kushtesh jetojmë ne" - thotë Lulja. Ajo u bën apel drejtuesve të institucioneve të Kosovës që të bëjnë më shumë për të rinjtë.

"Le të na ndihmojnë edhe neve politikanët e jo vetëm fëmijët e tyre. Edhe ne jemi pjesë e Kosovës" - shprehet Lulja, e dëshpëruar me jetën në Kosovë.

Pak më optimist se dy të parët është Albani. Ai ka një punë, që sipas tij është

e mjaftueshme për të dhe ia ka fashitur dëshirën që të shkojë në ndonjë vend të botës, për të fituar më shumë. "Nuk do të doja të dilja jashtë Kosovës për të punuar. Kam një rrogë mesatare, që më mjafton të jem afër familjes" - thotë Albani. Ai është i vetëdijshëm se gjendja e të rinjve në përgjithësi është e vështirë, por jo edhe në atë masë si e përshkruajnë shumë. "Është e vërtetë që nuk ka mjaft hapësirë për projektet e të rinjve, por jo edhe aq sa thotë dikush - dikush" - pohon Albani.

Në botën e jashtme jetojnë rreth 450 - 600 mijë shqiptarë të Kosovës

Trendi i largimit të të rinjve nga Kosova është duke vazhduar. Sipas të dhënave që jep SHPK-ja, vetëm në gjashtë mujorin e parë të këtij viti, nga Kosova janë përpjekur të ikin rreth 250 persona. Ndërkaq, në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kjo shifër ka qenë më e madhe për 50 persona.

Hulumtime të bëra nga organizata të huaja dhe vendore kanë "zbuluar" disa nga arsyet që i detyrojnë të rinjtë për ta lëshuar Kosovën. Ata vënë në pah gjendjen e rëndë ekonomike, izolimin që kanë të rinjtë, pasi nuk kanë mundësi të udhëtojnë për shkak të vizave dhe një sërë faktorësh socialë.

Momentalisht, zyrtarët e ministrisë së shërbimeve publike kanë thënë se numri i shqiptarëve të Kosovës që jetojnë në migrim, është tejet i madh. Sipas zëvendësministrit të ministrisë së shërbimeve publike, Rifat Blakut, në botën e jashtme jetojnë rreth 450 deri në 600 mijë shqiptarë. Ky numër ka qenë edhe më i madh, por qeveritë e huaja, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kanë ndërhyrë në fushatë për kthimin e tyre në vendlindje. Një rast, ku qytetarët e Kosovës nuk kanë dashur të kthehen, pavarësisht urdhrin për të lëshuar vendin ku kanë migruar, ka qenë rasti i Arigona Zogajt, e cila ishte zhdukur për javë të tëra, vetëm e vetëm që të mos kthehej në Kosovë. ■

Reportazh nga familja e të zhdukurit Bedri Tafë Bashota

Inshalla bahet ashtu qysh e ka shkru i Lumi ZOT!**“Qe nëntë vjet, sa herë që dëgjoja për ndonjë gjetje të personave të zhdukur, gjithandej Kosovës kam shkuar për ta kërkuar vëllain tim” - ka thënë Ismeti, arsimtar i Edukatës Qytetare në Shkollën Fillore “Esat Mekuli” të Caravikut****Berat DAKAJ**

Eshtë një ditë e diel me diell. Rrezet e diellit janë mjaft ndriçuese, por të ftohta. Gjyshja Halime ka një shprehje tjetër për këtë ndriçim dielli. Ajo thotë: “Sot ish diell me dham...”.

Halimja, nëna e Bedriut të zhdukur, një plakë 80-vjeçare me rrudha të shpeshta në fytyrë, duket sikur t'i ketë aq sa vjetët. Është ende e fortë nga kujtesa e nga shëndeti, ruan kujtime nga jeta e saj bardh e zi, kujtime nga ditët e luftës e të bredhjes së saj nëpër Kosovë për ta kërkuar të birin.

Nëntë vjet sa nëntëqind...

Nëntë vjetët e humbjes së birit të saj për të janë sikur 900 vjet. Janë vitet e dhembjes së mungesës së njeriut të dashur familjar. Çdo vit, festat fetare në familjen e saj janë më të zbrazëta. Çdoherë në to, për dallim nga 365 ditët e tjera të vitit, mungon më shumë Bedriu, mungojnë fjalët e tij “nënë”, “babë”, “vëlla”, “motër”; mungojnë urimet e tij “për hair Bajrami”, “për hair martesë”; mungojnë: lëvizja e tij, përkrahja e tij, buzëqeshja e tij, rrobat e reja ose të baltosura të tij, mungon vetë ai. Por, megjithëqë ikën nëntë vjet që nga ndarja fizike me të (Bedriun), familja e tij ende me gjakftohtësi, me dhembje që bluan trupin e përcillet herë-herë me lot, bart dhembjen nga viti në vit, nga miku në mik, nga vendi në vend.

“Qe nantë vjet jam nda prej djalit tem. Qe nantë vjet e sjellim, e blujmë dhe e ndajmë dhimbjen për humbjen e tij nshpinë tonë. Ndjej dhimbje shumë t'madhe për të, sikurse për të gjithë t'zhdukurit e tjerë, të atyne nanave që kurrë nuk pushojnë së qari për bijtë e vet” - shprehet nënë Halimja gjersa del në ballkonin e shtëpisë së rindërtuar

pas përfundimit të luftës, për ta përsëndetur plakun (burrin) e vet, axhën Tafë, teksa futet në oborrin e ngushtë me bagëtinë që e ka lëshuar në të gdhirë të së dielës.

Axha Tafë është rreth 90-vjeçar, por shumë i fortë fizikisht dhe mendërisht, ashtu sikurse gruaja e vet (Halimja). Nganjëherë, kur kafshët marrin vrapin për ndonjë kullosë “haram”, Tafa vrapon për t'ua marrë anën. Madje ka fuqi t'ua hedhë prapa edhe shkopin e drunjtë të trashë e të gjatë.

“Beso, - më thotë ai, - edhe n'k'it moshë jam n'gjendje me shku kamb' këtu e n'Rahavec, ashtu qysh shkojshum me babgjysh tanin (flet për babgjysh timin) para 60 vjetësh, atë rahmetlin”.

Dhe me të vërtetë axha Tafë ende është i fortë. Është pak thatim, por nuk e ka lëshuar kujtesa. Thotë se i ka punët mirë me të dyja. Plakjen e vetme të tij e heton në rrudhat e fytyrës dhe dhëmbët e rënë, të cilët e pengojnë për të lëshuar zë rrjedhimisht.

Sikur të gjendeshin eshtrat e djalit, gjysma e dhembjes kishte me mu hjek

Gjyshja Halime mund ta gjejë qetësinë në këtë botë nëse gjenden për të gjallë të saj eshtrat e djalit të saj: “Djali i nanës, - më thotë mua, - sikur të gjendeshin eshtrat e djalit, gjysma e dhembjes kishte me mu hjek. Do të kish dit Halimja (thotë për vete) se ku pushojnë eshtrat e tij, do të kish dit se asht duke derdh lot mbi varrin e tij, do të kish dit se është duke e ndreq varrin e tij. Ai humbi pa më lënë grua e as fëmijë të vet në shpi (ishte i pamartuar)”. E axha Tafë, për ta larguar emocionin e dhembshëm e prekës të saj,

Bedri Tafë Bashota, i lindur më 1.1.1969 në Caravik të Klinës, është zhdukur më 1.5.1999 në fshatin Kijevë të Komunës së Malishevës.

gjen përkrahje te Perëndia: “Inshalla bahet ashtu qysh e ka shkru i Lumi ZOT, oj gruaaaa...! Boll i ke djemtë tjerë, Xhaferin, Ismetin, Enverin, Elmin (vër. yni - Elmiun)”, të cilit menjëherë, me një zë të ngadalshëm, iu përgjigj gjyshja Halime: “Po, po, shyqyr Zotit që janë mirë e po na ndihmojnë. Zoti i ruajt!”

Axha Tafë ishte rreth 80 vjeç kur filloi Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Atëkohë kishte shprehur dëshirën të vishej ushtar i UÇK-së. Kishte zbritur nga kulmi pushkën “M 48” dhe me vrap ishte nisur t'i dalë ushtrisë serbe përballë, ta luftojë “hasmin e egër”, i cili, sipas tij, “gjithherë diti vetëm të gëlltitë”.

Ai ka kryer pak shkollë, por di shumë. Thotë se çështja e të zhdukurve nuk mbyll konfliktin me Serbinë, sado që ka përpjekje për pajtim dhe marrëdhënie të ndërsjella mes këtyre vendeve.

“Familjet nuk i harrojnë njerëzit e vet që ua kan' pre e gri shkiet. Ato janë plot vrer ndaj shkive, kurdoherë. Edhe zogun me ta myt hasmi është randë, se leje ma evladin, që nuk falet hiq” - thotë xha Tafa, i cili na përcjell deri te dyert e oborrit, e aty takojmë, duke ardhur te prindërit, të birin e tyre, profesor Ismetin e thinjur, i cili na tregon për përpjekjet e tij për kërkim të vazhdueshëm të vëllait.

“Kam shkuar gjithandej Kosovës, që nëntë vjet, për ta kërkuar vëllain tim sa herë që dëgjoja për ndonjë gjetje të personave të zhdukur” - tha Ismeti, arsimtar i Edukatës Qytetare në Shkollën Fillore “Esat Mekuli” të Caravikut.

Edhe ne u ndamë nga familja Bashota, u përshëndetëm me gjyshen Halime, xha Tafën, profesor Ismetin, por me vete, për në Prishtinë, morëm një copë dhembje të tyre, të cilën u përpoqëm ta zbrazim e shpërndajmë, sa me shkrim, sa me lot, në veturë e këtu në “Paqe”. Dikur, në të hyrë të Prishtinës, të katër shokët që ishim për vizitë te kjo familje, mblodhëm veten e nisëm të shpresojmë se koha do t'i shërojë plagët shpirtërore të këtyre të gjallëve për të vdekurit. ■

Integrimi i pakicës shqiptare në Strukturat Shtetërore të Serbisë

Shqiptarët – i vetmi entitet në Serbi pa Këshill Nacional

Derisa në Kosovë, serbët mund të kenë çdo mundësi për t'u integruar, duke filluar nga përfaqësimi i tyre me 20 për qind në Parlament dhe dy ministri e disa zëvendësministra, në Parlamentin e Serbisë ka vetëm një ulëse për shqiptarët e Preshevës, Bujanocit e Medvegjes.

Ferid SELIMI

Shqiptarët e Preshevës, Bujanocit e Medvegjes, të sistemuar në shumë parti e grupime qytetare (gjithsej 10 sish), veprojnë politikisht në kuadër të Republikës së Serbisë, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të zgjedhur me votën e lirë. Kështu, prej 10 subjekteve politike, katër parti dhe dy grupime qytetarësh kanë selinë në Preshevë, tri parti politike në Bujanoc dhe një parti politike në Medvegje. Nëpër Kuvendet Komunale (pas zgjedhjeve të fundit lokale) përfaqësohen pesë parti dhe dy grupime qytetare.

Kundërthënie rreth formimit të Këshillit...

Të tri komunat, nga këshilltarët e zgjedhur komunalë, kanë nxjerrë Kuvendin e Këshilltarëve shqiptarë të tri Komunave, që herë pas here takohen dhe shqyrtojnë e mbase edhe marrin vendime, për të cilat, pretendojnë që janë çështje që duhet diskutuar.

Ky organ i dalë nga këshilltarët e zgjedhur shqiptarë i këtyre tri komunave, mëton të kryejë funksionin e Këshillit Nacional të shqiptarëve në Serbi, që për çudi, mbase është i vetmi entitet në këtë shtet që, nuk ka themeluar Këshillin Nacional. Liderët partiakë shqiptarë të këtyre tri komunave, nuk po tregojnë gatishmëri për themelimin e një trupi të tillë, që për momentin, duket të jetë i domosdoshëm.

Disa herë është ndërmarrë iniciativa për themelimin e këtij Këshilli, por deri më sot nuk është arritur të gjendet një gjuhë të përbashkët. Duket që sharra ka hasur në gozhdë rreth dilemës se si do të dukej ky Këshill.

Shqiptarët që jetojnë në Serbinë Qendrore harrohen edhe më tej

Sipas burimeve informative të përfaqësuesve të disa subjekteve politike, ekzistojnë disa mospajtime rreth themelimit të një organi të tillë.

Mospajtimi i parë: Është një palë që kërkon që Këshilli Nacional të jetë në kuadër të institucioneve dhe të përbëhet nga anëtarët e Kuvendeve Komunale të zgjedhur nga vota e lirë. Ndërsa pala tjetër, e do këtë Këshill jashtë institucioneve shtetërore serbe dhe kërkon shtrirje më të gjerë të anëtarëve të këtij Këshilli, përfshirë edhe pjesëtarë nga shoqëria civile.

Mospajtimi i dytë: Emërimi ose zgjedhja e liderit të Këshillit Kombëtar. Kjo është një çështje shumë e ndjeshme, sepse shumë nga liderët e partive shqiptare të këtyre tri komunave, duan të kenë postin e kryetarit të Këshillit Kombëtar. Andaj, themelimi i këtij organi, mbetet pre e disa liderëve partiakë shqiptarë të Preshevës, Bujanocit e Medvegjes.

E treta: Secila nga këto tri Komuna, do që përfaqësuesi i Komunës së tyre ta udhëheqë Këshillin Kombëtar; dhe

E katërta: Harrohen edhe më tej shqiptarët që jetojnë në Serbinë Qendrore. Kur studiohen dhe analizohen krejt këto, del që liderët partiakë shqiptarë të Preshevës, Bujanocit dhe të Medvegjes, nuk e dëgjojnë zërin e arsyes për të themeluar Këshillin Kombëtar, edhe pse një organ i tillë ka kohë që u nevojitet shqiptarëve të këtyre tri Komunave.

Serbët në Kosovë gëzojnë shumë më tepër të drejta se sa shqiptarët në Serbi

Në strukturat shtetërore, koalicioni i shqiptarëve i këtyre Komunave ka një ulëse në Parlamentin serb dhe deri para zgjedhjeve të fundit, ishin pjesë e Trupit Koordinues që Qeveria e Republikës së Serbisë e kishte themeluar mu për shkak të integritetit të shqiptarëve të kësaj ane, në shoqërinë serbe. Mirëpo, që nga zgjedhja e Qeverisë së re, shqiptarët e këtyre tri Komunave, ende nuk janë përcaktuar për të qenë sërish pjesë e atij organi.

Integrimin në këtë trup politik, partitë politike shqiptare të këtyre tri Komunave, më parë, pos kushtit për integrimin e shqiptarëve

në strukturat shtetërore serbe, e kushtëzonin edhe me pranimin e diplomave të Universitetit të Prishtinës. Sepse, përfaqësuesi i Partisë Socialiste të Serbisë, me ardhjen në krye të ministrisë të arsimit në Qeverinë e Serbisë, vendosi në mënyrë të njëanshme të mos pranonte diplomat e lëshuara në Universitetin e Prishtinës e të vulosura nga UNMIK-u. Tani kur është rizarituar pranimi i diplomave, ka mbetur për t'u plotësuar kushti i parë që ka të bëjë me integrimin e shqiptarëve në organet shtetërore.

Kur vihet një paralele dhe krahasohet përpjekja e Pushtetit Qendror të Republikës së Serbisë në integrimin e pakicës shqiptare të Preshevës, Bujanocit e Medvegjes në përfshirjen në Organet Qendrore të këtij shteti, me përpjekjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të integruar pakicën serbe në strukturat e Pushtetit Qendror të Kosovës, do të shihet një disharmoni e politikë-bërjes dhe pjesëmarrjes se këtyre pakicave në organet shtetërore.

Derisa në Kosovë, serbët mund të kenë çdo mundësi për t'u integruar në shoqërinë kosovare, duke filluar nga përfaqësimi i tyre me 20 për qind në Parlament dhe dy ministri e disa zëvendësministra në Qeverinë e Republikës së Kosovës, në Parlamentin e Serbisë ka vetëm një ulëse për shqiptarët e këtyre tri Komunave.

Pragu zgjedhor dhe kuota e madhe e votave (15.000 vota për një ulëse), kanë bërë që shqiptarët mezi të sigurojnë një ulëse në Parlamentin e Republikës së Serbisë.

Edhe pse në Preshevë e Bujanoc ka rreth 50 mijë votues shqiptarë, dalja e tyre në zgjedhje parlamentare është e ulët, sepse Pushteti Qendror i Republikës së Serbisë nuk e motivon pakicën shqiptare për të kryer obligimin e tyre qytetar. Andaj, mezi tubohen 15 mijë vota për të siguruar një ulëse në Parlament.

Zëri i një Deputeti në Parlamentin e Serbisë dhe një nënkryetar në Trupin Koordinues, janë të vetmet poste për çfarë mund të shpresojnë shqiptarët e këtyre komunave. ■

Esenca e artit islam

Arti islam ka një synim të ngjashëm me atë të Kur'anit – të mësojë dhe përforcojë tek njerëzimi perceptimin e transcencës hyjnore. Kur'ani i Shenjtë siguron një burim të gatshëm dhe logjik të inspirimit për krijim estetik. Artet islame, si rrjedhim, mund të emërohen me plot të drejtë “arte kur'anore”

Mimoza SINANI

'Natyra simbolike' e artit islam

Një numër studiuesish kanë shkruar vitet e fundit rreth natyrës simbolike të artit islam. Cilësimi i tyre 'simbolik' për artin islam nuk nënkupton thjesht nocionin e pranuar universalisht se artet janë një mënyrë për të shprehur një ide abstrakte në poezi, ngjyra, vija, trajta, tinguj, lëvizje dhe me radhë. Në këtë sens, natyrisht, i gjithë arti është simbolik. Këta shkrimtarë pretendojnë shumë më tepër për ato që ata i shohin si implikime simbolike të artit islam. Për ta, format, trajtat, objektet, skenat dhe madje shkronjat dhe numrat e përdorur në artin islam, kanë një kuptim të fshehtë. Sikurse paraqitet antropomorfike të perëndive dhe perëndeshave kanë kuptim të veçantë religjioz për hindunë; apo kryqi, skena e kryqëzimit dhe statuja e Krishtit janë simbole të fuqishme për të krishterët; po ashtu, vazhdon argumenti i tyre, ekzistojnë “simbole islame” të veçanta të cilat paraqesin vizualisht një numër të madh domethëniesh që kapen dhe kuptohen nga shikuesi. Pretendohet se kubeja duhet të konsiderohet si kupë e qiellit; medaljoni në qendër të një qilimi është një paraqitje e vendkalimit në qiell; dekorimi epigrafiq që përfshin emrin e sundimtarit është përkrahje për shtetin politik. Deri edhe zbrazëtia apo “boshllëku” konsiderohet si “një simbol i transcencës së Zotit dhe i prezencës së Tij në të gjitha gjërat.”

Të gjitha këto atribuime të përmbajtjes literale simbolike janë antagoniste me esencën e artit islam dhe me cilësinë e tij abstrakte. Arti islam lindi dhe u zhvillua në një ambient semit, i cili i mohoi dhe i dënoi të gjitha paraqitjet e mbretërisë transcendentë. Ai është një art i bazuar mbi një ideologji – tevhidin – që nuk mund të shprehet estetikisht me anën e lidhjes reale apo të imagjinuar midis natyrës dhe Zotit. Lidhja e tillë është një lloj shirk-u apo “asociacionizmi” i qenieve dhe objekteve të tjera me All-llahun dhe kjo është e ndaluar në Islam.

Është një nocion i pranuar përgjithësisht se shprehja “art i krishterë” lidhet

vetëm me ato objekte arti dhe godina që krijohen për një përdorim veçanërisht religjioz në kulturën e krishterë. Kjo është posaçërisht e vërtetë pas Rilindjes, kur uniteti i jetës në Krishterizëm u thye nga ndarja gjithnjë e më shumë e theksuar e religjiozes nga shekullarja. Në fakt, disa shkrimtarë kanë menduar se, pas Rilindjes, prodhimi i “artit të krishterë” u ndërpre.

Ndërsa në kulturën islame çdo aktivitet, çdo ide, çdo ngjarje dhe çdo objekt, jo vetëm që ndikohet, por, gjithashtu, edhe determinohet nga ideologjia islame.

Disa orientalistë thonë se Islami nuk ka arte figurative (skulpturë, pikturë, art dramatik) për arsye se ai është i lirë nga çfarëdo zotash të trupëzuar apo immanent në natyrë. Ata e nënkuptojnë këtë si një qortim ndaj Islamit, megjithëse ai është në realitet dallimi parësor i Islamit. Është nderi unik i Islamit që ai është plotësisht i lirë nga idhujtaria, nga ngatërimi i krijesës me Krijuesin.

Çifutët kishin pohuar më parë se transcendencë e Zotit nuk e pranon aspak bërjen e “statujave të gdhendura” dhe ata, në përputhje me këtë urdhëresë hyjnore, ishin larguar plotësisht nga çdo art vizual.

Në Romë, në teatrin e dekadencës greke, arti suprem grek i skulpturës u katandis në portretizimin realist empirik të perandorëve të ndryshëm. Në Greqi, arti i dramës u zhvillua përkrah atij të skulpturës, me qëllim që t'i paraqiste konfliktet e përjetshme të zotave me njëri-tjetrin. Qëllimi i përgjithshëm ishte paraqitja e karaktereve të tyre individuale që ishin plotësisht njerëzorë.

Ndërsa kulturat dhe popujt e tjerë mund ta kenë vlerësuar njeriun si “masë të të gjitha gjërave”, apo natyrën si përcaktuesen themelore, përqendrimi i muslimanit tek Zoti ka qenë në transcencën e Tij të pakompromis.

Artet islame janë “arte kur'anore”

Kur'ani synoi të rimësojë doktrinën e monoteizmit, një mesazh që iu ishte transmetuar pejgamberëve të shumtë semitë të kohëve të mëhershme – Abra-

hamit, Noes, Musës, dhe Jezusit. All-llahu përshkruhet në Kur'an si një Qenie transcendentë, për të Cilin nuk është i mundshëm përjetimi vizual apo sensorial.

Ai është përtej përshkrimit ezaurues dhe është e pamundshme që të paraqitet me anën e çfarëdo imazhi antropomorfik apo zoomorfik. Në fakt, All-llahu është Ai i cili i sfidon përgjigjet e pyetjeve: kush, si, ku dhe kur? Është kjo ide e njëshmërisë dhe transcencës absolute të All-llahut që njihet si tevhid.

Arti islam ka një synim të ngjashëm me atë të Kur'anit – të mësojë dhe përforcojë tek njerëzimi perceptimin e transcencës hyjnore. Kur'ani i Shenjtë siguron një burim të gatshëm dhe logjik të inspirimit për krijim estetik. Artet islame, si rrjedhim, mund të emërohen me plot të drejtë “arte kur'anore”.

Shpalljet kur'anore në lidhje me natyrën e Zotit sigurojnë e përjashtojnë paraqitjen e Zotit nëpërmjet mënyrave ndijimore, qoftë në formë njerëzore apo shtazore, qoftë në simbole figurale nga natyra. E tërë ikonografia e artit islam është e influencuar nga doktrina kur'anore e tevhidit, apo monoteizmit islam.

Modeli, i cili nuk ka fillim dhe nuk ka fund, i cili jep përshtypjen e pafundësisë, është si rrjedhim mënyra më e mirë për ta shprehur në art doktrinën e tevhidit.

Tevhidi nuk është kundër kreativitetit artistik dhe as kundër kënaqësisë së bukurisë. Përkundrazi, tevhidi e bekon bukurinë dhe e nxit atë. Ai e sheh bukurinë absolute vetëm tek Zoti dhe tek vullneti apo fjalët e Tij të reveluara.

Tevhidi pohon se asgjë në krijim nuk mund të jetë një përngjasim apo simbol për Zotin. Asgjë nuk mund të përfaqësojë Atë.

Eksperiencia estetike nënkupton eksperiencën përmes shqisave të një esence a priori meta-natyrore. Arti është procesi i zbulimit brenda natyrës të kësaj esence meta-natyrore dhe paraqitja dhe dhënia e kësaj esence në një formë që është e përshatshme për të. Është e qartë se arti nuk është imitim i natyrës së krijuar. Aftësia për të kuptuar se Zoti transcendent është vizualisht i pashprehshëm është objektivi estetik më i lartë i mundshëm për njeriun. ■

Vështrim kritik mbi romanët e Milazim Krasniqit

Statuset tekstuale


Rendi i strukturimit të kujtimeve më shumë është i mbindërtuar gjatë rikthimit, por tani me komentime dhe përshkrime. Komentimi në statusin e shkrimit dhe në shtresën narrative shënjon realen e ekzistuar, duke qenë edhe shenja të sigurt të kësaj reale në paraqitje dhe konkretizim. Situata kohore e ndodhisë, në perceptimin e fakteve, gjatë shtresës së argumentimit të tekstit, i lë vend edhe fiksonit.



Flamur MALOKU

Rikthimi i Kosovës në status shkrimi bëhet temë e mundshme për shumë autorë. Kjo temë, në statusin kategorial/tekstor, forcohet e identifikohet edhe më shumë në fiksonin e shkrimit, kur bëhet i motivueshëm, për të kryqëzuar kështu vazhdimisht në statusin tekstual, situatën dhe përjetimin dramatik në kohë. Koha në shkrim identifikohet dhe konceptohet me Kosovën, temë kjo për të mbetur gjithnjë e rikthyer nga statusi personal në kodin tematik dhe në atë tekstual. Ekzistencialja nacionale në kohë dhe hapësirë, shtresohet e identifikohet në diskursin e njohjes në kuptimin e plotësimit dhe të strukturimit. Idetë mbi ekzistencialen nacionale sa vijnë e theksohen, për t'u bërë formë dhe kategori statusore. Kështu, romanet e Milazim Krasniqit, *"Fijet e shpirtit"* dhe *"Fotografitë e kujtimeve"*, bëhen përcaktuese të mundshme statusore, si në formë ashtu edhe në kategori, për vetë kohën ekzistenciale të kodit të madh nacional. Niveli i shënjuar kohor në vijën narrative ndërtohet gjithnjë duke skicuar situatën. Situata në shkrim rrëfëhet e identifikohet me kohën. Kështu, duke filluar me romanin *"Fotografitë e kujtimeve"*, përshkrimi i ngjarjeve nëpërmjet situatave narrative do të karakterizohet në pikat themelore të strukturës tekstore, padyshim në kuptimin e përjetimit gjatë rrëfimit. Idetë e tekstit sintetizohen në figurën e shprehur, çdoherë duke u shtresuar nëpërmjet shenjave autobiografike. Shenjat autobiografike dalin në kuptimin e riplotësimit. Kjo ndodh sepse autori

pretendon të ndërtojë një sistem të kujtimeve, andaj fotografitë shtresohen në figurën e përjetimit, tani në situatën e përkuajtimit. Rendi i strukturimit të kujtimeve, më shumë është i mbindërtuar gjatë rikthimit, por tani me komentime dhe përshkrime. Komentimi në statusin e shkrimit dhe në shtresën narrative shënjon realen e ekzistuar, duke qenë edhe shenja të sigurt të kësaj reale




në paraqitje dhe konkretizim. Situata kohore e ndodhisë, në perceptimin e fakteve, gjatë shtresës së argumentimit të tekstit, i lë vend edhe fiksonit. Autori këtë e bënë më qëllim në kuptimin e diskursit, edhe pse kujtimet shpallen të zbehura në kohën e tanishme përgjatë rikthimit-përkuajtimit. Për të krijuar faktin kohor, mbi situatën, fillon rrëfimi mbi ato copa kujtimesh të hidhura, të cilat shtjellohen në rrëfim. E shkuara shënjohe me tragjiken e brendshme në

strukturën e romanit, ku pikat themelore të përjetimit bëhen të dallueshme. Duke vazhduar me ngjarje dhe situata, të cilat tani gjykohen në të tashmen, ato dalin edhe si tituj tregimesh në vete: *Baba, Nëna, Dardhana, Marksi, Tito, Enveri*. Kosova dhe ngjarjet që janë përjetuar, tani në statusin tekstual evidentohen nëpërmjet argumentimit. Kjo njëherësh e rrit edhe më shumë shtresimin e tekstit dhe ndjeshmërinë emocionale gjatë komentimit, kur kihet parasysh edhe koha e sugjeruar. Në këtë rast sugjerimi, del shenjë e botës së brendshme të shënjesit-autorit. Në të njëjtën kohë del edhe si dëshmi shpirtërore. Teksti këtu bashkon shqetësimin përmes artikulimit të dëshpëruar, kur kujtohen ngjarjet në hapësirën e ndodhur. Prandaj, mbizotëron figurshmëria dhe ndjeshmëria autoriale gjatë perceptimit të kujtimit. Dhembja e kërkimit të situatave dhe e zbulimit vjen si hapje e botës së brendshme e shkrimit autobiografik, që shumëfishohet në një gjakim. Shtresimi dhe kërkimi i kujtimeve konceptohet edhe në monologun e brendshëm, dialogun dhe përshkrimin karakterizues. Është ky rasti ku bëhet njëherësh edhe perceptimi i jetës, vuajtjes dhe dhembjes. Kjo ndodh edhe atëherë kur rrëfimtari shënjon censurat e kohës, kur nuk guxohej të pëshpëriteshin as lutjet shpirtërore, të cilat tani janë të pashlyeshme në mendjen e tij, duke lënë gjurmë të thella. Pra, çdo gjë skicohet në kohën, duke e shtresuar kështu rrëfimin në pozicionin e argumentimit-komentimit:

"Arsimtari i historisë shpurdhte si zorra në prush, më kërcënonte e përpiqej të më kapte për fyti. Vetëm kur pëshpëritja lutjen që ma kishte mësuar nëna "La ilahe ilallah" më hiqej frika dhe ndieja trupin të më lehtësohej".

Ky është skicim në rrafshin e aftësisë dhe të vetëdijesimit shpirtëror,



në strukturën narrative shtjellohet me karakterizimin dhe qëndrimin e paluhatshtëm. Është rasti kur diskutohet mbi njerëzit dhe figurat e pavlera, që dikur identifikoheshim më to. Është rasti kur personazhi-narrator, tregon historinë e zhgënjimit mbi Enver Hoxhën. Fotografia e tij që dikur mbahej e fshehur nën kresë nga i vëllai i Muhametit, thekson tani besueshmërinë e kotë të kësaj figure të rreme, për një mbrojtje gjithë kombëtare, në kuptimin e idesë nacionale. Pra, këtu zberthehet ideja mbi zhgënjimin dhe shpresën e kotë mbi figurë e Enver Hoxhës:

-A e sheh?- i them vëllait.

-Po. Por, ashtu ishte kjo kohë. Ne e kishim një shpresë tek ai.

-Shpresë e kotë kishte qenë. Sa për të, Mirko e policët e tij do të na piqnin në hell...

-Por, kemi qenë të mashtruar, pranoje.

Situatat e këtilla dhe zhgënjimet e mëdha në kohë, në vijën narrative bëhen element i tërë strukturës së romanit, përmes të tashmes së komentuar, koha e kaluar shënjohet fund e krye në kohë me pretendim të zhbërjes së identitetit kombëtar. Apo siç thotë në një kritikë të tij Roland Zisi: "Zakonisht lidhet me fakte, gjendje dhe të ndodhura të cilat nxisin qëndrime dhe vlerësime etike-morale midis personazheve. Në një relacion të fortë me këto qëndrime dhe vlerësime konstaton sidomos pozita e deklaruar e rrëfyesit, i cili bëhet vazhdimisht mbrojtës i hapur i vlerave dhe refuzues i palëkundur i pseudovlerave njerëzore". Kështu, gjykimi dhe vlerësimi mbi vlerat e rrejshme, që dikur identifikoheshim në strukturën e shkrimit fiksional dhe në karakterizimin gjatë thurjes së tekstit, shënjon iluzionet mbi shumë gjëra kur analizohen dhe vlerësohen. Vlerësimi dhe analizimi, çdoherë përmes komentimit dhe argumentimit, hapin lexime dhe rilexime në kërkim dhe në gjetjen e ideve, sepse idetë e shtresuara në roman dhe në mikrostrukturën e shtresore, vijnë si rezultat i një zgjedhje mbi temat, tema këto etike, sociale, politike, që

shtjellohen përmes përvijës empirike. Shenjat e rivlerësimit përqendrohen në pjesën dërmuese të romanit, në kuptimin mbrojtës së kodit nacional.

Ideologjia e kohës

Besimi mbi kodin e madh nacional dhe mosluhatshmëria karshi këtij kodi, duke shkuar deri në identifikim të plotë, do të shënjohet edhe në romanin "*Fijet e shpirtit*", ku forma e jetës së sprovuar, përballë zberthimit të situatës dhe fatit, nxjerr natyrën e shumë ngjarjeve ideologjike të kohës dhe të personazheve të vetë kohës. Detajet, rastet dhe situatat e artikuluar në rrëfim, shkojnë drejt përgjithësimit të kodit tematik. Personazhi Besnik Shtylla, njëherësh edhe protagonist i romanit, sfidohet dhe sprovohet me ideologjitë e kohës. Ky fenomen, në vijën e përgjithshme, dëshkohet në sprovimin e personazhit. Struktura tematike ndërtohet mbi intrigën që i bëhet Besnikut, intriga e pushtetit kuptohet, e cila vjen si rezultat e idealit-bashkimit gjithëkombëtar që personazhi ka në jetë. Shfaqja e idealit në kohë bëhet e papranueshme nga i huajpushtuesi. Kjo është esenciale që nga fillimi i romanit. Formimi i personazhit në kodin e përgjithshëm nacional dhe paluhatshmëria karshi tij, në situatën e veprimit, bëhet fat-pësim. Kështu, nëpërmjet meditimit shtrohet çështja e ekzistencës nacionale, që për Besnikun është çdo gjë në jetë. Shkallëzimi dramatik i situatës, do të shënjohet me preokupime të shumta të përditshmërisë së mërzitshme, ku ideologjia kohore jepet nëpërmjet rrafshit të njohjes së tjetërsimit. Shqetësimi i personazhit del në secilën sferë të rrëfimit. Ambienti dhe forma e jetesës në kohë dhe hapësirë mbetën përherë zhgënjyese, në kuptimin e mbindërtimit dhe të shtjellimit së idesë tematike. Boshti themelor ngrihet në pikat të cilat dëshkohen për të dhënë realitetin në një shtresim më të egër, ku egërsia del e tillë në sintezën

gjithëpërfshirëse. Arrestimi i Besnikut dhe mënyra se si arrestohet, dëshmon kohën e ligë. Kjo do të thotë se koha lidhet më botën reale-ekzistuese, ku e pashmangshmja fatale është në çdo hap të jetës. Pësimi dhe ndjenja e personazhit karshi reales janë të promovueshme. Ato e përcjellin tekstin deri në fund. Besimi dhe mosndryshmi në situatë të vështirë, ku luhet jeta dhe vdekja, e forcojnë idenë e tekstit nëpërmjet fortësisë individuale gjatë sprovimit. Figurativisht, kësaj fortësie i përshtatet edhe emri i personazhit Besnik. Vrasja e Besnikut përballë kodit nacional shënjon idenë kulminante të romanit, duke qenë edhe roman me tezë. Kështu, gjesti jetësor përballë kodit nacional i përkufizon të dy romanët, krejtësisht të identifikueshme në shtresën tekstuale, si esencë dhe si kategori ideore, ndërmjet lirisë dhe robërisë së atdheut. Duke qenë kështu, ngrihet një ide themelore në strukturën e përgjithshme të romanëve, ku tragjikja kohore artikulohet e shumëfishohet në rrafshin kombëtar. Përballimi dhe mos tjetërsimi janë shqiptim përhershmërie i fatit të përjetuar. Tragjikja nisët e sosët nga ajo personale në atë kombëtare, sepse personalja kryqëzohet e bëhet njësh me atë nacionale. Prandaj, të gjitha shenjat tekstuale në variacione dhe kategori funksionalizohen nëpërmjet shkrimit dhe botës së ekzistuar-reale. Çdo gjë në romanet e Milazim Krasniqit rrëfëhet e shqiptohet, përshkruhet e komentohet, duke mos lënë anash edhe shkrimin e figurshëm, atëherë kur rrëfimi nuk është i drejtpërdrejtë. Të dy romanet bëhen shënjuese të një kohe, që koha do të identifikohet gjatë përjetimit, për t'u realizuar në gjuhë dhe shkrim. Vetëm një prozator i shkëlqyeshëm, siç është Milazim Krasniqi, mund të sprovohet gjatë rrëfimit të kësaj teme, që njëherësh për lexuesin model shënjon vlerën dhe identifikimin. Vetëm vlera të rikthen në rilexime, prandaj të dy romanet e Milazim Krasniqit i lexoj edhe sot si vlerë e identifikim. ■

Me rastin e 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit

Atëherë kur lindi alfabeti i përbashkët i shqipes

Kongresi i Manastirit ishte një hap i rëndësishëm përpara në rrugën e zgjidhjes përfundimtare të çështjes së alfabetit të shqipes dhe ushtroi një ndikim të fuqishëm në bashkimin politik dhe përparimin e mëtejshëm kulturor të kombit shqiptar



Besim R. CENGU

Kishte ardhur koha e krijimit të një alfabeti të përbashkët

Në fillimin e shekullit të 20-të, idetë dhe aktivitetet e gjithanshme të Rilindjes Kombëtare Shqiptare kishin arritur qëllimet themelore me sukses. Me në krye inteligjencien e asaj kohe, të orientuar dhe të ndikuar fort nga iluminizmi, ishte kryer në mënyrë të kënaqshme përhapja e shkollave dhe e mësimit të gjuhës shqipe, si edhe zhvillimi i kulturës kombëtare në përgjithësi. Ishte vënë bazamenti intelektual, bazat e koncepteve të bashkimit e zhvillimit kombëtar, ishin përpunuar dhe sistemuar idetë për mëvetësi kombëtare etj. Tani, në fillimin e shekullit të ri, u shtruan në rend të ditës nevoja e caktimit të një alfabeti të vetëm, përmes të cilit do të shkruhej gjuha shqipe. Rilindësit, me të drejtë, e shihnin mungesën e një alfabeti të njëjtë të gjuhës shqipe jo vetëm si një problem gjuhësor e kulturor, por edhe si një problem tepër të rëndësishëm politik dhe atdhetar, d.m.th, një faktor ndarje, që pengonte bashkimin kombëtar. Krijimi i një alfabeti të përbashkët të gjuhës shqipe u përgatit gjatë një epoke të tërë të periudhës së Rilindjes, falë veprimtarisë krijuese në lëmin e gjuhësisë dhe të letërsisë të brezave të tërë të iluministëve shqiptarë. Gjithashtu, një ndihmë të çmuar dha shtypi në mënyrë të veçantë "Albania" (Bruksel-Londër, 1897-1909) e Faik Konicës. Alfabeti i Stambollit, i miratuar në vitin 1879, shënoi një hap të rëndësishëm përpara në rrugën e vendosjes së një alfabeti të

njëjtë të gjuhës shqipe, por nuk arriti të përmbushte përfundimisht qëllimet, pasi ai u përhap vetëm në Shqipërinë e Jugut e të Mesme, ndërsa në Shqipërinë e Veriut, konkretisht në Shkodër, vazhonte të përdroreshin tri alfabetet; ai i shoqërisë "Bashkimi" (1899), i "Agimit" (i jezuitëve) dhe alfabeti i shkrimtarëve të vjetër të Veriut, që përdorej më shumë nga klerikët katolikë. Në këtë situatë, vendosja e një alfabeti të njëjtë të gjuhës shqipe do të shkaktonte kundërshti, por nga ana tjetër, duhej patjetër të tejkalohesh fryma dhe interesat lokalë të shoqërive e të grupeve kulturore shqiptare, që vazhdimisht ushqeheshin prej dasive krahinore të trashëguara nga e kaluara.

Problemet që duhej të kapërcëheshin

Edhe pse ishte një problem kulturor, njësimi i alfabetit të gjuhës shqipe paraqitej njëherazi një nga çështjet më të rëndësishme politike të kohës, zgjidhja e të cilit do të varej nga zhvillimi i lëvizjes kombëtare në përgjithësi. Për hir të së vërtetës, thirrja e Kongresit për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe u bë e mundur vetëm në rrethanat e reja, që u krijuan për lëvizjen kulturore-kombëtare pas shpalljes së kushtetutës, në vitin 1908. Thirrjen e Kongresit të Manastirit, e mori përsipër klubi "Bashkimi" i Manastirit, që luante rolin kryesor ndërmjet klubeve shqiptare. Në "Zëdhënien" që u shpërnda me këtë rast, ftoheshin të merrnin pjesë në kongres "gjithë shqiptarët, brenda dhe jashtë Shqipërisë", si edhe "çdo filolog" shqiptar. Kongresi u hap në Manastir, më 14 nëntor 1908 dhe i vijoi punimet deri më 22 nëntor. Në Kongres morën pjesë tridhjetë e dy delegatë me të drejtë vote, që përfaqësonin njëzetë e gjashtë qytete e shoqëri të ndryshme shqiptare brenda dhe jashtë atdheut, si dhe tetëmbëdhjetë delegatë të tjerë

si pjesëmarrës pa të drejtë vote. Kongresi i Manastirit u shndërrua kështu në një kuvend të vërtetë mbarëshqiptar, në të cilin morën pjesë gjithsej 50 delegatë, nga të gjitha anët e Shqipërisë, nga qytetet e vilajeteve të Manastirit, të Kosovës, të Janinës e të Shkodrës, si edhe nga shoqëritë shqiptare të Bukureshtit, të Sofjes, të ShBA-së, të Egjiptit, të Italisë etj.

Kongresi i Manastirit, vlerësohet me të drejtë si kuvendi më i rëndësishëm kombëtar në historinë politike e kulturore të shqiptarëve, në fillim të shekullit të njëzetë. Delegatë të tij ishin intelektualë të shquar të kohës si Gjergj Fishta, Nikollë Kaçori, Ndre Mjeda, Gjergj Qiriazi, Mithat Frashëri, Hilë Mosi, Mati Logoreci, Thoma Avrami, Sotir Peci, Shahin Kolonja, Luigj Gurakuqi, Adam Shkaba; veprimtarë të lëvizjes kombëtare dhe të klubeve shqiptare, si Bajram e Çerçiz Topulli, Mihal Gramenoja, Fehim Zavalani, Dhimitër Mole, Nyzhet Vrioni, Rrok Berisha, Leonidha Naço, Dhimitraq Buda, Akil Eftimi, Shefqet Frashëri, Refik Toptani, Gligor Cilka, Emin bej Shkupi, Hafiz Ibrahim efendiu (nga Shkupi), Ramiz Daci, Xhemal Beu (nga Ohri), Fahri Frashëri (nga Resna) etj. Kryetar i Kongresit u zgjodh Mithat Frashëri, ndërsa nënkryetarë Luigj Gurakuqi e Gjergj Qiriazi.

Diskutimet në Kongres dhe marrëveshjet e rëndësishme historike

Dy ditët e para të Kongresit u organizuan takime frytdhënëse, ku morën pjesë, përveç delegatëve, edhe intelektualë e nxënës të shkollave të Manastirit, si edhe banorë të tjerë të këtij qyteti, rreth 400 veta. Këto mbledhje u shndërruan në manifestime kombëtare, në të cilat u mbajtën fjalime patriotike për nevojën e

bashkimit të të gjithë shqiptarëve, gegë e toskë, muslimanë e të krishterë, si dhe për përparimin e kombit e të kulturës së tij. Në qendër të punimeve të Kongresit, u vu çështja e caktimit të një alfabeti të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Gjatë diskutimeve që u bënë në ditët e para, të gjithë shfaqën mendimin se alfabeti që do të vendosej duhej të kishte si bazë atë latin. Mendimet e konceptet e delegatëve u ndanë më tej, prandaj, në ditën e tretë të punimeve, Kongresi zgjodhi një komision prej 11 vetash, të kryesuar nga Gjergj Fishta, ku bënë pjesë njohësit më të mirë të gjuhës shqipe, përkrahës të alfabetëve të Stambollit, të “Bashkimit”, të “Agimit”, si dhe intelektualë të tjerë të njohur. Komisionit iu dhanë fuqi të plota për të vendosur për këtë çështje. Debatet vazhduan me intensitet derisa Komisioni vendosi që të mos merrej në konsideratë asnjëri nga tri alfabetet e përmendura më sipër, por të krijohej një alfabet i ri mbi bazën e atij latin, duke u dhënë shkronjave latine vlera fonetike në përputhje me nevojat e gjuhës shqipe. Mirëpo, Komisioni ndeshi në vështirësi për caktimin e shkronjave dyshe, që nevojiteshin për ata tinguj të shqipes, që i mungonin latinishtes (për dh, gj, nj, th etj.). Në këto kushte, pas tri ditë diskutimesh (17-19 nëntor), anëtarët e Komisionit, sikurse thuhej në vendimin e Kongresit, “të shtyrë edhe nga disa shkaqe të përjashtme”, nuk arritën të caktonin një alfabet të vetëm për gjuhën shqipe, prandaj vendosën “të kthehen prapa”, duke pranuar alfabetin e Stambollit “e bashkë me të edhe një abece thjesht latine, që të përdorehin e të mësoheshin bashkërisht në mes të shqiptarëve”. Vendimi, që vetë Kongresi e quajti kthim prapa, u argumentua nga Komisioni me “disa shkaqe të përjashtme” dhe pikërisht me nevojën për të shtypur me alfabetin thjesht latin libra jashtë Shqipërisë dhe për korrespondencat me jashtë. Në të vërtetë, me shkaqe të jashtme nuk kuptoheshin vetëm ato thjesht teknike, por edhe trysnia e ushtruar mbi Komisionin nga qarqet e shoqëritë e ndryshme shqiptare, që ishin për alfabetin e Stambollit (në Shqipërinë e Jugut) dhe atë të “Bashkimit” në Gegëri e sidomos në Shkodër. Vendimi për të përdorur bashkërisht dy alfabetet, u mor për të mos shkakuar përçarje në radhët e del-

egatëve dhe të shqiptarëve në përgjithësi. Në të njëjtën kohë ai u quajt si një zgjidhje e përkohshme për të kaluar në të ardhmen në përdorimin e një alfabeti të vetëm. Edhe pse nuk caktoi një alfabet të vetëm, vendimi i Kongresit të Manastirit ishte një hap i rëndësishëm përpara në rrugën e zgjidhjes përfundimtare të çështjes së alfabetit të shqipes dhe ushtroi një ndikim të fuqishëm në bashkimin politik dhe përparimin e mëtejshëm kulturor të kombit shqiptar. Me këtë vendim iu dha fund kaosit që mbretëronte deri atëherë në çështjen e shkrimit të shqipes. Në vend të alfabetëve të shumta që ishin përhapur në Shqipëri e në kolonitë e mërgimit, tani do të përdorehin vetëm dy, edhe këta bashkërisht.

Kongresi i Manastirit - edhe manifestim politik

Çështja e njësitimit të alfabetit zuri vendin kryesor në punimet e Kongresit të Manastirit. Vetë Kongresi nuk ishte një konferencë thjesht gjuhësore, por edhe një manifestim politik. U organizuan edhe mbledhje të fshehta kushtuar çështjeve politike të ditës, lufta për të drejtat kombëtare të popullit shqiptar, për zhvillimin kulturor dhe ekonomik të vendit, si edhe marrëdhëniet me shtetet evropiane. Përfundimet e këtyre diskutimeve dhe vendimet që u morën në këto mbledhje, u përfshinë në programin kombëtar prej 18 pikash që iu dha deputetit të Korçës, Shahin Kolonjës, për ta paraqitur në parlament në emër të shqiptarëve. Ky program është një nga dokumentet më të rëndësishme të Kongresit të Manastirit, në të cilin u pasqyruan aspiratat e shqiptarëve për autonominë territoriale-administrative të Shqipërisë. Në program vendin kryesor e zinin kërkesat politike për “njohjen zyrtare të kombësisë shqiptare dhe të gjuhës shqipe”. Pjesë përbërëse e kërkesës për njohjen e kombësisë shqiptare dhe e të drejtave të saj ishte edhe themelimi i shkollës së pavarur shqipe, që do të arrihej duke i kthyer të gjitha shkollat shtetërore turke në Shqipëri, në shkolla kombëtare dhe duke vendosur gjuhën amtare shqipe “si gjuhë mësimi në të gjitha këto shkolla shtetërore”, ndërsa turqishtja do të mësohej si lëndë e veçantë, duke filluar nga viti katërt i shkollës fillore. Të

ndërvarura ngushtë me këtë ishin edhe masat që parashikohej të merreshin për kthimin e shkollave në gjuhën greke, që funksiononin për shqiptarët, në shkolla kombëtare, me gjuhën shqipe si gjuhë mësimi, duke i hequr ato nga administrimi i klerit dhe duke i shpallur shkolla shtetërore. Një nga kërkesat më të rëndësishme në fushën e arsimit ishte ajo për themelimin e një universiteti shqiptar, që kishte qenë aspiratë e hershme e rilindësve. Për përgatitjen e profesorëve për këtë universitet do të dërgoheshin çdo vit, me bursa të shtetit, të rinj që do të mësonin në shkollat e larta të Evropës dhe të ShBA-së. Po kështu, kërkohesh të themelohej një muze arkeologjik kombëtar në një nga qytetet e Shqipërisë, i cili do të ishte i pajisur me eksponate ku vërtetoheshin lashtësia e vendit tonë. Programi i Kongresit përmbante, gjithashtu, një varg masash, që kishin për qëllim zhvillimin ekonomik të vendit, për të cilin ishte interesuar borgjezia shqiptare. Të tilla ishin masat për hapjen dhe shfrytëzimin e minierave, për ndërtimin e hekurudhave nga sipërmarrës shqiptarë, për ngritjen e ekonomive të mëdha bujqësore në Myzeqe etj. Në pjesën ekonomike përfshihej edhe kërkesa për kufizimin e depërtimit të kapitalit të huaj në ekonominë shqiptare, që kishte për qëllim të ndalonte ekspansionin ekonomik të shteteve të huaja dhe në mënyrë të veçantë t'i jepte mundësi borgjezisë shqiptare e kapitalit vendas të shtetin në dorë tregun dhe ekonominë e vendit. Ky dokument i rëndësishëm, i miratuar në Kongresin e Manastirit, megjithëse nuk përmbante kërkesa të domosdoshme për organizimin e një shteti autonom, si veçimi i territoreve shqiptare dhe forma e qeverisjes së tyre, pati rëndësi të veçantë. Miratimi i tij dëshmonte gjithashtu se Lëvizja Kombëtare Shqiptare, edhe pas shpalljes së kushtetutës, e kishte ruajtur karakterin e saj politik e të pavarur dhe synonte autonominë e vendit. Kjo ngjarje e madhe kombëtare, hodhi një hap të rëndësishëm në ngritjen e shkallës së organizimit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Kongresi i Manastirit dhe vendimet e tij përbëjnë një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e re të popullit shqiptar. ■

Reagim rreth shkrimit: "Kontributi i klerit katolik në Kongresin e Manastirit", të prof. dr. Jahja Drançolli

Rreth "Kongresit të Manastirit" profesori Jahja - asgjë nuk tha...

Shkrimet e historianit me prejardhje nga Peja, prof. dr. Jahja Drançolli, gjithmonë i lexoj me vëmendje, me kënaqësi, por shkrimi i fundit i tij më zhgënjeu në tërësi... Pse? Sepse në dy faqet e gazetës më të lexuar në Kosovë "Koha Ditore", Koha për kulturë, ditën e shtunë, 8 nëntor 2008, faqe: 38-39, u botua shkrimi me titull: "Kontributi i klerit katolik në Kongresin e Manastirit".

Në këtë shkrim për Kongresin e Manastirit, me rastin e 100 vjetorit (1908 – 2008) profesori Jahja – asgjë nuk tha...!

Për hir të së vërtetës, në dy faqe të gazetës, për Kongresin e Manastirit ishte vetëm një fjali... Pra, për një ngjarje me kaq rëndësi, siç është Kongresi i Manastirit, profesori i nderuar, Jahja Drançolli, e përfundon shkrimin e tij vetëm me një fjali... Me një fjali, e cila sjell shqetësime – sepse është me gabime... Me gabime janë shënuar edhe disa emra në fotografi, që ka mundësi të mos jetë gabim i tij...!?

Por, gabimi kryesor i tij është se profesori hedh dritë vetëm në një anë dhe njëra anë të vërtetën nuk e përmban... Të vërtetën mund ta krahasosh me diamantin, siç thoshte Gëte, diamanti nuk hedh dritë në një anë, por në shumë anë.

E vërteta rreth "Kongresit të Manastirit"

Është e vërtetë se kleri katolik ka dhënë kontribut të madh, por ky kontribut, i cili nuk mohohet kurrësi, është një pjesë e së vërtetës...

E vërteta e plotësuar është kur nuk mohohet, kur nuk injorohet, por edhe kur shënohet edhe kontributi i shqiptarëve ortodoksë, protestantë dhe në veçanti i shqiptarëve muslimanë....

Atdhetarët shqiptarë, prej të gjitha besimeve, patën mes vete fërkime, kundërshtime, por edhe bashkëpunime rreth alfabetit, sepse, pothuajse çdo shqiptar kishte një alfabet të vetin... Kur e kuptuan se janë të rrezikuar, atëherë filluan për të bashkëpunuar...

Fillimi i një bashkëpunimi

Gjithçka ka filluar në "Stambollin e mallkuar"... Këtu u themelua "Shoqëria e të shtypurit shkronja shqip" (1879). "Komiteti i Stambollit me 6 mars 1879 miratoi Alfabetin (Abeceja) e hartuar nga vëllezërit Frashëri, nën kryesinë e Samiut, të cilin e përkrahën

edhe Hoxha Tahsini, Koto Hoxhi e atdhetarë të tjerë...

Më vonë në Shkodër, nga klerikë katolik, françeskanë, u themelua Shoqëria "Bashkimi" (1899, kurse me 1901 u themelua Shoqëria "Agimi" nga klerikë katolik, jezuitë, që të dy shoqëritë kishin hartuar nga një alfabet të veçantë...

Nga këto tri alfabetet kryesore, me baza latine, botoheshin gazeta, broshura, libra të ndryshëm. Por, Abeceja apo Alfabeti i Stambollit, themeluar nga vëllezërit Frashëri, ishte më i përhapuri ndër shqiptarë, si në mërgim, njashtu edhe në trojet shqiptare... Konsujt e Austrisë, në raportet e tyre dërguar Vjenës, lajmëronin se në vitin 1905, Alfabeti i Stambollit përdoret në të gjithë Shqipërinë e Jugut, duke përfshirë muslimanë dhe ortodoksë, deri në Dibër e Prizren...

Kongresi i Manastirit"

Me 27 gusht 1908, me iniciativën e Klubit Shqiptar "Bashkimi" në Manastir, i cili kryesohej nga Fehmi Bej Zavalani, por me kërkesën e Mid'had Frashërit, u vendos të thirrej një Kongres për Alfabetin e gjuhës shqipe, i cili do të zhvillonte punimet me 14 nëntor 1908.

Me 14 nëntor 2008, ishte ditë me borë, në Manastir filloi punimet Kongresi i Manastirit apo Kongresi i Alfabetit... Punimet e këtij kongresi zgjatën tetë ditë, u ndoqën nga 50 përfaqësues të 26 qyteteve, klubeve dhe shoqatave, prej të cilëve vetëm 32 përfaqësues kishin të drejtë vote.

Kryetar i Kongresit të Manastirit u zgjodh Mid'had Frashëri, edhe pse nuk ishte i pranishëm aty, sepse ende nuk kishte arritur në Manastir, kur filluan punimet me 14 nëntor 1908. Pse u zgjodh Mid'had Frashëri?

U zgjodh jo pse ishte biri i Abdyl Frashërit, nip i Naimit, Samiut, Mehmetit, Tosumit, Kasemit, por pse ishte një emër i nderuar, një atdhetar, publicist, shkrimtar i dëshmuar, mbi të gjitha, sepse ishte ideator i këtij Kongresi. Atëherë ky atdhetar ishte 28 vjeçar dhe përfaqësonte Alfabetin e Stambollit... Në dy ditët e para të Kongresit të Manastirit, që i priu nënkryetari, Gjergj Qiriazi, protestant, deri sa erdhi kryetari, Mid'had Frashëri, u diskutua se cili prej tre alfabetëve duhet të përcaktohet për gjuhën shqipe: Alfabeti i Stambollit, më i përhapuri, apo alfabetet e shoqërive "Agimi" që e përfaqësonte Dom

Ndre Mjeda, apo të shoqërisë "Bashkimi" që e përfaqësonte At Gjergj Fishta, të dy shoqëritë nga Shkodra, të dy klerikë katolik, por njeri i përkiste urdhrin (rendit) jezuit, tjetri rendit apo urdhrin françeskan, por që kishin fërkime e kundërshtime...

Në ditën e tretë të punimeve, meqë fërkimet, kundërshtimet arritën kulmin, u zgjodh Komisioni i Alfabetit prej 11 vetash, të cilin e kryesoi At Gjergj Fishta, i cili e përfaqësonte Alfabetin e "Bashkimit"....

"Komisioni i Alfabetit"

"Kongresi i Manastirit" i dha fuqi të plotë "Komisionit të Alfabetit" për të vendosur për çështjen e alfabetit të gjuhës shqipe... Anëtarët e Komisionit të Alfabetit, pas tri ditë diskutimesh, sikurse thuhej në vendimin e Kongresit të Manastirit: "Të shtyrë edhe nga disa shkaqe të përjashtme e pranuem "Alfabetin e Stambollit, e bashkë edhe një abece thjeshtë latine, që të mësoheshin bashkarisht në mes të shqiptarëve..."

Kush ishin anëtarët e Komisionit të Alfabetit?

At Gjergj Fishta (Kryetar); Mid'had Frashëri, jo Mehdi Frashëri; Luigj Gurakuqi; Gjergj Qiriazi, protestant; Dom Ndre Mjeda; Grigor Cilka, protestant; Taqi Buda; Shahin Kolonja; Sotir Pecil; Bajo Topulli; Nysret Vrioni, jo Nuzihet Vrioni; Fineas Kenedi, protestante, vëzhguese amerikane.

Pra, ky ishte Komisioni i Alfabetit prej 11 anëtarësh dhe një vëzhguese amerikane. Në bazë të emrave dallohen anëtarët muslimanë, ortodoksë dhe katolikë, i shënuam vetëm anëtarët e besimit protestantë, sepse vazhdimisht injorohet besimi i tyre...

A ka rëndësi kjo? A ka rëndësi besimi? Po. Pse? Sepse, besimi ka qenë tema kryesore gjatë gjithë historisë botërore...

Kurse, prof. dr. Jahja Drançolli me një fjali i injoron në tërësi...!

Është një psalm në Bibël, ku shkruan: "Urretja sjell grindjen, kurse dashuria i kapërcen të gjitha".

Shqiptarët e "Kongresit të Manastirit", para 100 vjetësh, i kapërcyen të gjitha me dashuri... Dashuria dhe besimi janë themeli ku lartësohet njeriu, njerëzimi...

Mexhid YVEJSI, Gjakovë

(Autori është studiues i religjioneve)

Diçka matanë të bukurës

Blerim HALILI

Adhurimi, dritë e qenies

Triumfues në betejën e fundme
Shpartallon errësirën e botës së stërlodhur
Me një dritë që vjen nga vetja e saj
Tatëpjetës së poshtër të jep fuqi rrufeje
Dhe shpon pa mëshirë mundimin që del para
Trondit dembelinë, shporr nga faqja e dheut
Nga zemra fatlume që di çështë mikpritja
Që adhurimit në jetë
Di t'i bëjë konak
Shtrin dorën e pajtimit për ty
Kur je hidhëruar edhe me veten e molisur
Dorë që i duket veç puna e saj e madhe
Faqebardhë në jetën plot të zeza
Me shije dhe aromë, në etje dhe uri
Me heshtje dhe me fjalë që i ligjërojnë udhëtarit
Ngjall edhe stinët e vdekura të botës
U jep hijeshi netëve të zymta
Ngjall ditët e vdekura të zemrës
Rindez dritën e shuar të mendjes
Kur veshët pa barrierë,
t'i mbyll zhurma e bezdisshme e botës
Dhe dy duart e tua, shtrëngojnë edhe kokën
Ndal.
Kollitu një herë si burrë
Krenari për mikun e jetës
Jepi lirinë vetes
Qetësinë zemrës
Dhe kur heshtja prore mbyllet e stërmbyllet
Jepi shenjë zemrës, i çoi asaj një fjalë
Le të shoqërojë melodia e valëve të saj
Le të thahen në fytyrë,
lumenjtë që vijnë prej saj
O le te derdhen më mirë
Në oqeanin e pendimit
Tretu mëkat si tretet qiriu
Nga flaka e pashuar e adhurimit
Digju ligësi në zjarrin e zemrës
Si druri i thatë në zjarrin përvëlues
-Vetëm Ty të adhurojmë-
Jehonë e nderit të amshuar

Bota e idesë dhe ideja e botës

Zemra prore e ndriçuar
Si një vëlla
thërret mendjen e hutuar
S'ë lë në hata.
Mos kërko kot kuptim
Në terrin tënd të tmerruar
Mjegullën me mëdyshje

Mashtrim, mbështjellë me mohim
Tërbim.
Shih shakanë e shkretë
Çohet qanë i qetë
S'ia mësynë matanë
Se heton hatanë
Dritë e Zotit, zërin e zemrës
E mbarësoi me mëshirë
Një ujdi si ujë n'Saharë
Ç'na ka qitur një çlirim
Qofsh i qetë, ç'ë do që qan
Çast o ç'nderim
Rrofsh o fe, fuqi e fatit
Fe e Zotit, zgjidh zinxhirët
Triumfo, trishtoje tërë trillimin
Nga lart lëshon jehonë lavdërimi
Kalon qiejt e qëndisur
Lamtumirën ligësisë
Vetja vajti, vaji e pat
Mjaftoi zëri i ezanit t'mbrëmjes
Të fshijë lotët në fytyrën e zbehur
Nga bota e idesë dhe ideja e botës
Që rrezja e qiellit i ra përmbi
I dha shkëlqimin e pasosur
Horizonti i saj mbresëlënës
Diçka matanë të bukurës
Zgjimi i saj po flet
Vula e kohëve zemrës
ia ndali një tërmet.

Një dhuratë që nuk blihet

Sihariq për vlerë madhore
Që s'qet hapin si i mitur
Shpirt'i pastër, mendje-ndritur
Lumi i paqes po rrjedh prore.
Një dhuratë që nuk blihet
Një e dukshme që kudo s'shihet
Ç'po mahnit ky yll i zjarrtë
pasqyrë e mirësisë.
Shtrij ngjyrën e paqes
ngjyrën e njerëzisë.

Po pasurinë si morali
Më thuaj kush ta fali?
Fjala jote mëshirë
Jep jetë në shkretëtirë.
Po si mund të jesh si bleta
Edhe në kohët e shkreta?
Po çëshë kjo që po shndrit
Mu si hëna n'mes të natës?
Mos je dhuruar me dritë
Nga nur'i edukatës?

Klipomania

Producentët e vetëquajtur të muzikës, dëshirojnë që kënga të joshë spektatorin. Nëse jo me muzikë, të paktën sa më shumë femra që preken, fërkohe, picërrojnë sytë, rrudhin buzët, hidhen, tundin prapanicën, zbulojnë zona erogjene, dridhen, rrotullojnë ç'të munden... Momenti që shqiptohet fjala videoklip të bën të përfytyrosh ca femra të bukura dhe, për fat të keq, të zhveshura

Drin GASHI

Mjafton të nxjerrësh tri femra të zhveshura para kamerës dhe klipi u bë. Kjo është përshtypja karshi klipeve që kanë vërshuar tregun muzikor të vendit. Pak syresh kanë mbetur në kujtesën e publikut për vlerat e profesionalizmin.

Nëse një klip ka ngacmuar shijet e publikut në çastin e shfaqur, qoftë për performancat e vajzave gjysmë lakuriqe, qoftë për dukjen e këngëtareve, gjithçka ka ngecur në po ato minuta. Jehona e këngës nuk ka mbijetuar më gjatë.

Klipe playboy

Momenti që shqiptohet fjala videoklip të bën të përfytyrosh ca femra të bukura dhe për fat të keq të zhveshura. Më tmerron termi videoklip, pa një fabul të mirëfilltë brenda. Edhe në botë ndodh një gjë e tillë, porse ka një limit. Ndërsa te ne funksionon ndryshe. Mjafton të nxjerrësh tri femra të zhveshura dhe klipi u bë. Ky fenomen të lë përshtypjen e një pornografie. Edhe jashtë ka klipe të tilla, por kanë një orar të caktuar pas mesnate. Duhet të ketë një shënim 'ndalohet për filan moshë', siç ndodh në gjithë botën.

Në klipet tona, nëse mund t'i quaj kështu, ka shumë mangësi dhe çështje më e keqja ato po i afrohen pornograf-

isë. Videoklipet muzikore tashmë janë bërë modë në këngët tona. Me vlerë e pa vlerë, me shije e pa shije, me vend e pa vend, videoklipet i kemi të pranishme, sot e gjithë ditën. Fillimi i këtyre klipeve ndërlidhet me ngjarjet e para të luftës, ndaj mendoj se dikur brenda tyre kishte nuanca të logjikës patetike, skenat e gjakut, trishtimit, konform teksteve muzikore. Tashmë kjo formë i takon të kaluarës, sepse në 'opcion' është një formë tjetër e videoklipes muzikore. Thjesht një logjikë seksi.

Këngëtarët e estradës muzikore të tipit të "turbo-folkut", një numër jo i vogël, përqendrimin e tyre e mbështesin në videoklipes ku mbizotëron skena më e lirë, madje në raste të shpeshta ajo arrin përmasa deri në pornografi.

Lëvizjet e shfrenuara

Sfera intelektuale po përballet me probleme të ndryshme, ku edhe kultura është e vërshuar nga një mori faktorësh të cilët po ia hedhin perden e zezë asaj. Në këtë kontekst, edhe ngjarjet muzikore të përcjella me videoklipes janë shumë të pranishme në mjetet vizuale, pa marrë parasysh se cilit nivel i takojnë këto klipes dhe a duhet apo nuk duhet të transmetohen. Kategorizimi i tyre do të duhej të bëhej sipas një niveli të ngritur artistik e estetik, ku do të filtroheshin e të pas-troheshin të gjitha ato njolla të zeza që nuk përmbushin madje as edhe kërkesat

minimale estetike. Këtë hap do të duhej ta bënin përgjegjësit për emetimin e klipesve, meqë ata janë bartësit e drejtpërdrejtë të transmetimit të jovlerave. Por, materializmi ka shkelur kufijtë e çdo gjëje, madje edhe atëherë kur kemi të bëjmë me art të mirëfilltë, përparësi u jepet situatave që çojnë drejt degjenerimit të brezit të ri, e me këtë po humbet beteja për luftimin e fenomeneve negative të shoqërisë sonë.

Këto klipes janë të zbrazëta dhe të mangëta, të krijuara për përfitime personale dhe pa kurrfarë niveli artistik. Kur mungon profesionalizmi, medemos mungon edhe ndjenja për të krijuar gjëra të bukura, andaj edhe kjo situatë muzikore çfarë e kemi i përgjigjet jetës joprofesionale artistike. Pjesa dërmuese e klipesve jo vetëm që nuk i përgjigjen shtjellimeve të temave të caktuara muzikore (në rastin konkret temën për të cilën bëhet fjalë në tekstin e kënduar), por vetëm sa e ulin përjetimin e këngës, përmes lëvizjeve të shfrenuara emocionale të cirkusantëve.

Në këto klipes ka vetëm shthurje emocionale, moskoordinim mes regjisë dhe muzikës, skenës së vendosur dhe mesazhit të këngës, lëvizjes dhe koreografisë...

Videoklipet muzikore duhet të jenë pjesë përbërëse e realizimeve të vërteta muzikore - estetike. Ato janë forma skenike të realizuara përmes mjeteve të avancuara bashkëkohore, ku përmes tyre vjen deri tek lidhshmëria dhe realizimi i drejtë mes fjalëve të kënduara dhe lëvizjeve koreografike. ■





Sfida e të mbeturit familje normale

“Së pari duhet të lësh duhanin dhe së dyti duhet t’i rezervosh gjithmonë një hapësirë familjes”. Këto janë dy kushtet që Michelle Obama i vuri bashkëshortit kur ai kandidoi për Shtëpinë e Bardhë. “Vogëlush” - vazhdoi ajo - “ne mund të të mbështesim deri në 80%”.

Elton XHANARI

“Së pari duhet të lësh duhanin dhe së dyti duhet t’i rezervosh gjithmonë një hapësirë familjes”. Këto janë dy kushtet që Michelle Obama i vuri bashkëshortit kur ai kandidoi për Shtëpinë e Bardhë. “Vogëlush” - vazhdoi ajo - “ne mund të të mbështesim deri në 80%”.

Fajta tjetër revolucionare e presidentit të 44-t të Amerikës është pikërisht familja e tij normale; ai aspekt i jetës private që as kolltuku më prestigjioz në botë nuk e ka cenuar. Rrallë është dëgjuar një zonjë e parë që emërton burrin e vet “vogëlush”, por është një provë e mëtejshme që ndryshimi kalon medoemos nga pohimi i vetvetes dhe mbrojtja xheloze e boshtit familjar.

Michelle, (e quajtur ndryshe nga Barack, “The Boss”), avokate e suksesshme me master në Harvard, deri dje, kishte një rrogë më të lartë se Barack-u; ajo është mama e rreptë dhe grua që kështjellën e tanishme i është dashur ta ndërtojë nga themelet.

Çifti Obama është prind i dy vajzave

(e vogla Sasha, 7 vjeçe, është banuesja më e vogël e Shtëpisë së Bardhë nga koha e J. F. Kennedy Jr., në 1963-shin). Jeta e tyre është gjithmonë nën vëzhgimin e sertë të prindërve. Zgjimi bëhet herët në mëngjes për të rregulluar krevatin, për t’u veshur dhe për të sistemuar dhomën. Më vonë, futen te krevati i prindërve, për pak minuta përkëdhelje, para se të fillojë dita: është riti që mama Michelle, ka premtuar të mos ta ndërpresë kur të shkojnë te banesa e re.

Riti tjetër që nuk duhet të ndërpritet është ai i darkës: pas ngrënies dhe gjysmë ore kukullash, në tetë e gjysmë, mami i shoqëron në krevat dhe, pak më vonë, babi shkon me ndonjë libër në dorë. Para pak javësh Barack-u ka mbaruar së u lexuari të gjitha aventurat e Harry Potterit dhe tani nuk dihet akoma se cili është personazhi tjetër, protagonist i mbrëmjeve.

Mesazhi numër një që Barack dhe Michelle Obama synojnë t’u përcjellin vajzave përmbledhet në një frazë: “Këmbë në tokë”. Dhe nuk mund të ishte ndryshe, duke pasur parasysh që të dy kanë njohur varfërinë dhe e dinë fare

mirë çfarë ka tej vitrinave që reflektojnë luksin. Natasha dhe Malia duhet të shikojnë pak televizor dhe “paga” javore nuk mund të jetë më e lartë se 1 dollarë (g gjithmonë e dhënë nga babi).

Problemi më urgjent është ruajtja e një modeli jetese të mesëm, i bazuar në vlera të shëndosha dhe, për këtë, Michelle po kërkon t’i mbushë mendjen mamasë së vet, Marianës, të shkojë të jetojë me ta në Uashington. I vetmi shpërblim për vajzat do jetë një këlysh që do zgjedhin në një stelë qeni, midis kafshëve të braktitura, si falënderim për durimin e tyre në këto muaj fushate, kur Barack-u ishte për 98% të kohës jashtë (llogari të “The Boss”-it).

Për katër vitet e ardhshme adresa e “1600 Pennsylvania avenue” (Shtëpia e Bardhë), do të banohet nga një çift me ngjyrë, dy goca, një gjyshe dhe një këlysh. Jo më nga një dinasti naftë (dera Bush), por asgjë më pak dhe asgjë më shumë nga një familje normale amerikane, ku të gjithë mund të gjejnë pak nga vetja.

Ndoshta edhe kjo është pjesë e revolucionit. ■

'Shkurtëza e faraonit'

Vezët e shkurtëzave japoneze janë "ilaçi i ardhmërisë". Mundësitë shëruese të këtyre vezëve janë vërtetuar edhe nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.



Bujar SEJDIU

Shkurtëzat (apo thëllëzat) japoneze, të njohura edhe si "shkurtëza e faraonëve" për shkak të përdorimit të gjerë nga egjiptianët e asaj kohe, janë një lloj shpendi i vogël, që prodhojnë në mënyrë tërësisht natyrale vezë me përmbajtje shumë ushqyese.

Vezët e këtyre shkurtëzave janë shumë të pasura me vitamina dhe minerale të ndryshme. Këto vezë përmbajnë një spektër të gjerë vitaminash, si: A1, B1, B2, B6, B12, po ashtu dhe një mori mineralesh si: kalcium, fosfor, hekur, pastaj lizinë, cistinë, metioninë dhe thartinë asparagonike, ndërkohë që nuk përmbajnë fare kolesterol.

Efekt i jashtëzakonshëm në ngritjen e imunitetit te njeriu

Ushqimi të cilin njeriu e konsumon është i lidhur ngushtë me jetën e tij në shumë dimensione. Tanimë shkenca dhe mjekësia bashkëkohore e ka vërtetuar që vitaminat dhe mineralet, si përbërës të ushqimit, përveç rolit ushqyes, kanë një rol shumë të rëndësishëm edhe në mjekimin dhe parandalimin e shumë sëmundjeve.

Bazuar në përbërjen e vezëve të këtyre shkurtëzave është konstatuar se me përdorimin e tyre, gjithnjë në konsultim me mjekun, mund të shërohen dhe të parandalohen në mënyrë të suksesshme shumë sëmundje pasi që kanë efekt të jashtëzakonshëm në ngritjen e imunitetit te njeriu. Vezët e shkurtëzave japoneze janë "ilaçi i ardhmërisë". Mundësitë shëruese të këtyre vezëve janë vërtetuar edhe nga OBSH-ja (Organizata Botërore e Shëndetësisë).

Ndër sëmundjet që mund të mjekohen me përdorimin e këtyre vezëve janë: tumori në tru, tumori në zorrë, astma e rëndë, diabeti, infarkti, tendosja

nervore, tensioni i lartë, anemia, migrena, astma bronkiale, sëmundjet digestive, gastritisi, kolesteroli, arterioskleroza,

thati në lukth, etj. Po ashtu, përdorimi i këtyre vezëve ndihmon edhe në përmirësimin e memories, regjenerimin e



teli nga 5 copë për ditë për personat e rritur.

Duhet të përzihen mirë me ndonjë lëng pemësh sipas dëshirës, dhe duhet të pihen çdo mëngjes në lukth të zbrazët,

30-60 minuta para çfarëdo lloj ushqimi, qoftë bukë, kafe apo ndonjë gjë tjetër ushqimore.



Është me rëndësi vitale që vezët të jenë të freskëta. Duhet të jenë të ruajtura me kujdes në temperaturë prej 1deri 6 °C dhe mos të jenë më të vjetra se 60 ditë. Nëse nuk plotësohen këto dy kushte themelore atëherë veza nuk do të ketë efekt shërues.

Personat që kanë nivel të rritur të sheqerit në gjak nuk guxojnë t'i përdorin vezët me lëngje të ëmbla. Gjithashtu, personat që kanë probleme me tëmthin, pra që e kanë idhëzën e sëmurë apo me gurë, si dhe fëmijët nën

organizmit, si dhe forcimin e aftësisë fizike të organizmit.

Vezët duhet të përdoren të freskëta
Vezët duhet përdorur në formë kok-

moshën 10 vjeçare, duhet të përdorin një sasi më të vogël se 5 copa vezë në ditë. Për sasinë e duhur të përdorimit duhet konsultuar me mjekun. ■

Mrekullia natyrore

Gjatë një hulumtimi shkencor te shkurtëza japoneze është vërtetuar një fuqi e madhe natyrore rezistuese e kësaj krijese.

Disa shkencëtarë japonezë kanë marrë dy mostra të ndryshme: një pulë të zakonshme dhe një shkurtëz japoneze. Në trupin e të dyjave kanë injektuar, në të njëjtën kohë, sasi të barabarta të radioaktivitetit. Gjatë vëzhgimit disa ditë, është vërejtur se pula e zakonshme ka lëshuar vezë me radioaktivitet për 6 ditë me radhë, ndërsa ditën e shtatë ka ngordhur duke mos mundur t'i rezistojë radioaktivitetit në trupin e saj. Në të njëjtën kohë kanë vëzhguar edhe gjendjen e shkurtëzës. Fillimisht, vezët e lëshuara nga shkurtëza japoneze kanë përmbajtur radioaktivitet, por shkencëtarët janë habitur fare se, përafërsisht pas shtatë ditëve, shkurtëza japoneze përveçse që ka vazhduar të jetojë, ka lëshuar vezë pa radioaktivitet, e po ashtu radioaktiviteti në trupin e saj është larguar.

Gurët në veshka

Ende nuk dihet me saktësi se pse formohen gurët, megjithatë mund të rreshtohen një sërë faktorësh që ndihmojnë formimin e tyre. Ka një lidhje trashëgimie që varion statistikisht në 80 % të rasteve

**Iliriana ALLOQI &
Bernard TAHIRBEGOLLI**

Guri në veshka është një masë e fortë, që zhvillohet kur përbërësit e kalciumit ose kimikate të tjera në urinë formojnë kristale të vogla e që bashkohen në mes vete. Këto kristale, gjegjësisht formacione, rriten dhe formojnë gurë. Madhësia e gurëve luhetet nga një kokërr gruri deri në një top golfi.

Trakti urinar anatomikisht përbëhet nga veshkat, ureterët, qesja e urinës dhe uretra.

Veshkat përveçse zbrazin "mbeturinat" dhe lëngjet nga trupi, luajnë edhe shumë role të rëndësishme. Ato rregullojnë sasinë e ujit në trup dhe përbërësve të tjerë kimik në gjak si natriumi, kaliumi, fosfori dhe kalciumi. Po ashtu largojnë medikamentet dhe helmet nga trupi, çlirojnë hormonet në gjak për të ndihmuar trupin, rregullojnë presionin e gjakut, krijojnë qelizat e kuqe të gjakut, nxisin kockat e forta e të tjera.

Ureterët, janë dy tuba të hollë që lidhin veshkat me qesen e ujit. Zgjatjen si dy tuba elastike përgjatë barkut deri sa hyjnë në qesen e ujit.

Qesja e urinës është elastike, mbushet me rreth 500 ml urinë, dhe mbas këtij çasti përgjithësisht përcjell dëshirën për të urinuar.

Uretra është kanali i jashtëqitjes së urinës. Gjatësia varion për të dy gjinitë.

Ende nuk dihet me saktësi se pse formohen gurët, megjithatë mund të rreshtohen një sërë faktorësh që ndihmojnë formimin e tyre. Ka një lidhje trashëgimie që varion statistikisht në 80 % të rasteve.

Nga pesë burra, katër kanë gurë në veshka

Disa nga faktorët që kontribuojnë në formimin e gurëve te njerëzit



Pirja e rregullt e lëngut të molës nuk lejon formimin e gurëve në veshka

prekshëm nga kjo sëmundje janë: marrja e paktë e lëngjeve, infeksionet kronike në rrugët urinare, keqpërdorimi i disa mjekimeve, bllokimi i rrugëve urinare me aktivitet të kufizuar për javë, si dhe disa sëmundje të caktuara gjenetike dhe metabolike.

Disa njerëz mund të mos kenë simptoma të kuptueshme për gurë në veshka si dhimbje të forta, pengesa në urinim etj.

Gurët në veshka janë më të zakonshëm te burrat, ku katër në pesë burra kanë gurë në veshka.

Dhembja është shenja karak-





teristike e gurëve në veshka, ajo mund të zgjasë nga disa minuta në disa orë dhe herë-herë ka periudha qetësie. Por është dramatike dhe është një nga dhimbjet me te forta që shoqërojnë sëmundjet. Dhimbja është e lokalizuar në bel, shpinë dhe përhapet në bark dhe fundbark, nganjëherë shkon edhe më poshtë në organet gjenitale. Simptomat të tjera janë edhe vjellja, temperatura, ethe dhe dobësi, urina e turbullt apo me erë të keqe, bllokim i urinimit.

Një nga shkaktarët e dhembjeve në veshka është edhe shtatzënia. Nga studimet e bëra rreth 60-65 % e grave shtatzëna më e dukshme është dhembja e veshkës së djathtë, që fillon nga java e 24-t deri në javën e 28-të të shtatzënisë.

Nga studimet e bëra rreth 60-65 % e grave shtatzëna më e dukshme është dhembja e veshkës së djathtë, që fillon nga java e 24-t deri në javën e 28-të të shtatzënisë

Masat që mund të parandalojnë formimin e gurëve në veshka





















Shumë eksperimente sugjerojnë se marrja e lëngjeve në sasi të madhe mund ta ulë rrezikun e gurëve. Mirëpo edhe sapo të zbulohet shkakut i formimit të gurit, mund të përdoren trajtime të ndryshme apo ndryshime në dietë për të parandaluar gurët e rinj. Rekomandohet konsumimi i ushqimeve të lehta, supave me zarzavate, lëngjeve të frutave, çajet e ndryshme, etj, por njëkohësisht duhet që i sëmuri të lëvizë. Abuzimi me alkoolin ndikon

Marrja e ujit dhe e lëngjeve është një domosdoshmëri edhe më e madhe për ata që vuajnë nga gurët e veshkave

në dhimbjet e veshkave Alkooli ndikon negativisht te njerëzit që vuajnë nga veshkat për vetë faktin se ai është toksik për parenkimën e veshkës dhe qelizave të veshkës, duke ngushtuar njëkohësisht enët e gjakut që gjenden në të dhe duke dobësuar punën e veshkës.

Trajtimi medikamental- metoda më e preferuar

Sipas mjekëve, gurët gjithmonë duhet të hiqen kur ka infeksione, bllokime dhe dëmtime në veshka. Ka metoda të ndryshme për ta bërë këtë. Megjithatë, trajtimi medikamental mbetet metoda e preferuar kur ka mundësi. Ndërsa mjekët popullorë rekomandojnë disa kura popullore për kurimin e gurëve në veshka. Sipas tyre, gurët në veshka kurohen me fier guri, gjethe delli, bishta qershie etj. Këto bimë kuruese për gurët në veshka përdoren në forme çaji.

Autor: ENDRITI	FUTBOLLISTI NË FOTO	ISH FUTBOLLISTI SHQIPTAR BORIÇI	PREDHA E MBUSHUR ME LENDË PLASËSE KIK-BOKSIERI MAKSUTAJ	I LARTË	NATRIUM, FOSFOR, INTENSITET	EPOKA	DOKUMENT I VJETËR MBI PRONËSINË E TOKËS	AKTORI HOLLIVUDIAN SANDLER		ZANORË	UJËVARË NË KOSOVË	AKTORI YNË REXHEPI	JEVG
INSTRUMENT MUZIKOR										PRINC QË SUNDON NË NJË EMIRAT EMËR YNI MASHKULLI (shq.)			
KËNGËTARE DHE AKTORE E NJOHUR SHQIPTARE										SHKURTESA PER ORGANI- ZATEN NDERKOM- BETARE TE PUNËS (original)			
AKTORE E NJOHUR ARVANITASE										"RIMINI" DEM, TER			
SHTET NË AFRIKË (pashq.)							I LODHUR SA GATI I ZIHET FRYMA FOLI, SHPREHEM ME FJALË						MBATHËSET SPORTIVE
TEPELENA KLUB I YNI FUTBOLLI		KRYEQYTETI I ARABISË SAUDITE	LLOJ PISTOLETE ARKËTAR			BASHKËT- INGËLLORE PERËNDESHË E DASHURISË (mit. romake)		HOV, VRULL (sh.shq.)	NË KËTË MOMENT, TANI TEFTA TASHKO			BASHKËT- INGËLLORE PARAKALIMI USHTARAK	
					MJET I THJESHË PUNË (shq.) KASOLLE E BARINJVE					VËLLAU I MADH ANTON PASHKU			
AMPER, INDIUM				EMAL MËSYMJE						APOLLONIA KUNDREJT E VJETËR		ARTIOLA TOSKA DËSHMORI KODRA	
PËRZJEVA										PJESË E ILIRISË STUJIA E FORTE ME ERË DHE SHI			
AI QË KUJDESEJ PËR ODAT (pashq.)								HJESHI, BUKURI (krah.) SULFUR, RADIUM				PJESË E DREDHUR E LITARIT NORA ISTREFI	
QYTET I LASHTË NË ILIRI							KËNGA QË I KËNDOHET TË DASHURISË ME KITARË PJESËTAR I NJË FISI ILIR						
ZANORË		ALBIN KURTI SHTET NË AZI (shq.)			AKTORJA JONË DOBROSHI EKZEMPLAR I VETËM (shq.)					LEJE PËR TË SHKUAR NGA ODA (sh.shq.)			
ADNAN (perkdh.)				AKTORJA E FAMSHME THURMAN ZAKONI, TRADITA				GROSETO PRAGA					
QYTET I VJETËR NË KOSOVË								PAMELA ANDERSON ORGANIZATA NDERKOM- BETARE PËR MIGRIM (Original)					
LEZHË, MALIQI			ISH FUTBOLLISTI ITALIAN BAXHO GOTA E METALTE						NANTES LEGJENDA E MUZIKËS SONE ZELA				
AGJENT PROFESION- IST PRIVAT (shq.)													
							MIMOZA AHMETI KYÇ, NYJE			ANITA TAKE			
LLOJ VEPRE MUZIKORE	I SHOSHITA ROSTOK							QIPRO, AUSTRIA BASHKËT- INGËLLORE					
RADIO TELEVISIONI ITALIAN													

